



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Biznes dhe Tregti  
Elektronike”**

**ofruar nga**

**“Universiteti i New York-ut në Tiranë”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

Prof. Asoc. Ezmolda Barolli

Prof. Asoc. Anila Boshnjaku

Nëntor, 2024

**Tabela Përmblyëse Për Programin e studimit e studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” ofruar nga “Universitetit i New York-ut në Tiranë”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 230, dt. 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2021-2022:8 PAE/2 PAK v.a 2022-2023:14 PAE/2 PAK v.a 2023-2024:20PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022: 4 studentë 2022-2023: 3 studentë 2023-2024: 13 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” në Universitetin e New York-ut në Tiranë është një program i ciklit të parë të studimeve. Ky program ofrohet nga një Universitet me përvojë mbi 20 vjeçare në procesin akademik dhe kërkimor, i cili ka ofruar programe të kombinuara katër vjeçare amerikane me State University Of New York / Empire State University, SHBA, të cilat kanë rezultuar të suksesshme.

Hapja e programit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” vjen pas zhvillimeve të fundit në fushën e arsimit bazuar në kërkesat e sistemit të Bolonjës dhe zhvillimeve lokale dhe rajonale të tregut të punës. Ky program ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, i cili është i organizuar në tre njësi themelore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, konkretisht:

1. Departamenti i Administrimit të Biznesit,
2. Departamenti i Ekonomisë dhe Financës,
3. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe E-Biznesit

Programi i studimit është licensuar me Urdhrin e MAS Nr. 230, dt. 19.07.2021

Qëllimi i programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është të sjellë një risi në tregun e profesionistëve të fushës së biznesit dhe tregtisë elektronike që lidhen me shfrytëzimin e web në fushën e marketingut dhe menaxhimit me qëllim rritjen e konkureshmërisë në këtë mjedis të ri të të bërit biznes, në erën e inteligjencës artificiale. Gjithashtu, ky program studimi tenton të rrisë aftësitë e punës së pavarur të studentëve, të menduarit kritik si dhe pozicionimin e tyre aktiv në tregun e punës.

Programi refleton një strukturë mësimore të mirëstrukturuar mbështetur në eksperiencën akademike dhe profesionale të personelit brenda dhe jashtë UNYT, si edhe në përvojat e të diplomuarve në degë të përafërta. Programi është i strukturuar në përputhje me standardet kombëtare të arsimit të lartë dhe ofron mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta dhe të specializuara në fushën e biznesit dhe tregtisë elektronike. Programi fokusohet në përdorimin e metodave dhe teknologjive të fundit, duke përgatitur studentët për të kontribuar në zhvillimin e dijes në këto fusha. Personeli akademik është i kualifikuar dhe ndjek një qasje të personalizuar në mësimdhënie, duke ofruar orientim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Përfundimi i programit të studimit realizohet me mbrojtjen e punimit të diplomës. Proçesi i vlerësimit është transparent dhe i drejtuar nga kriteret dhe standardet e përcaktuara në rregulloret dhe ligjet e arsimit të lartë në Shqipëri. Studentët, pas përfundimit të programit, pajisen me diplomë dhe suplement të diplomës që japin informacion mbi njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve. Përgjegjësia për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve është e siguarur në përputhje me legjislacionin dhe parimet e konfidencialitetit.

Programi i studimit u jep mundësi studentëve të kenë akses në tregun e punës në sektorët që lidhen me teknologjinë e internetit në praktikat e saj të biznesit. Lëndët në këtë program janë një harmonizim i atyre që lidhen me ekonominë, financën, menaxhimin, marketingun, pra ekonomi dhe shkenca kompjuterike.

Për të fituar diplomën studentët duhet të kenë marrë 180 kredite ECTS, duke përfshirë 60 kredite ECTS për çdo vit akademik.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti i New York-ut në Tiranë ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për herë të parë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike" me shkresën Nr. 45/2023 Prot, datë 10.03.2023.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli dhe Prof. Asoc. Dr. Anila Boshnjaku është mbështetur nga Zj. Alma Arapi, koordinatore teknike e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Puna për vlerësimin e jashtëm ka filluar me një takim të dy vlerësuesve me koordinatoren teknike të ASCAL, ku u diskutua mbi organizimin e punës.

Në përgatitjen e RVJ, GVJ ka analizuar gjetjet e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) bashkë me anekset si dokumentacion mbështetës dhe evidencat e përgatitura nga strukturat përkatëse. Gjatë analizës së Raportit, të përgatitur nga GVB, janë evidentuar disa pyetje e komente të cilat përbënë bazën e diskutimeve në takimet e zhvilluara gjatë vizitës dy ditore në institucion. Gjatë këtyre 2 ditëve GVJ u takua me drejtues, pedagogë, GVB, përfaqësues të zyrave si Zyra e Burimeve Njerëzore, NJSBC, KPSSC, studentë, Zyra e Karrierës, Zyra e Çështjeve Studentore, Sekrearia, etj, gjatë diskutimit me të cilët u sqaruan çështjet sipas pyetjeve të përgatitura në avancë.

Gjithashtu, përmes vizitës në institucion, GVJ është njohur më nga afër me infrastrukturën fizike dhe mësimore, aspektet praktike të punës së zyrave dhe Departamentit, opinionet e pedagogëve dhe studentëve lidhur me procesin mësimor, sistemin e sigurimit të cilësisë etj. GVJ vizitoi laboratorët, auditorët, bibliotekën, për të parë nga afër përshtatshëmrinë e tyre me standardet cilësore të mësimdhënies dhe jetës akademike.

Vlerësimi i jashtëm u realizua për të 6 fushat e vlerësimit, sipas standardit përkatës.

Dëshirojmë të vlerësojmë angazhimin maksimal të institucionit për organizimin e takimeve, përgjegjshmërinë e stafeve gjatë diskutimeve dhe mikpritjen e ofruar nga institucioni.

Universiteti i New York-ut në Tiranë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 5 / 39 Prot, datë 31.10.2024. Universiteti i New York-ut në Tiranë njofton në ASCAL më datë 08.11.2024, me anë të shkresës me Nr.248 Prot, datë 06.11.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 248 Prot, Datë 06.11.2024.

*GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:*

### **Komenti 1**

GVJ sugjeron që shtimi i stafit ndihmës akademik në organigramë është shumë i nevojshëm, në funksion të zhvillimit të orëve të praktikës dhe orëve të laboratorit për lëndët që lidhen specifiku me këtë program studimi apo programe të tjera të ngjashme dhe lidhen ngushtësisht me përdorimin e teknologjisë së informacionit.

*Në lidhje me këtë sugjerim institucioni argumenton se: Departamenti njeh vlerën e stafit ndihmës akademik për të përmirësuar procesin e mësimdhënies, veçanërisht në zhvillimin e komponentëve praktikë dhe laboratorikë. Profili i programit përfshin një*

*numër të kufizuar lëndësh që kërkojnë orë laborator, të cilat mund të akomodohen në laboratorët e kampusit kryesor ose lindor sipas nevojës. Për më tepër, departamenti i IT në UNYT, në bashkëpunim me pedagogun e lëndës, siguron që i gjithë programi softuerik i kërkuar të instalohet në kopjuterët laboratorikë, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për të mësuar anën praktike. Anëtarët e fakultetit që japin lëndë si Aplikacione Kompjuterike, Statistika I, Statistika II dhe Sistemet e Informacionit në Menaxhim kanë integruar aktivitete praktike dhe laboratorike në programin bazë.*

*GVJ merr në konsideratë argumentat e institucionit në këtë pikë.*

***Sugjerimi hiqet dhe ndryshimi reflektohet në raport.***

## **Komenti 2**

GVJ sugjeron pasqyrimin e funksionit të koordinatorit të programit si dhe përcaktimin e detyrave të koordinatorit në Rregulloren e Programit, Rregulloren e Departamentit apo edhe Statutin e Institucionit.

*Në lidhje me këtë sugjerim, ju bëjmë me dije se UNYT ka marrë masat të emërojë staf akademik të dedikuar në funksion si koordinator programi në programet bachelor. Ky funksion do të reflektohet në aktet ligjore të institucionit.*

*GVJ vëren me kënaqësi që ky sugjerim është marrë në konsideratë dhe Institucioni angazhohet ta reflektojë emërimin e një stafi akademik të dedikuar në pozicionin e koordinatorit të programit dhe formalizimin në aktet ligjore përkatëse.*

*Rekomandimi mbetet deri në miratimin e akteve ligjore përkatëse si Rregullorja e Programit, Rregullorja e Departamentit dhe Statutin e Institucionit.*

***Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.***

## **Komenti 3**

GVJ konstaton se përfshirja e studenteve në mobilitete është shumë e vogël.

*Në lidhje me këtë konstatim, UNYT bie dakord duke pasur parasysh numrin e ulët të studentëve. Ju bëjmë me dije se përkatesisht zyra e marrëdhënieve me jashtë do të angazhohet me qëllim përfshirjen e një numri më të madh studentësh në programet Erasmus +, duke konsideruar se numrat e studentëve janë në rritje në këtë program studimi.*

*GVJ vëren me kënaqësi që ky sugjerim është marrë në konsideratë dhe Institucioni angazhohet për përfshirjen e një numri më të madh studentësh në programet Erasmus +, detyrë kjo që i ngarkohet zyrës së marrëdhënieve me jashtë.*

***Rekomandimi mbetet e raporti nuk ndryshon.***

## **Komenti 4**



Ka një paqartësi në rregulloret e sipërcituara në lidhje me mbrojtjen e Projektit të Diplomimit para një komisioni apo vlerësimit të tij vetëm nga udhëheqësi, meqenese konsiderohet si një lende e detyruar. Sugjerohet që kjo gjë të qartësohet në rregulloret përkatëse.

*Projekti i Diplomimit është konsideruar në Rregulloren e Programit si një kurs i zakonshëm dhe si i tillë është vlerësuar nga pedagogët udhëheqës. Aktualisht, departamenti planifikon të integrojë mbrojtjen e projektit para një komisioni.*

*GVJ vëren me kënaqësi që ky sugjerim është marrë në konsideratë dhe Institucioni planifikon të integrojë mbrojtjen e projektit para një komisioni.*

*Rekomandimi mbetet deri në reflektimin e këtij angazhimi në Rregulloren përkatëse.*

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

## **Komenti 5**

Dosjet e personelit duhet të përmbajnë dhe përshkrimet e punës së stafëve. Procesi i vlerësimit të standardizohet përmes një formati vlerësimi me pikë, gjë që do të rrishte transparencën dhe objektivitetin në vlerësim.

*Përsa i përket përshkrimit të punës, ju njoftojmë që është e përfshirë në kontratën e punës. Institucioni do të marrë parasysh sugjerimin e ekspertëve të jashtëm dhe të rishikojë procesin e vlerësimit përmes një formati vlerësimi me pikë për stafin akademik. (Aneksi 4.28 Kontrate Punë me kohë të plotë me afat të pacaktuar).*

*GVJ lidhur me përshkrimet e punës, pasi rishqyrtoi kontratën e punës, gjen se përshkrimet e punës janë të përfshira në të.*

*Sa i takon procesin e vlerësimit, vërejmë me kënaqësi se Institucioni angazhohet për një vlerësim me cilësor të stafëve siç rekomandohet pra të rishikojë procesin e vlerësimit përmes një formati vlerësimi me pikë për stafin akademik.*

**Rekomandimi rishikohet: hiqet pjesa që ka të bëjë me përshkrimin e punës por mbetet ajo që ka të bëjë me vlerësimin me pikë të stafëve.**

## **Komenti 6**

GVJ rekomandon monitorim më të mirë të përditësimit të literaturës nëpërmjet kontrollit më të saktë të syllabuseve.

*UNYT bie dakord me rekomandimin e eksperteve dhe do të merren masat e nevojshme për përditësimin e literaturës, por vlen të theksohet se në disa lende si psh. Planifikimi i Burimeve të Ndërrmanjes nuk ka literaturë të botuar brenda 5 vjeçarit të fundit.*

*GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për të marrë parasysh këtë rekomandim.*

**Rekomandimi mbetet dhe raporti nuk ndryshon.**

## **Komenti 7**



GVJ sugjeron ngritjen e një njësie të auditit te brendshëm.

*Ju informojmë se Institucioni e ka ngritur Komisionin e Auditimit te brendshëm dhe ka hartuar një procedurë specifike në lidhje me funksionimin e tij në vitin akademik 2022-2023. Ky komision ka filluar punën në vitin akademik 2023-2024, i cili e ka përfunduar procesin e auditimit në njësinë e sekretarisë mësimore. (Aneksi 6.8 Procedura e Auditit te Brendshem; Aneksi 6.20 Vendim Rektorati për Auditin e Brendeshem).*

*GVJ pasi shqyrtoi dokumnetacionin e vënë në dispozicion (Aneksi 6.8 Procedura e Auditit te Brendshem; Aneksi 6.20 Vendim Rektorati për Auditin e Brendeshëm) mendon se ky rekomandim është tashmë i ezauruar.*

**Rekomandimi hiqet dhe reflektohet në raport.**

### **Komenti 8**

GVJ sugjeron te behet përditësimi i fletëpalosjeve.

*Zyra e Marketingut dhe Marredhenieve me Publikunne UNYT, perditeson cdo vit akademik fletepalosjet/broshurat. (Bashkelidhur disa shembuj).*

*GVJ pasi konsideroi shembujt e vëna në dispozicion për fletëpalosjet , vëren se kjo çështje është ezauruar nga institucioni.*

**Rekomandimi hiqet dhe reflektohet në raport.**

### **Komenti 9**

GVJ sugjeron që Institucioni të mbajë statistika më të hollësishme lidhur me punësimin e studentëve. Mendojmë se duhet të mbahen të dhëna edhe se ku janë punësuar dhe jo vetem a janë punësuar studentët pas përfundimit të studimeve në UNYT.

*Në lidhje me këtë konstatim, institucioni sqaron se zyra e karrierës dhe alumnit mban lidhje me studentët e diplomuar, si dhe ka përpiluar raporte në të cilat ka informacione të detajuara në lidhje me punësimin e studenteve dhe nëse janë të punësuar sipas fushës në të cilat kanë zhvilluar studimet. Përsa i përket programit te studimit ne fjale, UNIT nuk disponon te dhena te kesaj natyre duke qene se ky program studimi po kalon procesin e akreditimit per here te pare dhe nuk ka studente te diplomuar. (Bashkengjitur aneksi i formatit per punesimin e studenteve per nje tjetër program studimi).*

*GVJ pranon sqarimin e bere nga ana e Instiucionit lidhur me statistikat për punësimin e studentëve dhe quan të drejtë argumentimin e tij lidhur me referencën që i bën këtij programi studimi, duke besuar se modeli i vënë në dispozicion për këtë çështje për një program tjetër studimi do të replikohet edhe për programin në fjalë.*

**Rekomandimi hiqet dhe reflektohet në raport.**

### **Komenti 10**



Mund të aplikohen edhe stimuj financiarë për pedagogë që kanë arritje të spikatura në procesin mësimor dhe kërkimor.

*UNYT bie dakord me këtë rekomandim dhe do të marrë masa për implementim.*

*GVJ vëren me kënaqësi pranimin e rekomandimit dhe angazhimin e institucionit për zbatimin e tij.*

**Rekomandimi mbetet.**

#### **Komenti 11**

GVJ sugjeron të ndiqen edhe metoda të tjera të tërthorta për të vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, siç është bashkëpunimi me institucione që janë të lidhura me keto programe studimi, të cilat mund të kërkojnë edhe studime e kërkime nga Departamenti, por edhe janë në cilësinë e punëdhënësve potenciale.

*UNIT bie dakord me këtë rekomandim dhe do të marrë masa për implementimin e tij. GVJ vëren me kënaqësi pranimin e rekomandimit dhe angazhimin e institucionit që do të ndiqen edhe metoda të tjera të tërthorta për të vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, siç është bashkëpunimi me institucione që janë të lidhura me këto programe studimi, të cilat mund të kërkojnë edhe studime e kërkime nga Departamenti, por edhe janë në cilësinë e punëdhënësve potencialë.*

**Rekomandimi mbetet dhe raporti nuk ndryshon**

#### **Komenti 12**

GVJ sugjeron metoda indirekte të vlerësimit të cilësisë dhe bashkëpunim të jashtëm.

*Departamenti ka realizuar prej themelimit të tij, bashkëpunime me institucionet e lidhura me programin e Biznesit dhe Tregtisë Elektronike, sepse gjithashtu mendojmë se ky bashkëpunim është i dobishëm për vlerësimin e cilësisë së programit. Kjo është arsyeja pse ne tashmë po ndjekim partneritete me drejtues të industrisë dhe organe profesionale. Këto bashkëpunime jo vetëm që na lejojnë të mbledhim reagime indirekte për cilësinë e programit, por gjithashtu t'u ofrojmë studentëve mundësi të vlefshme rrjetëzimi dhe punësimi (Aneksi 2.2 - Strategjia e Studimit të Tregut të UNYT; Aneksi 3.16 - Studimi i Tregut, 5.1 - Lista e Memorandumeve të Bashkëpunimit).*

*GVJ vlerëson prirjen për bashkëpunim të Institucionit me institucionet e lidhura me programin e Biznesit dhe Tregtisë Elektronike, njohjen e dobisë së këtij bashkëpunimi për vlerësimin e cilësisë së programit si dhe partneritetet me drejtues të industrisë dhe organe profesionale. GVJ merr në konsideratë argumentat.*

**Rekomandimi hiqet dhe reflektohet në raport.**





**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), mbështetur tek dokumentacioni i shtyrtnuar (Aneksi 1.1) si dhe Statuti i Universitetit të New York-ut në Tiranë (UNYT) (Aneksi 1.4). konstaton se programet e arsimit që ofron ky institucion nuk bien ndesh me interesat kombëtare duke synuar ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore në vend. Në Statut, Neni 3 deklarohet se <i>“Misioni i UNYT është krijimi, zhvillimi, përcjellja dhe mbrojtja e dijeve, si edhe përgatitja e qytetarëve paraprirës të së ardhmes, profesionistëve dhe akademikëve të ardhshëm me anë të mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe intergrimit në komunitet, si dhe duke siguruar njohuritë, aftësitë, karakterin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar.”</i></p> <p>Në Statut theksohet se institucioni është i angazhuar në zhvillimin intelektual, krijues dhe personal të studentëve të tij. Ai synon zhvillimin e metodave të kërkimit shkencor, rritjen e njohurive në perspektivën globale, zhvillimin e aftësive për tu bërë ekspertë të fushës, forcimin e vlerave të integritetit dhe objektivitetit, formimin e vlerësimit të trashëgimisë dhe kulturës shqiptare përmes rasteve studimore, etj. Duke u bazuar në këto objektiva të shprehura në Statut, GVJ gjykon se institucioni ka në fokus ruajtjen e vlerave akademike (të shprehura tek kërkimi shkencor i alternuar me mësimdhënien) dhe vlerave kulturore (të shprehura në kontributin dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe rritjen e mirëqënies së kësaj të fundit).</p> <p>UNYT ofron 17 programe studimi në 3 fusha kryesore: Shkenca Ekonomike; Shkenca Humane dhe Shoqërore; Shkenca Inxhinierike. Nëpërmjet këtyre programeve synohet të formohen profesionistët e së ardhmes të cilët do të kontribuojnë në avancimin e njohurive dhe aplikimin e tyre në tregun e punës në vendin tonë. Duke i konsideruar këto fusha të rëndësishme për zhvillimin e vendit, gjykojmë se ofrimi i programeve të studimit në UNYT mbështet interesat kombëtare në vend.</p>



	<p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.4: UNYT Arsyetim per hapjen e programit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar (Aneks 1.4), GVJ konstaton se qëllimi i përgjithshëm i programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është që tu mundësojë studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zhvillojnë dhe aplikojnë arritjet shkencore dhe profesionale në fushën e biznesit dhe tregtisë si dhe të disiplinave të përafërta;</li> <li>• Të përvetësojnë kualifikim profesional që të punësohen në sektorët e biznesit të cilat shfrytëzojnë teknologjitë e informacionit dhe internetit;</li> <li>• Të kenë edukimin e përshtatshëm për të vazhduar studimet e mëtejshme në ciklin e dytë.</li> </ul> <p>Ky program studimi synon tu ofrojë studentëve një kombinim të ekspertizës teknologjike dhe aftësive në biznes dhe tregti duke eksploruar thellësisht konceptet dhe praktikat thelbësore të biznesit dhe tregtisë elektronike nga marketingu modern, në perspektivën e menaxhimit strategjik, në shfrytëzimin e web-it për biznes dhe tregti, dhe në menaxhimin me efektivitet të eksperiencës dhe kënaqësisë konsumatore, me qëllim rritjen e konkurrencës në këtë mjedis të ri të të bërit biznes.</p> <p>Mbështetur tek qëllimi dhe objektivat e programit, GVJ konstaton se ai është i hartuar në përputhje me atë që është shprehur në qëllimin e përgjithshëm dhe misionin e institucionit siç deklarohen në Statutin e tij (Neni 3) si dhe në Misionin dhe Objektivat e tij (Aneks 1.11), ku theksohet misioni për të edukuar drejtuesit e së ardhmes, si dhe për të përgatitur profesionistët dhe akademikët e ardhshëm.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.4: UNYT Arsyetim per hapjen e programit.pdf</b>  <b>Aneks 1.11: UNYT Mission and Objectives, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi Planin Strategjik 2020-2025 (Aneks 1.6) të institucionit, konstaton se programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” ofrohet në përputhje me këtë plan, konkretisht në përputhje me Objektivin Strategjik 1, ku citohet zhvillimi i vazhdueshëm i kurrikulave akademike dhe hapja e programeve të reja për të integruar sa më mirë nevojat e tregut.</p>




	<p>Gjithashtu sikurse konstatuam edhe në kriteret e mësipërme, hapja e këtij programi studimi është mbështetur në Statutin e institucionit duke qenë në përputhje me misionin e tij.</p> <p>Duke shqyrtuar Rregulloren e UNYT Kreu IV (Aneks 1.7) dhe Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit Neni 9 (Aneks 1.8), GVJ konstaton se ky program është hartuar në përputhje me këto rregullore në lidhje me elementët kryesorë të programit të tillë si numri i krediteve të fituara në përfundim të tij, kohëzgjatja, hartimi i kurrikulës, ngarkesa e të nxënit, etj.</p> <p>Bazuar tek Rregullorja e Programit të Studimit (Aneks 1.10) ky program i përket një fushe ndërdisiplinare duke kombinuar njohuritë e fushës së biznesit me ato të teknologjisë së informacionit. Ai është i orientuar drejt ndërtimit të ekspertizës në shfrytëzimin e sistemeve të informacionit për të përmbushur nevojat e biznesit, me qëllim të krijojë profesionistë për dekadën e ardhshme të teknologjisë së informacionit, si rrjedhim është në përputhje me fushat e veprimtarisë së institucionit (të cilat janë: Shkenca Ekonomike; Shkenca Humane dhe Shoqërore; Shkenca Inxhinierike).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.6: UNYT Plani Strategjik 2020-2025, Ang.pdf</b>  <b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>Aneks 1.8: UNYT Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, Alb.pdf</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit të UNYT. Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar Tabelat Përmbledhëse: Tabela 1 (Aneks 2.5), për vitin akademik 2023 – 2024 ky departament ka 8 anëtarë staf akademik efektiv (në përputhje me kërkesat e legjislativës në fuqi), i cili është i përfshirë në mësimdhënie në këtë program. Për shkak të natyrës ndërdisiplinare në këtë program janë përfshirë edhe pedagogë të tjerë, të departamenteve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, apo të fakulteteve të tjera të UNYT si dhe pedagogë me kontratë. Në bazë të të dhënave të Tabelës 4, gjatë vitit akademik 2023 – 2024 në këtë program janë përfshirë 22 pedagogë. Duke pasur si objektivi strategjik edhe ndërkombëtarizimin (Ankes 1.11) institucioni ka punësuar staf të huaj dhe ka rritur përqindjen e përfaqësimit të personelit nga vende të tjera.</p>

	<p>Mbështetur në të dhënat e sipërcituara si dhe tek shyrtimi i CV-ve të stafit akademik (Aneks 1.18) GVJ gjykon se UNYT i ka kapacitetet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.18: CV Staff.pdf</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas Nenit 6 të Rregullores së Programit (Aneks 1.10), programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është i hapur për studentët që synojnë të ndërtojnë njohuritë në informatikën e biznesit. Programi synon të krijojë profesionistë në fushën e biznesit dhe tregëtisë elektronike. Programi ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit të UNYT. GVJ konstaton se fusha e studimit të programit ka përputhshmëri me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore si dhe njësisë bazë e cila është përgjegjëse për programin e studimit. Ky konstatim mbështetet edhe në të dhënat e dokumentit për kërkimin shkencor në departament (Aneks 2.3) si dhe në Rregulloren e Departamentit (Aneks 1.9). Sipas Kornizës Europiane dhe Shqiptare të Kualifikimit, ky program studimi i përket nivelit 6 të kualifikimit, dhe ka një kohëzgjatje në 3 vite akademike, në përfundim të të cilit studentët pajisen me 180 kredite ECTS.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.9: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b>  <b>Aneks 2.3: Kerkimi Shkencor ne nivel Departamenti.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mbështetur tek Statuti i UNYT, GVJ konstaton se programet e arsimit që ofron ky institucion nuk bien ndesh me interesat kombëtare duke synuar ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore në vend. Institucioni ofron programe në fusha të rëndësishme për zhvillimin e vendit, kështu që gjykojmë se ofrimi i programeve të studimit në UNYT mbështet interesat kombëtare në vend.</i></p> <p><i>Mbështetur tek qëllimi dhe objektivat e programit, GVJ konstaton se ai është i hartuar në përputhje me atë që është shprehur në qëllimin e përgjithshëm dhe misionin e institucionit.</i></p>



	<p><i>Mbështetur në dokumentacion GVJ konstaton se programi është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</i></p> <p><i>Në bazë të të dhënave të tabelave përmbledhëse dhe CV-ve të stafit, GVJ gjykon se UNYT i ka kapacitetet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike".</i></p> <p><i>GVJ konstaton se fusha e studimit të programit ka përputhshmëri me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore si dhe njësisë bazë e cila është përgjegjëse për programin e studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar tek shqyrtimi i dokumentave: Statutit të institucionit, Kapitulli 2, 3, 5 (Aneks 1.1), Rregullore e Fakultetit (Aneks 1.8) dhe Rregullore e Departamentit (Aneks 1.9) GVJ konstaton se UNYT ka përshkruar strukturën organizative si dhe mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe bashkëpunimin mes njësive përbërëse të tij. Sipas tyre, çdo njësi ka detyra dhe objektiva ku njësitë bazë organizojnë veprimtaritë mësimore dhe kërkimore dhe njësitë kryesore koordinojnë aktivitetet e njësive bazë që ato kanë të përfshira. Njësitë administrative të përgjithshme të institucionit mbështesin aktivitete të ndryshme të përgjithshme si infrastruktura, shërbimet e teknologjisë së informacionit, menaxhimin e projekteve, etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi një harmoni dhe bashkëpunim midis të gjitha njësive, në mbështetje të ofrimit të programeve cilësore të studimit.</p> <p>Përsa i përket analizës së punës së njësive institucionale, GVJ shqyrtoi Raportin Vjetor të institucionit (Aneks 1.5) si dhe Raportin Vjetor të Departamentit (Aneks 1.14) në të cilat evidentoi angazhimin e njësive përkatëse në analizimin e punës së stafit dhe performancës së programeve të studimit që ato ofrojnë në tërësi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.18: CV Staff.pdf</b></p>

	<p><b>Aneks 1.9: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b>  <b>Aneks 1.5: Raporti Vjetor 2022- 2023 MAS.pdf</b>  <b>Aneks 1.14: Raporti vjetor i Departamentit_ Viti Akademik 2022-2023.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</b></p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar (Aneks 2.5: Tabelat Përmbledhëse, Tabela 5) dhe sipas konfirmimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar 60 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme private dhe publike, ku vend të rëndësishëm zënë njësitë ekonomike dhe kompanitë e biznesit. Nga këto marrëveshje 27 janë në funksion të të gjitha programeve të studimit dhe 33 të tjera për programe specifike ku përfshihet IT dhe Telekomunikacioni, Ekonomia, Financa, etj.</p> <p>Përsa i përket bashkëpunimit me institucionet homologe, GVJ konstaton që UNYT ka një sërë bashkëpunimesh me një shtrirje të gjerë në universitetet Evropiane, por vetëm një bashkëpunim me IAL në vend. GVJ sugjeron shtrirjen e bashkëpunimit me IAL në Shqipëri, për të forcuar rrjetin e bashkëpunimit akademik dhe institucional në vend.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b>  <b>5.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit.pdf</b>  <b>5.2 Lista e Marreveshjeve per Bashkepunim Erasmus, Mevlana.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</b></p>	<p>Në bazë të planit mësimor të programit të studimit (Tabela 10) si dhe diskutimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se praktika mësimore është 100 orë nga të cilat 30 orë zhvillohen si lëndë mësimore në auditor dhe 70 orë zhvillohen internship në institucionet me të cilat UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi. Lidhjen e studentit me këto institucione e bën Zyra e Karrierës. Sikurse e theksuam edhe në kriterin e mësipërm UNYT ka bashkëpunim me kompani dhe biznese të ndryshme në vend, me të cilat bashkëpunon për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Gjithashtu institucioni organizon aktivitete të tjera në funksion të ofrimit të studentëve të tij në tregun e punës, si p.sh. panairin e punës, ditët e karrierës, apo workshop-e të ndryshme të cilat organizohen nga Zyra e Karrierës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b>  <b>5.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit.pdf</b></p>



	<p><b>5.2 Lista e Marreveshjeve per Bashkepunim Erasmus, Mevlana.pdf</b>  <b>Aneksi 5.12: Aktivitete Zyra e Karrieres.pdf</b>  <b>Aneksi 5.13: Zyra e Karrierës workshop.pdf</b>  <b>Aneksi 5.14: Internship me kompanitë bashkëpunuese.pdf</b>  <b>Aneksi 5.15: Panairi i Punës.pdf</b>  <b>Aneksi 5.14.1: Lista e internshipeve 2023.pdf</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit, përgjegjës për këtë program studimi harton raporte periodike për analizimin e performancës së vet vjetore (Aneksi 1.14). GVJ shqyrtoi raportin në të cilin analizohet përmbushja e objektivave të përgjithshme të departamentit dhe hartohen planet për vitin e ardhshëm. Në raport nuk evidentohet specifikisht cilat janë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në lidhje me këtë program studimi.</p> <p>Gjithësi gjatë vizitës në institucion, në takimin me Zyrën e Karrierës, GVJ u informua që kjo zyrë është përgjegjëse për lidhjen e studentëve me tregun e punës, si për realizimin e praktikave edhe për orjentimin e tyre drejt punësimit. Kjo zyrë harton planin e saj të veprimit (Aneks 5.16) në të cilin përcaktohen objektivat dhe analizohen arritjet e tyre.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi: 1.14 Raporti vjetor i Departamentit_ Viti Akademik 2022-2023.pdf</b>  <b>Aneksi 5.11: Rregullore Zyra e Karrieres.pdf</b>  <b>Aneksi 5.16: Plani Vjetor Zyra e Karrierës 23-24.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UNYT ka siguruar marrdhënie të frytshme bashkëpunimi midis njësive të tij në funksion të realizimit të programeve të studimit dhe mbarëvajtjes së punës. Këto marrdhënie mbështeten tek dokumentat themelore të institucionit si Statuti dhe Rregulloret e njësive përbërëse të tij.</i></p> <p><i>Institucioni harton raporte vjetore në të cilat analizon arritjen e objektivave dhe performancën e programeve të studimit dhe personelit të tij.</i></p> <p><i>Institucioni ka nënshkruar një sërë marrveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private, me qëllim realizimin e praktikave të studentëve, sjelljen e ekspertizave më pranë studentëve dhe lidhjen e tyre me tregun e punës.</i></p> <p><i>Zyra e Karrierës është përgjegjëse për lidhjen e studentëve me institucionet me të cilat UNYT bashkëpunon, në ndihmë të realizimit të praktikave si dhe afrimit të tyre me tregun e punës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II.ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është një program i ciklit të parë të studimit, që realizohet gjatë 3 viteve akademike në 6 semestra. Në përfundim të programit studentët marrin 180 kredite ECTS dhe pajisen me diplomë “Bachelor” në “Biznes dhe Tregëti Elektronike”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Aneks 1.1.3).</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit (Aneks 2.1), GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. Sipas “VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar”, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmblylëse për diplomim.</p> <p>Bazuar nga sa u tha më sipër, GVJ konkludon se ky program studimi është i organizuar në lëndë e module, dhe elementët përbërës të tij janë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015) dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p><b>Evidenca:</b></p>

	<p><b>Aneks 1.1.3: 2021-Urdher nr. 230, dt. 19.07.2021 Biznes dhe Tregti Elektronike UNYT.pdf</b></p> <p><b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit (Aneks 2.1), GVJ konstaton se tërësia e lëndëve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje të parashikuara në programin e studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” ofron një mbulim të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e biznesit dhe tregëtisë elektronike dhe ofron larmi të përfitimit të njohurive përkatëse në këto fusha. Lëndët në këtë program përfshijnë kurse të gjera si teoritë e biznesit dhe marketingut, lëndë ndërdisiplinore si financa, ekonomia dhe shkencat kompjuterike dhe kurse të përparura siç janë tregtia elektronike, menaxhimi strategjik i biznesit elektronik, menaxhimi i marrëdhënieve me klientët, planifikimi i burimeve, teknologjitë e web-it, big data, dhe marketingu dixhital.</p> <p>Ky program i përket Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe synon të mundësojë njohuritë themelore si dhe aftësitë specifike në një larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit dhe më tej të syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se në tërësi ky program planifikon të japë njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushën e vet të studimit si edhe i aftëson studentët për punësim të mëtejshëm. Ndërthurja e lëndëve paraqitet në përgjithësi e kompletuar për të aftësuar studentët e programit të kuptojnë parimet akademike të të dyja disiplinave.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p> <p><b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ashtu sikurse u evidentua edhe në kriterin 1 të këtij standardi, GVJ shqyrtoi Planin Mësimor të programit (Aneks 2.1) dhe konstaton që shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive është e qartë, duke pasqyruar ngarkesën në kredite. Kjo shpërndarje është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Kategoria A</b> (Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme): – 5 lëndë/module, gjithsej 30 ECTS (16.67%)</li> <li>- <b>Kategoria B</b> (Lëndë Karakterizuese - përgatitje për disiplinën shkencore): - 15 lëndë/module, gjithsej 96 ECTS (53.33%)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Kategoria C</b> (Lëndë Ndërdisciplinore - nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje): - 3 lëndë/module, gjithsej <b>22 ECTS</b> (12.22%)</li> <li>- <b>Kategoria D</b> (Lëndë Plotësuese - gjuhë e huaja, njohuri informatike, praktika profesionale): - 4 lëndë/module, gjithsej <b>24 ECTS</b> (13.33%)</li> <li>- <b>Kategoria E</b> (Detyrimet Përmbyllëse - Teza e diplomimit): - gjithsej <b>8 ECTS</b> (4.44%)</li> </ul> <p>GVJ konkludon se hartimi i programit të studimit përsa i përket verimtarive formuese është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar).</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas Planit Mësimor (Aneks 2.1) të programit dhe Tabelës 10 (Aneks 2.5), është përcaktuar ngarkesa në kredite e praktikës profesionale si dhe e detyrimeve përmbyllëse që është teza e diplomës.</p> <p>Praktika zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve, i përket Kategorisë D, ka 4 kredite ECTS dhe realizohet nëpërmjet 30 orëve në auditor dhe 70 orëve jashtë auditorit.</p> <p>Teza e Diplomës realizohet në përfundim të vitit të tretë të studimeve, i përket Kategorisë E, ka 8 kredite ECTS, realizohet nëpërmjet 30 orëve në auditor dhe 170 orëve jashtë auditorit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentacioni (RVB) dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se pranimit i studentëve në UNYT në programet e ciklit të parë bëhet sipas kriterëve që përcakton Këshilli i Ministrave për notën mesatare, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. Kushtet e pranimit, regjistrimit dhe matrikullimit të studentëve janë të përcaktuara edhe në Nenin 62 të Rregullores së UNYT dhe Neni 10-11 i Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit.</p> <p>Specifikisht për këtë program studimi këto kriterë janë të përcaktuara në Nenin 7, 8, 9 të Rregullores së Programit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”.</p> <p>Kërkesat për regjistrimin e studentëve paraqiten në Zyrën e Çështjeve Studentore sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e</p>





	<p>Arsimit dhe Sportit. Për studentët e huaj ndjekja e procedurave bëhet nga Senati dhe vlerësimet e aplikimeve bëhen nga Komisioni i Pranimit dhe Transferimit në nivel fakulteti.</p> <p>GVJ konstaton se ndjekja e procedurave të pranimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>RVB Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se nga institucioni nuk ofrohen programe të tilla të ngjashme me të njëjtën emërtesë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Aneks 1.3) GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është shoqëruar me kodin përkatës, sipas klasifikimit të bërë nga ministria përgjegjëse për arsimin, përkatësisht: Code1 63BA; Code2 0499; Code3 A.</p> <p>Gjithashtu në Planin Mësimor (Aneks 2.1) pasqyrohet qartësisht që çdo lëndë është e pajisur me kodin përkatës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b>  <b>Aneks 1.3: UNYT Kodifikimet Nr. Prot. 55.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se ky program studimi nuk ofrohet si program i përbashkët me institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky program studimi është i organizuar në lëndë e module, dhe elementët përbërës të tij janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015) dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p>

	<p><i>GVJ konstaton se në tërësi ky program planifikon të japë njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushën e vet të studimit si edhe i aftëson studentët për punësim të mëtejshëm.</i></p> <p><i>GVJ konstaton që shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive A-E është e qartë, duke pasqyruar ngarkesën në kredite.</i></p> <p><i>Në Planin Mësimor të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është përcaktuar qartë ngarkesa me 4 kredite e praktikës profesionale si dhe me 8 kredite e tezës së diplomës.</i></p> <p><i>Pranimi dhe financimi i studentëve në UNYT bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i></p> <p><i>Institucioni nuk ofron ndonjë program tjetër të ngjashëm me të njëjtën emërtesë.</i></p> <p><i>Kodimi i programit dhe lëndëve është bërë sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.</i></p> <p><i>Ky program nuk ofrohet si një program i përbashkët me institucione të tjera homologe.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>																										
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>																										
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																									
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” ofrohet nga Departamenti i Informantikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit të UNYT.</p> <p>Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të ligjit të A.L. “Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, GVJ konfirmon se Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Administrimit Biznesit</li> <li>• Departamenti i Ekonomisë dhe Financës</li> <li>• Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit</li> </ul> <p><b>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit për tre vite akademike ka në përbërjen e tij:</b></p> <table border="1" data-bbox="550 1848 1332 2016"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1		2		2	
Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit	2021-2022		2022-2023		2023-2024																					
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																				
Prof.Dr	1		2		2																					



<b>Prof.As.Dr</b>	4	1	2	1	3	1
<b>Dr</b>	7	6	10	9	11	9
<b>MSc</b>	9	1	9	3	8	3
<b>Total</b>	<b>21</b>	<b>8</b>	<b>23</b>	<b>13</b>	<b>24</b>	<b>13</b>

Referuar të dhënave në Aneks 2.5 (Tabelat 2), si dhe pas konfirmimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (më specifikisht, duhet të ketë minimumi 7 pedagogë efektivë nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada).

Bazuar tek Tabelat Përmbledhëse, të dhënat analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në 3 vitet që nga hapja e programit janë si më poshtë:

Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e- Biznesit	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
<b>Prof.Dr</b>	1		1		1	
<b>Prof.As</b>	1					
<b>Dr</b>	2		4		5	
<b>MSc</b>	3		3		2	
<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>

Çfarë bie në sy në të dhënat e mësipërme është mungesa e stafit me kontratë në këtë departament. Gjatë vizitës në institucion, GVJ pyeti për këtë pikë dhe u informua nga Përgjegjësi i Departamentit se kjo ka ndodhur për shkak se departamenti bashkëpunon me njësitë e tjera bazë të fakultetit si dhe me fakultetet e tjera të UNYT për plotësimin e nevojave me staf akademik për lëndët që ai mbulon.

Përsa i përket procesit të akreditimit, UNYT është licensuar me VKM Nr. 397, datë 15.08.2002 dhe Akredituar me Vendim BA Nr. 61, datë 18.12.2020 me kohëzgjatje 6 vite.

Sipas të dhënave në sistemin AMS të ASCAL, programi i studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” është licensuar me UMASR nr.230, datë 19.07.2021 dhe ky vlerësim bëhet për efekt të akreditimit për herë të parë të këtij programi.

Si përfundim GVJ konkludon se njësi kryesore/bazë përgjegjëse për këtë program studimi përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin.

	<p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b>  <b>RVB Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Përsa i përket angazhimit të personelit ndihmës akademik / administrativ në ndihmë të procesit mësimor, GVJ shqyrtoi informacionet në dokumentat e dorzuara, përkatësisht Tabelën 2 (Aneks 2.5) dhe vëren që institucioni deklaron një numër të konsiderueshëm të stafit ndihmës përgjatë 3 viteve të studimit të këtij programi, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Viti 2021 – 2022 ka 18 staf ndihmës akademik / administrativ</li> <li>• Viti 2022 – 2023 ka 9 staf ndihmës akademik / administrativ</li> <li>• Viti 2023 – 2024 ka 7 staf ndihmës akademik / administrativ</li> </ul> <p>Por gjatë vizitës në institucion, GVJ u interesua për funksionin dhe detyrat e këtij stafi të angazhuar dhe u informua që ai është pjesë e strukturës së institucionit dhe në ndihmë të të gjithë njësive kryesore të tij dhe ka detyra administrative. Në të përfshihen anëtarë të Zyrës së Informatikës, Bibliotekës, Zyrës së Pranimeve, Zyrës së Regjistrimit, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me përfaqësues të zyrës së Informatikës të cilët konfirmuan angazhimin e tyre në mirëmbajtjen e laboreve dhe asistimin e stafit akademik në rast instalimi programesh apo asistencë teknike.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b>  <b>RVB Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, RVB raporton se Drejtuesi i Departamentit është përgjegjës për koordinimin e programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”, duke evidentuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tij të cilat janë të përcaktuara në Statutin e UNTY dhe Rregulloren e këtij programi. Megjithatë GVJ konstaton që në këto dokumenta nuk evidentohet qartësisht ky fakt, si dhe nuk është përcaktuar qartësisht roli i koordinorit të programit si pjesë integrale e funksionit të përgjegjës të departamentit (Neni 24 i Statutit).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me Përgjegjës të Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, GVJ u informua se Përgjegjësi i Departamentit është koordinori i të dy programeve Bachelor që ofron ky departament, si dhe u njoh me rolin e tij në ecurinë e programeve të studimit duke konfirmuar këtë pozicion.</p> <p><i>Megjithatë GVJ sugjeron pasqyrimin e këtij funksioni si dhe përcaktimin e detyrave të koordinorit në Rregulloren e Programit, Rregulloren e Departamentit apo edhe Statutin e Institucionit.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p>

	<b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b> <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludon se Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit që janë njësitë përgjegjëse për këtë program studimi përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin.</i></p> <p><i>UNYT ka angazhuar staf ndihmës administrativ i cili luan një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e funksionimit të programeve të studimit që ai ofron.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon që Përgjegjësi e Departamentit kryen funksionin e koordinatorit të këtij program studimi duke realizuar me sukses të gjitha detyrat përkatëse, megjithatë sugjerjmë që zgjedhja dhe roli i koordinatorit të qartësohet në dokumentat themelore të institucionit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar (Rregullore e Programit, Rregullore e UNYT) si edhe informacionet e publikuara në faqen e internetit të UNYT dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishëm të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” disponohen nga Fakulteti (njësia kryesore) dhe Departamenti (njësia bazë) si edhe janë publike dhe të mundshme për t’u aksesuar lirisht nga studentët.</p> <p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi gjithashtu se studentët kanë informacion në lidhje me programin e studimit pasi informohen që në fillim të studimeve, por edhe në fillim të çdo semestri nga pedagogët përkatës të lëndëve specifike. Sikurse është e përcaktuar në Nenin 21 të Rregullores së Programit, plan programi i çdo lënde jepet në leksionin e parë dhe diskutohet me studentët. Kjo u konfirmua edhe në takimin me ta.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b> <b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b></p>

	<p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/e-business-and-e-commerce/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/e-business-and-e-commerce/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter GVJ shqyrtoi planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” (Aneks 2.5: Tabela 10) dhe konfirmon se ai përmban ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të çdo lënde, sasinë e orëve të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, projekteve, praktikës dhe orët jashtë auditorit. Gjithashtu edhe kreditet për çdo lëndë dhe kategorinë ku ajo bën pjesë. Ky plan është i hartuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimeve të studentëve në këtë program studimi, GVJ konstaton se ato janë të paraqitura qartësisht në Statutin e UNYT (Neni 66), Rregulloren e UNYT (Neni 62) dhe Rregulloren e Programit (Seksioni B: Procedurat e Pranimit). GVJ konstaton se pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për kriterin e notës mesatare dhe gjuhës angleze në nivelin B1 (si kriter pranues por jo përjashtues).</p> <p>Në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve, GVJ shqyrtoi dokumentacionin dhe vëren se institucioni ka implementuar rregulla të qarta dhe transparente për transferimet (Aneks 3.20). Komisioni i transferimeve (Neni 65 i Statutit) vepron në nivel departamenti. Pranimi i transferimit të studentëve bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të përcaktuara në dokumentin “Politika të Transferimit të Krediteve“. Studentët e huaj i nënshtrohen procedurave për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës, sipas legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>GVJ shqyrtoi gjithashtu edhe Tabelat Përmbledhëse të RVB (Tabela 21) dhe konstaton 1 student të transferuar gjatë vitit akademik 2023-2024 (në vitin e 2). Kjo gjë u verifikua edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>





	<p><b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b>  <b>Aneks 3.20: UNYT Politika e Transferimit te Studimeve, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të vlerësuar shkallën e plotësimit të këtij kriteri GVJ shqyrtoi Planin Mësimor të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike“ (Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse) dhe Syllabuset e lëndëve (Aneks 2.14).  Referuar dokumentave të sipërcituara, GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me praktikën në auditor, orët e seminarit, orët e laboratorit dhe orët e studimit individual. Të gjithë këta elementë janë në përputhje me udhëzimet e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Syllabuset përmbajnë edhe elementë të tjerë të tillë si: përmbledhjen e lëndës, rezultatet e të nxënit, temat, formën e kontrollit të njohurive, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar, etj. GVJ konkludon se ky program studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përsa i përket këtij program studimi, GVJ u informua gjatë takimit me Drejtuesin e Departamentit përgjegjës për këtë program, që gjatë këtyre 3 viteve akademike të ofrimit të këtij programi nuk janë bërë ndryshime në përmbajtjen e tij, deri në momentin e aplikimit për procesin e akreditimit.  Ndërsa në lidhje me procedurat e mundëshme të ndryshimit dhe përmirësimit të programeve, GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik dhe Drejtuesin e Departamentit që si procedurë, rishikimet e programit, ndërmerren në fund të një viti akademik si iniciativë e pedagogëve, për t’i paraprirë organizimit të punës për vitin në vijim dhe pasi miratohen nga përgjegjësi i departamentit ai e përcjell kërkesën në Dekanat. Dekanati i paraqet propozimet për ndryshime Senatit akademik i cili miraton ndryshimet në programe.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.1: Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar dhe intervista me studentët, GVJ konstatoi se informacionet për elementet e rëndësishëm të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” disponohen nga Fakulteti dhe Departamenti</i></p>

	<p>përgjegjës për këtë program, si edhe janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht nga studentët.</p> <p>GVJ konkludon që plani mësimor i këtij programi studimi përmban të gjithë elementët e duhur dhe është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p>GVJ konkludon që në Rregulloren e Programit janë përshkruar në mënyrë të qartë të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike" syllabuset e lëndëve janë hartuar me të gjithë elementët përbërës, në përputhje me udhëzimet ligjore dhe formatin e miratuar nga institucioni.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke analizuar Planin Mësimor të programit të studimit (Aneks 2.1), vëmë re se shpërndarja e lëndëve në 5 tipe veprimtarish (lëndë bazë; lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, diploma), si dhe përmbajtja e tyre, i jep mundësi studentëve të marrin njohuritë e nevojshme që nga ato bazë tek njohuritë më të thelluara, duke i përgatitur ata qoftë për tregun e punës qoftë për vazhdimin e studimeve në ciklin e 2-të. Ndër to spikasin lëndët Big Data, Marketingu Elektronik, Tregëtia Elektronike, Aplikime Kompjuterike, Sistemet e Informacionit të Menaxhimit, etj, të cilat do ti aftësojnë studentët në aplikimin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit për nevojat e biznesit dhe vendimmarjes.</p> <p>Një tjetër elementët për t'u vlerësuar në këtë program është edhe mësimdhënia në gjuhën angleze, gjë që lehtëson njohjen e studentëve me terminologjinë teknike, si dhe u jep më shumë mundësi studentëve të punësohen në tregun brenda ose jashtë vendit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b>  <b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në tre vite akademike sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e mirë menduar dhe mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Programi ka si objektiv pajisjen e studentëve me aftësitë themelore të përdorimit të teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe shërbimeve të internetit që mbështesin proceset elektronike të biznesit dhe tregtisë. Përzgjedhja e lëndëve në këtë program sidomos ato karakterizuese e mbështesin arritjen e këtij objekti.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b> <b>1.4 UNYT Arsyetim per hapjen e programit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor, GVJ konfirmon që struktura e programit dhe shpërndarja e lëndëve është në përputhje me profilin e programit. Sikurse e cilësuam edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, përzgjedhja e lëndëve është bërë e tillë që mbështet profilin e tij dhe përmbushjen e objektivave të programit për formimin e studentëve. Përsa i përket shpërndarjes së orëve, vihet re që shumica e lëndëve kanë orë praktike, të cilat janë në raportin e duhur me sasinë e orëve të leksioneve dhe seminareve. Gjatë takimit me drejtuesit, GVJ u informua që hartimi i këtij programi është mbështetur në modele të ngjashme të universiteteve ndërkombëtare.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të pasqyruara në Planin Mësimor janë të përcaktuara në përputhje me udhëzimet ligjore. Sikurse u analizua në Kriterin 1 të këtij standardi, lëndët e parashikura në secilën veprimtari janë zgjedhur të tilla që mbështesin realizimin e objektivave të programit. Për çdo lëndë janë parashikuar orët e praktikës, të cilat varrojnë nga 10-30 orë. GVJ vlerëson pozitivisht peshën e orëve të praktikës me aktivitetet e tjera të procesit mësimor, dhe konkludon që struktura në përgjithësi i lejon studentët të transferojnë studimet apo të bëjnë mobilitete, duke pasur lehtësi në njohjen e krediteve të përfituara.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve</p>	<p>Ky program studimi ka vetëm tre vite akademike që është hapur, dhe nuk ka pasur ndryshime thelbësore në strukturën dhe</p>

<p>/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>përmbajtjen e tij. Megjithatë në takimin me pedagogët dhe Drejtuesin e Departamentit, GVJ u informua që përditësime dhe përmirësime të materialeve mësimore, të literaturës, apo dhe elementëve metodikë të mësimdhënies ka pasur në çdo fillim viti. Çdo syllabus përmban seksionin e literaturës bazë dhe të rekomanduar, e cila në përgjithësi është ajo e viteve të fundit.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Ky program studimi, nëpërmjet lëndëve të tilla si Big Data, Marketingu Elektronik, Tregtia Elektronike, Aplikime Kompjuterike, Sistemet e Informacionit të Menaxhimit, etj, do ti aftësojë studentët në aplikimin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit për nevojat e biznesit dhe vendimarrjes. Do ti aftësojë studentët të zhvillojnë programe për menaxhimin e skenarëve kompleks të sistemeve të informacionit. Do ti aftësojë studentët të zhvillojnë baza të dhënash, të mësojnë gjuhë programimi, etj. Këto janë disa nga kompetencat dhe aftësitë që programi synon ti japë studentëve të regjistruar në të.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 2.1: Plani Mesimor i programit Bachelor në Biznes dhe Tregti Elektronike.pdf</b> <b>1.10 Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri syllabuseve të programit të studimit konstaton se në vija të përgjithshme përmbajtja e programit të studimit mundëson si vijimin e mëtejshëm të studimeve (në programe brenda dhe jashtë vendit pasi sic u tha më lart, ka ngjashmëri me programe ndërkombëtare), ashtu edhe punësimin e menjëhershëm të studentëve në kompani vendase apo të huaja.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton që shpërndarja e lëndëve në 5 tipe veprimtarish (lëndë bazë; lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, diploma), si dhe përmbajtja e tyre, i jep mundësi studentëve të marrin njohuritë e nevojshme që nga ato bazë tek njohuritë më të thelluara, duke i përgatitur ata qoftë për tregun e punës qoftë për vazhdimin e studimeve në ciklin e 2-të.</i></p> <p><i>Programi ka si objektiv pajisjen e studentëve me aftësitë themelore të përdorimit të teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe shërbimeve të internetit që mbështesin proceset elektronike të</i></p>



	<p><i>biznesit dhe tregtisë. Përzgjedhja e lëndëve në këtë program sidomos ato karakterizuese e mbështesin arrijten e këtij objekti. Përsa i përket shpërndarjes së orëve, vihet re që shumica e lëndëve kanë orë praktike, të cilat janë në raportin e duhur me sasinë e orëve të leksioneve dhe seminareve.</i></p> <p><i>Çdo syllabus përmban seksionin e literaturës bazë dhe të rekomanduar, e cila në përgjithësi është ajo e viteve të fundit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</b></p>	<p>Sikurse e kemi cilësuar edhe në Standardin 2.3 të këtij raporti, ky program studimi nuk ka pasur ndryshime që në hapje, përgjatë këtyre 3 viteve akademike të ofrimit të tij.</p> <p>Megjithatë GVJ konstaton se argumenti për hapjen e këtij programi studimi është bazuar mbi studimin e tregut dhe ka evidentuar nevojën për profesionistë në këtë fushë (Aneksi 1.4, Aneksi 3.16). Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Aneksi 2.5: Tabela 5) dhe takimi në institucion GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit bashkëpunon dhe konsultohet vazhdimisht me institucionet që UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi për të përmirësuar cilësinë e programeve që ofron.</p> <p>Në takimin me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnai, GVJ u informua që hartimi dhe përmirësimi i programeve të studimit në UNYT mbështetet në një proces të vazhdueshëm konsultimi me partnerët industrial dhe profesionistët, për të siguruar që programet që ofrohen përfshijnë të gjithë kompetencat e nevojshme që nevojiten në tregun e punës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi: 1.4 UNYT Arsyetim per hapjen e programit.pdf</b>  <b>Aneksi: 3.16 UNYT Studim Tregu, Alb.pdf</b>  <b>5.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit.pdf</b>  <b>Aneksi 5.12 Aktivitete Zyra e Karrieres.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe</b></p>	<p>Gjatë takimit në institucion me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës dhe Alumnai, GVJ u informua që kjo zyrë mban një bazë të dhënash të të gjithë studentëve të diplomuar dhe zhvillon me ta anketa, 6 muaj pas diplomimit, për të marrë informacion prej tyre nëse janë punësuar apo jo, a janë punësuar në profilin që janë</p>

<p>konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>diplomuar, apo a janë përshtatur me tregun e punës, a kanë sugjerime për përmirësimin e programit që kanë ndjekur, etj. Përsa i përket përfshirjes së studentëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, GVJ konstaton se kjo garantohet nëpërmjet sondazheve dhe anketave periodike që zhvillohen në çdo semester, nëpërmjet të cilave studentët shprehen për performancën mësimore në tërësi. Gjithashtu studentët mund të bëjnë peticione në lidhje me aspektet akademike të programeve që ata ndjekin. Përfaqësuesit e studentëve në strukturat e UNYT gjithashtu luajnë një rol në dërgimin e zërit të tyre në organet vendimmarrëse të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi 2.2: UNYT Strategjia e Studimit te Tregut.pdf</b>  <b>Aneksi: 3.16 UNYT Studim Tregu, Alb.pdf</b>  <b>Aneksi 5.12 Aktivitete Zyra e Karrieres.pdf</b>  <b>Aneksi 6.14 Formular per Peticion Akademik.pdf</b>  <b>Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet.pdf</b>  <b>Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Sikurse e cilësuam edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, argumenti për hapjen e këtij programi është mbështetur në studimin e tregut dhe analizën e nevojave për profesionistë të kësaj fushe duke i dhënë një nxitje UNYT për të krijuar këtë program të ri në mënyrë që të përafrohet dhe të pajtohet me tendencat dhe zhvillimet e fundit. Për këtë arsye institucioni ka kombinuar përvojën aktuale dhe nevojat e tregut, dhe ka hapur programin e ri Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike". Ky program synon një kombinim të ekspertizës teknologjike dhe aftësive në biznes dhe tregti për të përgatitur një individ për një karrierë të suksesshme në këtë fushë të re të ekonomisë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi: 1.4 UNYT Arsyetim per hapjen e programit.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se për hapjen e këtij programi studimi institucioni është bazuar mbi studimin e tregut dhe ka evidentuar nevojën për profesionistë në fushën e biznesit dhe tregëtisë elektronike duke kombinuar ekspertizën teknologjike me atë të biznesit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit bashkëpunon dhe konsultohet vazhdimisht me institucionet që UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi për të përmirësuar cilësinë e programeve që ofron.</i></p>



	<i>Zyra e Karrierës dhe Alumnai, mban kontakte me studentët e diplomuar për të siguruar që programet që ofrohen përfshijnë të gjithë kompetencat e nevojshme që nevojiten në tregun e punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”, si edhe i programeve lëndore, por edhe nga intervistat me pedagogët dhe studentët e këtij programi, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet, seminarët, orët e laboratorit, detyrat e kursit/ esetë, rastet studimore individuale dhe në grup, dhe praktikat.</p> <p>Në RVB referohet gjithashtu se përveç elementeve të mësipërme të realizimit të programit mësimor, ka edhe forma të tjera specifike sipas lëndëve, të tilla si vizita në terren apo orë të hapura mësimi. Disa nga këto aktivitete organizohen në kuadër të ndonjë lënde të caktuar duke u njoftuar studentët paraprakisht për zhvillimin e tyre, ndërsa disa aktivitete të tjera që mund të jenë më ndërdisiplinore organizohen nga departamenti dhe pasqyrohen në planin vjetor të veprimtarisë së departamentit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.14 Syllabusët e Lëndeve.pdf</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhëse.pdf</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik dhe me studentët, GVJ konstatoi se përveç metododës tradicionale të leksioneve dhe seminareve, stafi akademik mendohej të ofronte sa

<p>nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>më shumë raste praktike gjatë orëve mësimore duke trajtuar raste studimore të cilat sjellin shembuj nga industria dhe biznesi. Gjithashtu ishin organizuar edhe vizita studimore pranë kompanive të ndryshme apo ishin ftuar lektorë të jashtëm profesionistë nga sektori privat. Kjo larmi dhe kombinim i metodave të ndryshme të mësimdhënies mundëson nxitjen e angazhimit nga ana e sa më shumë studentëve. Në takimin me studentët kjo gjë u konfirmua, madje ata u shprehën që do të preferonin që lëndën e Praktikës e cila zhvillohet në vitin e 2-të ta kishin në një kohështrirje më të gjatë.</p> <p>Një aspekt që vlen për tu përmendur në lidhje me respektimin e nevojave të studentëve është edhe mundësia që ata kishin për të zgjedhur lëndët që do të merrnin gjatë semestrit dhe përcaktimin e orarit sipas mundësive të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar tek RVB dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion (Aneks 3.1), GVJ konstaton se UNYT mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike, duke i përfshirë në trajnime që i aftësojnë ata në fushën akademike. Këto trajnime zhvillohen nga Zyra e Sigurimit të Brenshëm të Cilësisë, dhe kanë tematika të ndryshme, të tilla si hartimi i syllabuseve, trajnime për mënyrat e vlerësimit të studentëve, këshilla për rritjen e aftësive prezantuese, etj. Kjo gjë u konfirmua edhe gjatë diskutimeve me pedagogët e këtij programi studimi.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të kompetencave didaktike të stafit, sidomos atij të ri, shërbejnë edhe orët e hapura të mësimin të cilat organizohen në nivel departementi.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni mbështet stafin akademik për pjesmarrjen në programet Erasmus+ të mobilitetit për mësimdhënie në universitetet ndërkombëtare si një mundësi për të përfituar nga përvojat më të mira të mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 3.1: UNYT Manuali i Instruktove, Shqip.pdf</b>  <b>3.15 UNYT Workshop from I.Kasapi.pptx</b>  <b>3.17 UNYT Erasmus + E. Shtembari.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter GVJ shqyrtoi CV-të e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe konfirmon që kompetenca e personelit konfirmohet nëpërmjet kualifikimeve dhe ekspertizës së tyre. Vlen për tu theksuar se Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit i jep një rëndësi të veçantë përputhjes së formimit dhe interesave kërkimore të çdo pedagogu me lëndën që ai jep. Gjithashtu vlerësimi i kompetencës së stafit akademik bëhet nëpërmjet proceseve të vazhduara siç janë Pyetsorët për Vlerësimin e Lëndës dhe Formulartë për Vlerësimin e Kolegëve.</p>



<p>qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Këto metoda synojnë përmirësimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies.</p> <p>Mund të pohojmë që cilësia e stafit akademik është një nga pikat e forta të këtij programi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>1.18 CV Staff.pdf</b>  <b>Aneksi 6.4 Formular Vleresimi nga Koleget.pdf</b>  <b>Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Sikurse e përmendëm edhe në Kriterin 4 të këtij standardi, një nga mënyrat që përdoret për vlerësimin e metodës së mësimdhënies është Pyetsori për Vlerësimin e Lëndës nga Studentët.</p> <p>Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë shpërndan pyetsorin i cili plotësohet në mënyrë anonime. Konkluzionet që nxiren nga përpunimi i të dhënave ndahen me titullarin e lëndës dhe Drejtuesin e Departamentit. Sugjerimet e studentëve merren në konsideratë nga pedagogu dhe nëse ka vend për përmirësime bëhen ndryshimet e duhura. Në mënyrë të përmbledhur vlerësimet pasqyrohen edhe në Raportin Vjetor të Departamentit. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët, GVJ konfirmoi pjesmarjen e tyre aktive në procesin e vlerësimit të lëndës, pedagogëve dhe procesit mësimor në tërësi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet.pdf</b>  <b>Aneksi 6.2.2 Raporti Vjetor NjSBC 2022-2023.pdf</b>  <b>1.14 Raporti vjetor i Departamentit_ Viti Akademik 2022-2023.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është njësi përgjegjëse për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Ajo në bashkëpunim me dekanët kujdesen që të mbështesin rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe promovimin e metodave të reja innovative. Kjo zyrë përdor instrumenta të ndryshme për realizimin e qëllimit të saj dhe harton raporte për të analizuar rezultatet e arritura. Disa nga instrumentat që përdoren janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i Studentëve për lëndën;</li> <li>• Vlerësimi i mësimdhënies nga kolegët;</li> <li>• Vlerësimi i paanësisë, transparencës, krahasueshmërisë dhe auditimit;</li> <li>• Vlerësimi i performancës për përmbushjen e objektivave.</li> </ul>

<p>përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf</b>  <b>Aneksi 6.4 Formular Vleresimi nga Koleget.pdf</b>  <b>Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet.pdf</b>  <b>1.17 Performanca Individuale E. Shtembari.pdf</b>  <b>Aneksi 6.9.3 Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022.pdf</b>  <b>Aneksi 6.8 Internal Audit Procedure.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike" GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet, seminarat, orët e laboratorit, detyrat e kursit/estetë, rastet studimore individuale dhe në grup, dhe praktikat, si dhe vizitat në terren apo orë të hapura mësimi.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se përveç metododës tradicionale të leksioneve dhe seminareve, stafi akademik mundahej të ofronte sa më shumë raste praktike gjatë orëve mësimore duke trajtuar raste studimore të cilat sjellin shembuj nga industria dhe biznesi.</i></p> <p><i>UNYT mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike, duke i përfshirë në trajnime që i aftësojnë ata në fushën akademike.</i></p> <p><i>Mund të pohojmë që cilësia e stafit akademik është një nga pikat e forta të këtij programi.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Zyra e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë është njësi përgjegjëse për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Ajo në bashkëpunim me dekanët kujdesen që të mbështesin rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe promovimin e metodave të reja innovative. Kjo zyrë përdor instrumenta të ndryshme për realizimin e qëllimit të saj dhe harton raporte për të analizuar rezultatet e arritura.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive,**

GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive në këtë program studimi janë të përcaktuara qartësisht në Rregulloren e Programit Bachelor në "Biznes dhe Tregti




<p>dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Elektronike” (Neni 37), në Rregulloren e UNYT (Neni 76), si dhe në Rregulloren e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit (D: Frekuentimi, Provimet, Vlerësimi).</p> <p>Përgjithësisht kontrolli i vazhdueshëm konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provim përfundimtar 40%</li> <li>• Provim i ndërmjetëm 30%</li> <li>• Komponentë të tjerë 20%</li> <li>• Pjesmarrje aktive 10%</li> </ul> <p>Nota minimale kaluese është C.</p> <p>Të gjitha këto dokumenta ju vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luan edhe Qendra e Këshillimit të Studentëve e cila ju vjen në ndihmë atyre gjatë procesit të provimeve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b>  <b>Aneksi 1.9: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Plotësimin e këtij kriteri GVJ e konfirmon, bazuar tek informacioni që mori në takimin me studentët dhe pedagogët e programit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”. Ata pohuan se në fillim të semestrit, për çdo lëndë pedagogët ju prezantonin syllabusin e lëndës duke shpjeguar të gjithë elementët përbërës të tij, përfshirë edhe mënyrën e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, kriteret e vlerësimi, detyrimet për pjesmarrjen, etj. Syllabusi ju shpërnahet studentëve në rrugë elektronike që në javën e parë të mësimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sikurse e cituam edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, forma e testimit të njohurive dhe kriteret e vlerësimi janë të përcaktuara në Rregulloret e Programit, Departamentit dhe UNYT. Gjithashtu këto janë të përcaktuara qartësisht edhe në syllabuset e lëndëve dhe ndjekin një format të standardizuar.</p> <p>Për ti dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, kontrolli i njohurive është i vazhdueshëm dhe bazohet mbi disa komponentë, pesha e të cilëve por mund të varjojë edhe nga lënda, në përgjithësi është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provim përfundimtar 40%</li> <li>• Provim i ndërmjetëm 30%</li> <li>• Komponentë të tjerë (detyra kursi, raste studimi) 20%</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesmarrje aktive në klasë 10%</li> </ul> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b>  <b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se në mbështetje të Rregullores së UNYT, Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit shpërndan në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri pyetsorin e studentëve për vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor në tërësi. Nëpërmjet këtij pyetsori synohet të merret mendimi i studentëve për metodat e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, mënyrën e vlerësimit, dhe elementë të tjerë të programit. Rezultatet e pyetsorit përpunohen nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ju bëhen të ditura pedagogëve dhe Drejtuesit të Departamentit. GVJ u informua se mendimet dhe sugjerimet e studentëve janë marrë gjithmonë në konsideratë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm. Këto mendime janë reflektuar edhe në raportet periodike të departamentit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf</b> <b>Aneksi 6.4 Formular Vleresimi nga Koleget.pdf</b>  <b>Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet.pdf</b>  <b>1.14 Raporti vjetor i Departamentit_ Viti Akademik 2022-2023.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënëit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter GVJ shqyrtoi në detaje syllabusin e lëndëve dhe konstaton që ai përmban metoda të shumëllojshme të përcimit të dijeve tek studentët, si dhe të angazhimit të tyre në mënyrë aktive gjatë procesit mësimor. Kjo pasqyrohet tek format e vlerësimit, ku një peshë të konsiderueshme zënë edhe detyrat e kursit dhe rastet e studimit, apo pjesmarrja aktive në seminare.</p> <p>Bazuar në pyetjet drejtuar studentëve, GVJ konstaton se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët ishte nxitja e studentëve që të merrnin pjesë aktive në diskutimin e rasteve të studimit. Pedagogu i nxiste studentët të reflektojnë gjatë mësimdhënies, duke i caktuar secilit përgjegjësi të qarta për detyra specifike gjatë punës në grup. Kështu studentët promovohen që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese edhe në debatin mes njëri - tjetrit.</p> <p>GVJ mendon se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve, si dhe i</p>





të respektit të ndërsjellë mes tyre.	bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojnë lirisht opinionet e tyre.  <b>Evidenca:</b> <b>Aneks 2.14 Syllabuset e Lëndëve.pdf</b>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive në këtë program studimi janë të përcaktuara qartësisht në Rregulloren e Programit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” si dhe në Rregulloren e UNYT. Studentët konfirmuan që ata njihen me syllabusin e lëndëve që në javën e parë të semestrit, dhe informohen rreth elementëve përbërës të tij, si dhe me mënyrën e testimit të njohurive dhe kriteret e vlerësimit. Në përgjithësi komponentët e vlerësimit ndjekin një format të standardizuar, ku bëjnë pjesë: Provimi përfundimtar 40%; Provimi i ndërmjetëm 30%; Komponentë të tjerë (detyra kursi, raste studimi) 20%; Pjesmarrja aktive në klasë 10%. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit shpërndan në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri pyetsorin e studentëve për vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor në tërësi. Nëpërmjet kësaj synohet përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe përfshirja e studentëve në këtë process. GVJ konstaton se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët ishte nxitja e studentëve që të merrnin pjesë aktive në diskutimin e rasteve të studimit. GVJ mendon se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve, si dhe i bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojnë lirisht opinionet e tyre.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	Bazuar tek analiza e programeve lëndore, GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit të zhvillimit të lëndëve. Nota përfundimtare është rezultante e gjithë komponentëve të vlerësimit. Në programin e studimit Bachelor në

<p>vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>“Biznes dhe Tregti Elektronike” përgjithësisht pesha e komponentëve në vlerësimin përfundimtar është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provim përfundimtar 40%</li> <li>• Provim i ndërmjetëm 30%</li> <li>• Komponentë të tjerë (detyra kursi, raste studimi) 20%</li> <li>• Pjesmarrje aktive në klasë 10%</li> </ul> <p>Të gjitha syllabuset e programit janë të hartuara sipas një standardi, dhe përmbajnë qartësisht (në seksionin 15) komponentë përbërës në kontrollin e vazhdueshëm të dijeve.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>2.14 Syllabuset e Lëndeve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Gjatë takimit me pedagogët dhe studentët, GVJ u informua që në përgjithësi provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare bëhen me shkrim. Kjo është e përcaktuar edhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Pas korigjimit të provimeve studentët marrin vlerësimin nëpërmjet sistemit elektronik KION.</p> <p>GVJ u informua gjithashtu që në lëndë të veçanta përdorej edhe platforma elektronike McGraw Hill. Gjatë takimit studentët, ata pohuan që në të gjitha rastet procesi i vlerësimit është transparent për studentin.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>3.4 KION.pdf</b> <b>3.9 UNYT Platforma e lidhjes me Mc Graw Hill.pdf</b> <b>3.10 UNYT Komunikim per Vleresimet e Studenteve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sikurse u evidentua në Kriterin 1 të këtij standardi, të gjitha syllabuset e programit janë të hartuara në përputhje me me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Syllabuset e të gjitha lëndëve të këtij program përmbajnë disa komponentë përbërës në kontrollin e vazhdueshëm të dijeve, rezultatja e të cilave jep vlerësimin përfundimtar. Në takimin me studentët GVJ konfirmoi që vlerësimi përfundimtar i çdo lënde ishte bërë në përputhje me syllabusin përkatës.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>2.14 Syllabuset e Lëndeve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, RVB referon se vlerësimi i çdo komponenti të kontrollit të vazhduar shoqërohet me komente dhe feedback. Të pyetur gjatë vizitës në institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët të cilët u shprehën se në çdo rast, vlerësimet e provimeve të tyre ishin të argumentuara nga ana e pedagogëve dhe ata ishin të qartë për pikat ku kishin nevojë të përmirësohen. Ata u shprehën se stafi akademik ishte i hapur për të</p>




<p>procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>bërë ballafaqimin e vlerësimeve dhe bën takime me studentët, pas shpalljes së notave, ku studentët kanë të drejtën të shohin provimet e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ u informua që institucioni ka marrë masa për shmangien e plagjiaturës në çdo detyrë, projekt apo provim që zhvillohet në të gjitha programet e studimit. Kjo gjë realizohet nëpërmjet përdorimit të software-t TURNITIN ose platformës McGraw Hill. Gjithashtu studentët njihen me rregullat antiplagjaturë dhe penalitetet nëpërmjet Kodit të Ndershmërisë së studentit dhe përpiqen ta zbatojnë atë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>3.8 UNYT Shembull i Perdorimit te Turnitin ne provimin final ne klase.pdf</b>  <b>3.9 UNYT Platforma e lidhjes me Mc Graw Hill.pdf</b>  <b>Aneksi 5.32.1 - Kodi i Ndershmerise se Studentit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Si rregull, vlerësimi i provimeve bëhet brenda 5 ditëve nga dita e provimit. Vlerësimi i provimit përfundimtar i bashkohet vlerësimeve të tjera gjatë vitit dhe i komunikohet studentit nëpërmjet sistemit elektronik KION. Në takimin me pedagogët GVJ u informua se ky vlerësim bazohet në meritën dhe njohritë e fituara të studentëve gjatë gjithë semestrit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>2.4 UNYT Procedurat e Provimeve 2020, Shqip.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për tu njohur me vlerësimin e provimit dhe për ta rishikuar atë, e drejtë e tyre që është përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” (Neni 45), Procedurën e Provimeve (Neni 10), Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit (Neni 27).</p> <p>Sipas procedures student i paraqet kërkesë Zyrës së Çështjeve Studentore e cila ja përcjell kërkesën Dekanit. Për shqyrtimin e kërkesës Dekani ngre një komision ad-hoc për të rishqyrtuar vlerësimin. Vendimi përfundimtar i këtij komisioni jepet Brenda 5 ditëve.</p> <p>Në takimin me studentët, GVJ konfirmoi që e drejta e tyre për tu njohur me vlerësimin dhe kërkesa për rishikim ju njihet, dhe kishte raste të cilat ishin zgjidhur në përputhje me rregulloret e institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>2.4 UNYT Procedurat e Provimeve 2020, Shqip.pdf</b></p>

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b> <b>Aneksi 1.9: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit të zhvillimit të lëndëve dhe është i pasqyruar në syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>GVJ konstaton që provimet bëhen me shkrim, në lëndë të veçanta përdoret edhe platforma elektronike McGraw Hill.</i></p> <p><i>Stafi akademik është i hapur për të bërë ballafaqimin e vlerësimeve dhe bën takime me studentët, pas shpalljes së notave, ku studentët kanë të drejtën të shohin provimet e tyre.</i></p> <p><i>Institucioni ka marrë masa për shmangien e plagjaturës duke parashikuar rregulla në Kodin e Ndershmërisë së studentit.</i></p> <p><i>Studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për tu njohur me vlerësimin e provimit dhe për ta rishikuar atë, e drejtë e tyre që është përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike".</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike" kombinon mënyra të ndryshme të mësimdhënies si: leksione, seminare, punë në grup, punë individuale, diskutime case study, detyra shtëpie, praktikë, etj. Kombinimi i këtyre metodave është organizuar në mënyrë të tillë që u jep mundësinë studentëve të njohin teorikisht dhe praktikisht fushën ku studiojnë si edhe të zhvillojnë aftësi të mira të nevojshme për profesionistët e ardhshëm të epokës së teknologjisë së informacionit.</p> <p><b>Evidenca:</b> <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Vetë specifikat e programit e garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe lidhjen e kësaj të fundit me biznesin. Gjithashtu, për shkak se programi i



<p>veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>studimit ofrohet në gjuhën angleze, garanton zhvillimin deri në fund të studimeve, të aftësive të mira të komunikimit të përgjithshëm në këtë gjuhë, si edhe zotërimin e terminologjisë së nevojshme për ndërveprim, në fushat e biznesit dhe sistemeve të informacionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>2.4 UNYT Procedurat e Provimeve 2020, Shqip.pdf</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se të gjitha syllabuset e Programit të Studimit, Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”, kanë të përfshira një element të rëndësishëm i cili është “Rezultatet e të Nxënit” (kjo në përputje edhe me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019). Ky element liston përfitimet e pritshme nga çdo lëndë e programit. GVJ gjykon se përfshirja e këtij elementi në syllabus, orienton zhvillimin e lëndëve gjatë semestrit, duke ndihmuar stafin akademik të organizojë leksionet, diskutimet, testimet dhe orët e ushtrimeve. Në përfundim të semestrit, para provimit pedagogët kishin si praktikë pune të bënin një përmbledhje të lëndës duke diskutuar “Konceptet Themelore” të lëndës (gjithashtu të shprehura në një seksion të syllabusit) duke theksuar rëndësinë e çdo koncepti të marrë gjatë semestrit dhe lidhjen e tyre me rezultatet e të nxënit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>2.14 Syllabuset e Lëndeve.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit vëmë re që pothuaj të gjitha lëndët zhvillojnë orë praktike. Kjo gjë ju mundëson studentëve të aplikojnë drejtpërdrejt njohuritë e marra në leksione dhe seminare, duke ndërtuar kështu kompetencat e synuara nëpërmjet secilës lëndë. Përveç orëve të praktikave në secilën lëndë, ky program studimi ka edhe praktikën si lëndë të veçantë të detyrueshme, që zhvillohet në semestrin e 2-të të vitit të 2-të. Kjo ju mundëson studentëve të arrijnë të zhvillojnë dhe aplikojnë në këtë lëndë (Praktika) njohuritë e marra në lëndët e ndryshme.</p> <p>Mbështetur tek syllabuset dhe plani mësimor, evidentohet që metodat e mësimdhënies të përdorura nga personeli akademik përfshijnë projektet në grup dhe diskutimet e rasteve të studimit, duke synuar rritjen e aftësive të të menduarit kritik dhe orjentimin e punës në ekip për zgjidhjen e problemeve. Vetë studentët shpreheshin të kënaqur me përdorimin e këtyre</p>

<p>shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>metodave duke i konsideruar më motivuese dhe më produktive për të zhvilluar idetë e tyre inovative.</p> <p>Përsa i përket bashkëpunimit me institucione të tjera ndërkombëtare në kuadër të mobilitetit të studentëve, evidentohet se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe inkurajon studentët për mobilitete në universitetet të huaja. <i>Megjithatë GVJ konstaton se përfshirja e tyre në këto mobilitete është shumë e vogël (Tabelat përmbledhëse: Tabela 20) dhe sugjeron nxitjen e studentëve për pjesmarrje më të gjërë në to.</i></p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>2.14: Syllabuset e Lëndeve.pdf</b>  <b>2.5 Tabelat përmbledhëse .pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit raporton një sërë aktivitete të organizuara në kuadër të prezantimit të zhvillimeve të reja të shkencës dhe shkëmbimit të eksperiencave midis lektorëve të huaj dhe atyre vendas. Ndër to mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete trajnuese midis UNYT dhe Los Encales ku lektorë nga të dy universitetet shkëmbejnë eksperiencat e mësimdhënies.</li> <li>• Leksion i hapur me temë “Diversity, a competitive advantage or not?” nga Assoc. Prof. Fátima Guadamillas Gómez dhe Assoc. Prof. Amarildo Zane, University of Castilla-la Mancha, Spain</li> <li>• Leksion i hapur i Edlira Taga nga Austrian Development Agency me temë “Challenges of HR in project activities, and the intersection with technological advancements”.</li> <li>• Leksion i hapur i Nevi Kelmendi, Drejtor Marketingu tek “Fiber Group” ltd. me temën “473,040,000 seconds of working and monitoring for 30 seconds adv.”</li> </ul> <p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi, ata konfirmua ndjekjen e këtyre aktiviteteve dhe u shprehën që ato ishin shumë informuese.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>2.7 Aktivitete ne departament.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kombinimi i metodave të mësimdhënies në këtë program studimi është organizuar në mënyrë të tillë që u jep mundësinë studentëve të njohin teorikisht dhe praktikisht fushën ku studiojnë.</i></p> <p><i>Në përfundim të semestrit, pedagogët bëjnë një përmbledhje të lëndës duke diskutuar konceptet themelore duke theksuar rëndësinë e çdo koncepti të marrë gjatë semestrit dhe lidhjen e tyre me rezultatet e të nxëniet.</i></p>




	<p><i>Plani mësimor tregon që pothuaj të gjitha lëndët zhvillojnë orë praktike. Kjo gjë ju mundëson studentëve të aplikojnë drejtpërdrejt njohuritë e marra në leksione dhe seminare, duke ndërtuar kështu kompetencat e synuara nëpërmjet secilës lëndë. Metodatat e mësimdhënies të përdorura nga personeli akademik përfshijnë projektet në grup dhe diskutimet e rasteve të studimit, duke synuar rritjen e aftësive të të menduarit kritik dhe orjentimin e punës në ekip për zgjidhjen e problemeve.</i></p> <p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me universitetet të huaja, por GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në këto mobilitete është shumë e vogël dhe sugjeron nxitjen e studentëve për pjesëmarrje më të gjërë në to.</i></p> <p><i>Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit ka kryer një sërë aktivitete të organizuara në kuadër të prezantimit të zhvillimeve të reja të shkencës dhe shkëmbimit të eksperiencave midis lektorëve të huaj dhe atyre vendas.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara (Aneks 3.3) GVJ konstaton se UNYT ka hartuar një Rregullore të posaçme të Projektit të Diplomimit për studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor. Nëpërmjet saj studentët informohen për kushtet që duhet të plotësojnë për tu regjistruar në Projektin e Diplomës. Sipas kësaj rregulloreje studenti duhet të ketë përfunduar praktikën, të mos ketë provime të ngelura nga viti i parë, dhe të ketë marrë së paku 144 ECTS.</p> <p>Gjithashtu kushtet për tu regjistruar në Projektin e Diplomimit përcaktohen edhe në Rregulloren e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit (Neni 19, 20) dhe Rregulloren e Programit të Studimit (Neni 49).</p> <p>Sipas Planit Mësimor të programit (Aneks 2.5) Projekti i Diplomës është një kurs i detyrueshëm në vitin e 3-të të studimeve, përmban 30 orë në auditor dhe 170 orë jashtë auditori, në të cilin studenti mund të regjistrohet vetëm nëse plotëson kriteret e sipërcituara. Këto informacione ju bëhen të ditura studentëve në fillim të vitit të 3-të nga udhëheqësi i Projektit të Diplomës.</p> <p><b>Evidenca:</b></p>

	<p><b>Aneks 3.3: UNYT Rregullore e Projektit te Diplomimit.pdf</b></p> <p><b>Aneks 2.5: Tabelat permbledhese .pdf</b></p> <p><b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p> <p><b>Aneks 1.9: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat</b> përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Projektit të Diplomimit (Neni 5), Departamenti i cakton një udhëheqës për diplomim studentit, i cili e ndihmon studentin që në përzgjedhjen e e temës deri në nxjerrjen dhe procesimin e rezultateve, dhe shkrimin e projektit të diplomës. Gjatë takimit me studentët, përfaqësues të tyre që ishin në vitin e 3-të pohuan se ishin në kontakt të vazhduar me udhëheqësit e tyre dhe asistoheshin prej tyre për realizimin e Projektit të Diplomës.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneks 3.3: UNYT Rregullore e Projektit te Diplomimit.pdf</b></p> <p><b>Aneks 1.9: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3. Komisioni i</b> posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit (Neni 19, 20, 21) si dhe Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”, diplomimi i studentëve në këtë program studimi bëhet me anë të Projektit të Diplomimit dhe nuk aplikohet provimi final.</p> <p>Sipas Rregullores së Programit (Neni 29), Projekti i Diplomimit është i detyrueshëm dhe rregjistrohet si një lëndë e rregullt. Angazhimet dhe notat në drejtim të Projektit të Diplomimit përcaktohen nga Udhëheqësi sipas plan programit në fillim të semestrit. Nga ana tjetër në RVB cilësohet që këshilluesi miraton ose jo paraqitjen e Projektit të Diplomimit para komisionit. <i>Ka një paqartësi në rregulloret e sipërcituara në lidhje me mbrojtjen e Projektit të Diplomimit para një komisioni apo vlerësimit të tij vetëm nga udhëheqësi, meqënëse konsiderohet si një lëndë e detyruar. Sugjerohet që kjo gjë të qartësohet në rregulloret përkatëse.</i></p> <p>Në takimin me pedagogët dhe Drejtuesin e Departamentit, GVJ u informua që Projektet e Diplomimit synohet të orjentohen drejt përmbylljes së objektivave të programit dhe të reflektojnë njohuritë e synuara që studentët duhet të kenë në përfundim të tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneks 3.3: UNYT Rregullore e Projektit te Diplomimit.pdf</b></p> <p><b>Aneks 1.9: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b></p>



	<p><b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe më sipër, çdo studenti i caktohet një Udhëheqës për Projektin e Diplomimit. Në bazë të Rregullores së Projektit të Diplomimit (Neni 5), udhëheqësi ndihmon studentin që në përzgjedhjen e temës deri në nxjerrjen dhe procesimin e rezultateve, dhe shkrimin e projektit të diplomës. Më gjerësisht plan program i udhëheqjes përcaktohet në syllabusin e Projektit të Diplomimit. Udhëheqësi garanton cilësinë e punimit dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë, <i>por siç u cilësua edhe në kriterin e mësipërm, nuk është e qartë nëse Projektin e Diplomës e vlerëson vetëm udhëheqësi apo duhet paraqitur përpara komisionit të Projektit të Diplomimit, sikurse cilësohet në RVB.</i></p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 3.3: UNYT Rregullore e Projektit të Diplomimit.pdf</b>  <b>Aneks 1.9: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, Alb.pdf</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë takimi me stafin akademik, GVJ u informua që të gjithë studentëve ju vihen në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme që institucioni disponon për realizimin me sukses të Projektit të Diplomimit, të tilla si: laboratorët e informatikës, software të ndryshëm specifikë që lidhen me këtë program studimi, biblioteka me literaturë të bollshme, platforma online për të bërë kërkime të specializuara, etj.</p> <p>Kjo gjë u pohua edhe gjatë intervistës me studentët që ishin në prag të diplomimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p><i>Në lidhje me këtë kriter, RVB referon Nenin 37 të Rregullores së Programit, por GVJ vëren se ky nen përmban vetëm sistemin e pikëzimit për çdo lloj vlerësimi në përgjithësi, dhe jo mënyrën e vlerësimit me notë të Projektit të Diplomës.</i></p> <p>Megjithatë, sikurse u evidentua edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, sipas Planit Mësimor të programit (Aneks 2.5) dhe Rregullores së Projektit të Diplomimit (Neni 3) evidentohet që Projekti i Diplomës është një kurs i detyrueshëm në vitin e 3-të të studimeve, përmban 30 orë në auditor dhe 170 orë jashtë auditori dhe në përfundimin me sukses të tij studentit përfiton 8 kredite ECTS.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 3.3: UNYT Rregullore e Projektit të Diplomimit.pdf</b>  <b>Aneks 2.5: Tabelat përmbledhese .pdf</b></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Programit (Neni 5), studenti që përfundon me sukses ciklin e studimit, pajiset me diplomën dygjuhëshe me emërtimin Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”. Diploma, vërtetimi zyrtar i notave dhe Suplementi i Diplomës i jepen studentit në varësi të titullit që merr.</p> <p>Në bazë të Rregullores së UNYT (Neni 70), në përfundim të Ciklit të Parë të Studimeve institucioni pajis studentin me Suplementin e Diplomës si dhe kopjen zyrtare të programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneks 1.10: Rregullore e Programit të Biznesit dhe Tregtisë Elektronike ALB.pdf</b>  <b>Aneks 1.7: Rregullorja e Universitetit.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në Sekretarinë Mësimore, GVJ konfirmoi se institucioni ruante dosjen personale për studentët në format hard copy. Në këtë dosje ruhen dokumenta të tilla si: formulari i aplikimit; diploma e shkollës së mesme; fotokopje e noterizuar e listës së notave; dokumenti i identifikimit; fotografi; dhe të gjitha dokumentat që kanë të bëjnë me historikun akademik të studentit gjatë ciklit të studimit (Rregullore e Sekretarisë, Neni 25). GVJ u njoh me një dosje që u zgjodh në mënyrë të rastësishme.</p> <p>Pasi studenti diplomohet, në bazë të Rregullores së UNYT për Arkivën, dosja e studentit depozitohet në Arkivën qendrore të institucionit.</p> <p>GVJ u informua, që edhe pas arkivimit, këto dokumenta mund të vihen në dispozicion të studentit me kërkesë të tij.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <b>Aneksi 5.31 Rregullore e Arkives.pdf</b>  <b>Aneksi 5.32 UNYT Rregullore e brendshme per veprimtarine e sekretarise mesimore, Alb.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UNYT ka hartuar një Rregullore të posaçme të Projektit të Diplomimit për studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor.</i></p> <p><i>Gjatë takimit me studentët, përfaqësues të tyre që ishin në vitin e 3-të pohuan se ishin në kontakt të vazhduar me udhëheqësit e tyre dhe asistoheshin prej tyre për realizimin e Projektit të Diplomës.</i></p> <p><i>Diplomimi i studentëve në këtë program studimi bëhet me anë të Projektit të Diplomimit i cili synohet të orjentojnë drejt përmbylljes së objektivave të programit dhe të reflektojnë njohuritë e synuara që studentët duhet të kenë në përfundim të tij.</i></p> <p><i>Udhëheqësi garanton cilësinë e punimit dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për tu dorëzuar. Angazhimet dhe notat në drejtim të Projektit të Diplomimit përcaktohen nga Udhëheqësi</i></p>

	<p><i>sipas plan programit në fillim të semestrit. Ka një paqartësi në lidhje me mbrojtjen e Projektit të Diplomimit para një komisioni apo vlerësimit të tij vetëm nga udhëheqësi. Sugjerohet që kjo gjë të qartësohet në rregulloret përkatëse. GVJ konstaton se të gjithë studentëve ju vihen në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme që institucioni disponon për realizimin me sukses të Projektit të Diplomimit. Projekti i Diplomës është një kurs i detyrueshëm në vitin e 3-të të studimeve, përmban 30 orë në auditor dhe 170 orë jashtë auditori dhe në përfundimin me sukses të tij studenti përfiton 8 kredite ECTS. Studenti që përfundon me sukses ciklin e studimit, pajiset me diplomën dygjuhëshe me emërtimin Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”. Pasi studenti diplomohet, në bazë të Rregullores së UNYT për Arkivën, dosja e studentit depozitohet në Arkivën qendrore të institucionit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e	Politika e rekrutimit të NYUT, në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi është formalizuar në rregulloren për politikën dhe procedurat e rekrutimit, ku theksohet se Institucioni duhet të punësojë njerëz të kualifikuar dhe inovatorë, bazuar në kriteret e përcaktuara për këtë qëllim, ku përmendet kriteri i kualifikimit, përshtatjes me lëndën mësimore, filozofia e mësimdhënies, përvoja, kualifikimi akademik, titujt dhe gradat shkencore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pikërisht

programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/modulev e të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

tabelës përmbledhëse të vënë në dispozicion, dhe diskutimit gjatë vizitës në institucion, u informuam se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi në total është 8 persona, nga të cilët 1 me titullin Profesor, 4 me gradën shkencore Doktor dhe 3 me Master Shkencor. Përgjegjësjë e Departamentit ka aktualisht gradën Doktor, por është në fazën përmbyllëse të fitimit të titullit Profesor i Asociuar .100% e stafit është punësuar me kohë të plotë. Pra, është siguruar përputhshmëria me Ligjin e Arsimit të Lartë, neni 25, i cili kërkon që në Departament të ketë të paktën 7 antarë të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën 3 me grada shkencore ose tituj akademikë.

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
<b>Prof.Dr</b>						
<b>Prof.As.Dr</b>	2	1	3	1	3	
<b>Dr</b>	1		2		6	
<b>MSc</b>	5	1	9	1	10	
<b>Total</b>	<b>8</b>	<b>2</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>20</b>	<b>0</b>

Nga konsultimi i CV-ve të personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi rezulton se ata kanë kompetencat akademike dhe përvojën për mësimdhënie dhe aktivitet shkencor për lëndët që zhvillojnë dhe programin e studimit në përgjithësi. Pjesë e stafit janë Profesorë me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie , por edhe me eksperiencë praktike të lidhur me fushat e programit të studimit. Gjithashtu konstatojmë se koordinatori i programit zotëron aftësitë profesionale dhe eksperiencën praktike, të nevojshme për të përmbushur funksionet e tij.

Bazuar në kurrikulën e programit të studimit, kemi një përfshirje të stafëve me formim në Ekonomi dhe biznes dhe shkenca kompjuterike. Gjithashtu, ka një koordinim të stafëve me përvojë me stafet e reja me titull MSC, të cilat, na konfirmuan gjatë takimit, se synojnë ngritjen në karrierë pranë këtë institucion.

#### Evidencat:

**Aneksi 4.24. Politikat dhe procedurat e Departamentit të Burimeve Njerëzore**

**Aneksi 2.5 Tabela përmbledhëse**

**Aneksi 1.18: CV**



<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe listës së stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” GVJ konstaton se formimi profesional akademik dhe përvoja e pedagogëve janë të përshtatshme. Pra kemi përputhje të lëndës që ata zhvillojnë me programin e studimit. Referuar të dhënave për të tre vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi bachelor, është përballuar plotësisht nga stafi akademik me kohë të plotë, pra në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05. 2017. Përgjegjësi i Departamentit menaxhon përcaktimin dhe monitorimin e ngarkesës mësimore.</p> <p><b>Evidencat:</b></p> <p><b>Aneksi 2.5 Tabela përmbledhëse</b></p> <p><b>Aneksi 2.1 Plani mësimor</b></p> <p><b>Aneksi 1.18: CV</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe diskutimin gjatë vizitës, me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, por edhe me stafin e programit konstaton se Institucioni garanton rekrutimin e stafit akademik efektiv, përmes kontratave të punës. Të gjithë pedagogët që japin mësim në këtë program studimi janë punësuar me kohë të plotë dhe kanë marrëdhënie kontraktuale të qëndrueshme me IAL. Zyra e Burimeve Njerëzore informon se është kryer pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, gjë që e konfirmuam edhe gjatë shqyrtimit të disa dosjeve të personelit. Institucioni formalizon marrëdhënien e punësimit të stafeve akademike përmes kontratave, të cilat janë dy tipe sipas nivelit të angazhimit, kontrata me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Gjithashtu aplikohen kontrata me afat të përcaktuar dhe të papërcaktuar, Nga takimi me stafin e programit , rezultoi se pavarësisht faktit që kontratat për MSC janë 1 vjecare, pasi kjo është kërkesë ligjore, kjo nuk e cënonte qëndrueshmërinë e stafeve. Sipas stafeve të rinj rezultoi se nuk është kontrata e punës që i mban aty, por pasioni për mësimdhënien, mjedisi i punës, komunikimi dhe vlerësimi nga punëdhënësi. Me MSC janë 3 antarë të stafit, të cilët rinovojnë kontratat çdo vit . Formatet e kontratave të vëna në dispozicion janë në përputhje me kërkesat e procedurave të rekrutimit dhe Kodit të Punës.</p> <p><b>Evidencë</b></p> <p><b>Aneksi 4.24. Politikat dhe procedurat e Departamentit të Burimeve Njerëzore</b></p> <p><b>Aneksi 4,28, Kontratë pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar</b></p> <p><b>Aneksi 4.28.1 Kontratë pune me kohë të pjesshme</b></p> <p><b>Aneksi 4.28.2 Kontratë pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><b>Aneksi 4,27 Aneks kontrate.</b></p> <p>Konstatohet se IAL ka ndjekur procedurat e rekrutimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Procedurat formalizohen edhe në Statutin e Universitetit, nenet 41 dhe 42, ku përcaktohet procedura e rekrutimit që nga kërkesa për staf akademik, e cila paraqitet nga Drejtuesi i Departamentit, bazuar në nevojën sipas ngarkesës mësimore, deri tek miratimi, shpallja e vendit të lirë, vlerësimi dhe kontraktimi i aplikantit. Procedura garanton transparencë, drejtësi, trajtim të barabartë. Institucioni ka standardizuar procedurën e shpalljes dhe atë të rekrutimit përmes formateve respektive. Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme realizohet nga njësi bazë në bashkëpunim me burimet njerëzore. Ka kriteret të mirëpërcaktuara që lidhen me kualifikimin, me fokus në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Procedura kalon nëpër dy faza: aplikimi me dokumenta dhe intervistat, Komisioni i rekrutimit drejtohet nga Rektori dhe në të marrin pjesë Dekanët dhe Përgjegjësit e Departamenteve. Në formatin për shpalljen e pozicionit përcaktohen edhe dokumentat që duhet të paraqiten gjatë aplikimit. Vlen të përmenden dy dokumenta : deklaratë mbi interesin në kërkim dhe deklaratë mbi filozofinë e mësimdhënies, Këto ndihmojnë në procesin e përzgjedhjes dhe përmbushjes së kriterëve, pikërisht atij që lidhet me përvojën dhe aftësinë për kërkim shkencor dhe atij që lidhet me nivelin e mësimdhënies. Pra procesi kërkon të kombinojë aftësitë në mësimdhënie me ato në kërkimin shkencor, si dy elementë bazë të strategjisë së vet Universitetit dhe politikave kombëtare në fushën e arsimit të lartë. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, përveçse në website të UNYT edhe në portalin Euroaxxess, pasi procedura është e hapur edhe për staf akademik ndërkombëtar.</p> <p>Një kriter i rëndësishëm për rekrutimin e stafeve është njohja e gjuhës angleze në nivele shumë të avancuara. Procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion edhe gjatë takimeve. Vlerësimi i kandidatëve për personel akademik nuk bëhet me sistem pikëzimi, kurse për personelin ndihmës akademik po.</p> <p><i><b>Sugjerim : Për një procedurë më transparente dhe objektive vlerësimi duhet të kryhet me pikë sipas një formati të miratur paraprakisht</b></i></p> <p><b>Evidencat</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i Universitetit</b></p> <p><b>Aneksi 4.25 Format i shpalljes së pozicionit</b></p> <p><b>Aneksi 4.25.1 Format standard i procedurës së rekrutimit.</b></p> <p><b>Vizita në institucion.</b></p> <p><b>Faqja web :www.nyut.edu.al</b></p>
--	---




<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar si staf ndihmës akademik për këtë program stafet e zyrave të përbashkëta, siç janë Zyra operacionale, sekretaria, zyra e IT. Zyra operacionale është përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjediseve. Në zyrën IT janë angazhuar 2 specialistë, të cilët asistojnë zhvillimin e mësimin në disa lëndë që zhvillohen në laboratorët e pajisur me kompjutera si Big Data, Microsoft project management, etj.</p> <p>IAL ka miratuar një dokument të posacëm për Zyrën e suportit informtiko teknologjik, e cila është përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve në funksion të procesit mësimor.</p> <p><b>Evidencë:</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneksi 4.17: IT shërbimet</b></p> <p><b>Aneksi 4.3: Departamenti i shërbimeve mbështetëse</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstatoi se UNYT disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, ku disponohen dosjet personale të stafit akademik si edhe baza elektronike e të dhënave. Çdo vit Zyra e burimeve Njerëzore bën përditësime në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv, ngarkesën e tyre mësimore si dhe kualifikimet e tyre. Gjithashtu GVJ evidentoi që çdo fund viti akademik, pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit evidencat e realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky i koordinuar nga Drejtuesi i Departamentit. Të dhënat e mbledhura respektojnë legjislacionin që lidhet me mbrojtjen e të dhënave personale, duke siguruar në mënyrë të formalizuar dakordësinë e stafeve nëpërmjet nënshkrimit të Deklaratës së Pëlqimit Formalizimi bëhet edhe në kontratat e punës.</p> <p><b>Evidenca :</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneks 4.23 Deklaratë pëlqimi</b></p> <p><b>Aneksi 4.23.1. Mospërhapje e informacioni konfidencial</b></p>

<p>personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Zyra e karrierës dhe alumni pranë UNYT udhëzon studentët lidhur me karrierën dhe praktikat profesionale. Praktika profesionale është një lëndë specifike e përfshirë në program si Internship në semestrin e dytë të vitit të dytë. Sipas syllabusit të vënë në dispozicion dhe sqarimeve në takim me Drejtuesin e Departamentit dhe zëvendësrektoren, rezultojnë se në kuadër të kësaj lënde 10 orë zhvillohen si teori në institucion dhe 90 si projekt pranë një organizate, të cilën studenti mund ta propozojë vetë ose mund të këshillohet nga Zyra e karrierës, e cila shfrytëzon për këtë qëllim Marrëveshjet e nënshkruara nga institucioni me kompani e organizata të ndryshme.</p> <p>Lidhur me diplomimin, sipas politikës së institucionit të gjithë studentët përgatisin projekt diplome. Ky program ende nuk ka diplomuar studentë, por diplomimi i tyre do t'u nënshtrohet procedurave të specifikuar në Rregulloren për projektin e Diplomës. Kjo rregullore përcakton si do të përzgjidhen tematikat dhe supervizorët, të cilët instruktajnë dhe mentorajnë të gjithë procesin e përgatitjes së projektit të diplomimit.</p> <p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në "Biznes dhe tregti elektronike" institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të shumta. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi me 66 kompani dhe institucione. Nga takimi i zhvilluar me përfaqësues të zyrës së karrierës rezultojnë se institucionet kryesore të cilat janë më aktive në bashkëpunim janë institucionet bankare. Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundur realizimin e praktikave dhe realizimin e temave të diplomave.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 5.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</b></p> <p><b>Aneks 1.16 Raporti i internshipit</b></p> <p><b>Aneks 3.3 Rregullore e projektit të diplomimit</b></p>



<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Pedagogët mbikqyrës të praktikave dhe projektit të diplomimit janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët për praktikën dhe temën e diplomës. Përveç tyre studentët marrin këshillim edhe nga zyra e karrierës dhe nga këshilltari akademik. Çdo student ka këshilltarin e tij akademik, një pedagog që e ndjek përgjatë gjithë ciklit të studimit, me të cilin studenti komunikon përveç të tjerash edhe lidhur me praktikën dhe diplomimin.</p> <p>Studentët deklarojnë se kanë një bashkëpunim të mirë me këshilltarin akademik dhe me zyrën e karrierës. Gjithashtu janë pritur mirë dhe janë ndihmuar nga stafet e kompanive pranë të cilave kanë zhvilluar praktikën/internshipin.</p> <p><b>Evidenca : Takimet në institucion, me zyrn e karrierës, pedagogët dhe studentët.</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Institucioni përmbush kërkesat lidhur me angazhimin e stafeve në këtë program studimi, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe nga pikëpamja cilësore.</i></p> <p><i>-Për realizimin e programit të studimit Bachelor "Biznes dhe tregti elektronike" IAL ka angazhuar 100% staf akademik efektiv, të cilët mbajnë tituj dhe gradë shkencore apo Msc, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi..</i></p> <p><i>- Formimi akademik dhe përvoja e pedagogëve përputhet me lëndët mësimore që ata zhvillojnë në këtë program studimi, gjë që dokumentohet në Cv e stafeve dhe ngarkesën mësimore</i></p> <p><i>-IAL, ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe parimet bashkëkohore të rekrutimit të stafeve dhe ka formalizuar marrëdhënien e punës përmes kontratave përkatëse që garantojnë qëndrueshmërinë e stafeve dhe përmbushen e detyrimeve por edhe të drejtat e tyre. Në qëndrueshmërinë e stafeve ndikon edhe mjedisi i punës dhe politikat mbështetëse që zbatohen.</i></p> <p><i>-IAL disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës të përfshirë në programin e studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike", e cila përditësohet periodikisht dhe zbaton</i></p>

	<p><i>kuadrin ligjor në fuqi që lidhet me mbrojtjen e të dhënave personale.</i></p> <p><i>-Institucioni ka politika të qarta dhe procedura për ndjekjen e praktikave mësimore dhe projekteve të dipomimit, të formalizuara në Rregulloret përkatëse.</i></p> <p><i>-Zyrat mbështetëse të procesit mësimor janë në funksionim të plotë dhe mundësojnë një infrastrukturë mësimdhënieje të standardeve të larta dhe mbështetje maksimale të studentëve dhe pedagogëve.</i></p> <p><b>Sugjerime :</b></p> <p><i>-Procesi i vlerësimit të standardizohet përmes një formati vlerësimi me pikë, gjë që do të rrishte transparencën dhe objektivitetin në vlerësim.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita rezultoi se UNYT ofron një infrastrukturë bashkëkohore dhe me standarde të larta, Vërejmë se mjediset për zhvillimin e mësimi, aplikimi i teknologjisë së informacionit, shërbimet për studentët plotësojnë standardet për zhvillimin e një procesi mësimor me cilësi të lartë dhe me nivel bashkëkohor. UNYT ka bërë edhe një investim të ri dhe në vitin akademik 2022-2023 zhvillon aktivitetin në dy kampuse. Kjo ka sjellë zgjerimin e hapësirave për zhvillimin e mësimi dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin akademik dhe ndihmës akademik. Programi i studimit i zhvillon mësimet në godinën e re me kushte optimale për zhvillimin e këtij procesi, si dhe me kushtet e nevojshme për zhvillimin e seminareve. Institucioni përveç sigurimit të hapësirave të nevojshme, ka siguruar gjithashtu standardet që lidhen me ngrohjen, nëpërmjet një sistemi qendror ngrohjeje. Ai ofron jo vetëm klasa e auditorë por dhe mjedise për aktivitetet promovuese. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, mjedise promovuese e çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin të mirëpajisura, bibliotekë si dhe hapësira të jashtme. Gjithashtu jepen dhe të</p>

	<p>dhëna mbi kushtet teknike të godinës, ku garantohet ngrohja, kondicionimi, mbrojtja nga zjarri etj, të cilat u panë edhe gjatë vizitës në institucion. Njësia bazë ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Organizimi i orarit mësimor është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>Vlen të përmendet edhe fakti që UNYT ka një bibliotekë në godinën kryesore por ka krijuar edhe bibliotekën në godinën e dytë në të cilën zhvillon kryesisht mësim programi “Biznes dhe Tregti elektronike”, e cila është e pajisur me literaturën bazë, ndihmëse dhe revista në ndihmë të procesit mësimor .</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneksi 4,12 Sipërfaqja në funksion të mësimdhënies</b></p> <p><b>Aneksi 4.9. Politika dhe procedura e bibliotekës</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, rezulton se sallat e leksioneve janë pajisur me teknologji bashkëkohore si psh projektorë, televizorë, kamera digjitale, etj. Institucioni ka një zyrë të vecantë të IT e cila siguron pajisjen me mjetet bashkëkohore sipas nevojave të mësimdhënies dhe asiston studentët dhe pedagogët. GVJ vizitoi auditorët mësimorë, laboratorët dhe sallat e leksioneve dhe konstatoi se pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneksi 4.17 IT shërbimet</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se UNYT ka laboratorë mësimorë në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Biznesit dhe tregtisë elektronike, apo departamente të tjera. Mjediset janë të ndriçuara dhe janë gjithmonë funksionale dhe në dispozicion të studentëve. Në dispozicion të studentëve të programit të studimit është dhe biblioteka, e cila është e pajisur me materiale mësimore dhe libra.</p>



<p>përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në informacionin e dhënë nga institucioni detajohet funksionimi i bibliotekës dhe rezulton që ajo të jetë e pajisur me një fond titujsh si edhe me bibliotekën digjitale. Vlerësojmë faktin që mjediset përdoren edhe për klubet e studentëve ku ata organizojnë takime të ndryshme, gjë që përmirëson cilësinë e jetës dhe shoqërizimin e tyre. Në laboratorin e informatikës janë disponibël edhe software përmes të cilave zhvillohen orë mësimore si Big Data, microsoft projects etj. IAL ka një dokument të miratuar që specifikon praktikën dhe politikën e instalimit të software.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Vizita e ambjenteve në IAL</b></p> <p><b>Aneksi 4.17 IT shërbimet</b></p> <p><b>Aneksi 4.15 Politika e instalimit të softëare</b></p> <p><b>Aneksi 4.2 Formular kërkesë për event</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të realizimit të programit të studimit UNYT disponon disa laboratorë të teknologjisë së informacionit . Në vizituar një prej tyre, i cili ishte i pajisur me kompjutera si edhe me programe profesionale të instaluar, të lidhura me natyrën e këtij programi studimi. Të tilla përmendim BIG Data dhe Microsoft project. Studentët dhe pedagogët kanë akses në aplikacione të teknologjisë së fundit si Turnitin, në bazën e të dhënave të ESC, etj Edhe në Bibliotekën e kësaj godine janë instaluar kompjutera të cilët shfrytëzohen nga studentët si për aksesin në literaturë ashtu edhe për përgatitjen e projekteve të ndryshme në kuadër të programit mësimor. Ata mund të aksesojnë edhe librarinë online JSTOR.</p> <p>Studentët konfirmuan gjatë takimit se janë të kënaqur me infrastrukturën dhe e cilësojnë atë si ndihmëse të proceseve praktike të mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneksi 3.8: UNYT shembull i përdorimit të Turnitit</b></p> <p><b>Aneksi 4-15; Politika e instalimit të Softëare</b></p> <p><b>Aneksi 4.17: IT shërbimet</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor, sipas standardeve bashkëkohore të mësimdhënies dhe të sigurisë.</i></p> <p><i>-UNYT ka laboratorë të IT në funksion të programit të studimit,</i></p>






	<p>të cilët përdoren për një qasje më praktike të procesit të mësimdhënies dhe për ta bërë atë sa më tërheqës .</p> <p>–Në funksion të programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe Tregti Ndërkombëtare ”, janë vënë biblioteka dhe laboratorët e Informatikës, të pajisur me kompjutera dhe programe specifike që përdoren nga studentët pa pagesë, për qëllim mësimi apo përgatitje të projekteve në kuadër të programit mësimor.</p> <p>-Studentët dhe pedagogët kanë akses në wifi free</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni siguron literaturën e nevojshme për këtë program studimi në gjuhën angleze, e cila është dhe gjuha në të cilën zhvillohet mësimi në këtë program. Bëhet fjalë për një literaturë e cila është e përshtatur në nivel ndërkombëtar. Literatura mund të aksesohet nëpërmjet librave fizikë që disponohen në bibliotekë, por edhe në rrugë digjitale, Biblioteka ka bërë skedimin e tyre sipas fushave , ekonomi, biznes, tregti, etj, gjë që e lehtëson aksesin e studentëve dhe pedagogëve. Literatura përditësohet çdo vit, përmes kërkesave për blerje tekstesh mësimore që bëhet sipas një procedure të përcaktuar, për të cilat vihet në dispozicion edhe një buxhet vjetor. Gjatë bisedës me pedagogët që japin mësim në këtë program u informuam se institucioni është shumë i interesuar për sigurimin e një literature sa më të përditësuar, për ta bërë procesin mësimor sa më inovativ. Ai plotëson kërkesat e tyre për literaturën e fundit, gjë që ndihmon mjaft në sjelljen e shembujve më të përditësuar nga praktika gjatë leksioneve dhe seminareve . Kërkesat për blerjet e teksteve paraqiten nga çdo titullar i lëndës pranë Drejtuesit të Departamentit. gjatë hartimit të plan buxhetit në nivel Departamenti, i cili përcillet në zyrat përkatëse për miratim .</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 2.14 Syllabuset: .</b></p> <p><b>Aneksi : 4.9 Politika dhe Procedura e bibliotekes</b></p>

	<p><b>Aneksi 4.33.2 Plan buxheti ne nivel Departamenti</b></p> <p><b>Aneks 3.18 Kërkesë e literaturës</b></p> <p><b>Vizita në institucion, takimi me pedagogët</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me Stafin Drejtues, u deklarua që çdo fillim viti akademik, titullari i lëndës/ pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor , programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi një numër titujsh, që u evidentuan dhe gjatë shqyrtimit të syllabuseve. GVJ evidentoi që në pak raste literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e pa përditësuar. Në takimin me stafin akademik u theksua se çdo vit akademik paraqiten kërkesa për tekste dhe literaturë bashkëkohore dhe parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore.</p> <p><b>Evidenca :</b></p> <p><b>Aneks 4,9 Politika dhe procedura e bibliotekes</b></p> <p><b>Aneksi 3.27 Plan buxheti</b></p> <p><b>Aneks 2.14: Syllabuset</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNYT ofron për studentët dhe stafin akademik një bibliotekë me hapësira të dedikuara dhe të bollshme. Mjediset e bibliotekës kanë kapacitete të mjaftueshme. Orari i bibliotekës u jep mundësi studentëve të shfrytëzojnë atë mjedis edhe paradite edhe pasdite, pavarësisht nga hapësirat që u lejon programi mësimor. Kështu biblioteka është e hapur çdo ditë nga ora 9.00-19.00 dhe në fundjavë 9.00-15-00 Studentët kanë mundësi shfrytëzimi në mënyrë të barabartë. UNYT ka vënë në dispozicion dhe përdorimin e librave elektronikë. Biblioteka ofron tituj nga autorë prestigjiozë e publikime prestigjioze si nga Oxford University, Cambridge University , Pearson etj. Gjatë takimit me punonjësen e bibliotekës u informuam se ajo vizitohet mesterisht nga 80 persona në ditë. Gjatë pasditeve dhe në fundjavë, në mungesë të punonjësës së bibliotekës UNYT angazhonte studentë.</p> <p>UNYT disponon bibliotekën qendrore në godinën kryesore, e cila është krijuar që me krijimin e këtij institucioni. Gjithashtu është krijuar dhe dega e re e bibliotekës në East Campus, e cila u ka ardhur më pranë studentëve të këtij programi. Pra studentët mund të frekuentojnë të dyja bibliotekat. Kjo nuk paraqiste problematikë pasi studentët zhvillonin edhe disa lëndë në kampusin qendror.</p> <p>Biblioteka në East Campus ndodhet në katin zero të godinës , me një sipërfaqe prej 70 m2 dhe 30 vende studimi, një kapacitet ky i</p>

	<p>mjaftueshëm për studentët e këtij programi ( rreth 20 studentë)</p> <p><b>Evidenca . Vizita në institucion; biblioteka , punonjësja e bibliotekës dhe studentët</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka është e pajisur me tekste universitare, libra e revista kryesisht në gjuhë të huaj. Ajo ka një fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse si edhe libra apo revista shkencore të huaja, tituj librash elektronikë. Këto materiale mbulojnë pjesën më të madhe të moduleve dhe veprimtarive mësimore të këtij programi studimi. Biblioteka përdor sisteme të digjitalizuara katalogimi dhe regjistrimi të materialeve si Library Softe, etj</p> <p>Biblioteka disponon katalogun e saj elektronik, i cili është i aksesueshëm në <a href="http://library.unyt.edu.al">http://library.unyt.edu.al</a></p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita e ambienteve në institucion</b></p> <p><b>Aneksi 4.9: Politika dhe procedura e bibliotekës.</b></p> <p><b>Aneksi 3.18: Lista e literaturës e-business dhe e-commerce</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka bërë abonimin në dy baza prestigjioze burimesh elektronike. Në vitin 2023 është bërë abonimi në platformën EBSCOhost, ku mund të aksesohen rreth 1 milion libra dhe revista dhe 90,000 libra audio. Kjo iu shtua platformës ENERALD, e cila është aksesuar që në 2002. Gjithashtu, në bashkëpunim me Empire State Collge, është mundësuar akses i platformave të tjera si JSTORE, PROQUEST;APA, etj. Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët ashtu edhe për pedagogët duke krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë on-line. Akses i literaturës online lehtësohet përmes aksesit në wifi</p> <p><b>Evidenca :</b></p> <p><b>Vizita e ambienteve të bibliotekës</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera të cilët kanë të instaluar programet e aksesit në literaturë. Janë 8 kompjutera të instaluar. Kapacitet e bibliotekës ofrojnë kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi akses në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektet e tyre. Nga ana tjetër aty disponohen edhe punimet e studentëve dhe pedagogëve duke e pasuruar më shumë atë. Në bashkëpunim me Empire State Collge, është mundësuar</p>

	<p>aksesi në platforma të tjera si JSTORE, PROQUEST;APA, etj</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion, takimi në bibliotekë</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe për pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara, konkretisht 09.00 – 19.00 për çdo ditë të javës, dhe në fundjavë deri në orën 18.00, orare këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën, të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen e saj dhe përmbushjen e nevojave të studentëve. Gjatë pasditeve dhe fundjavave angazhohen studentë të UNYT. Orari ishte i afishuar në hyrje të bibliotekës, por edhe në websitin e Universitetit</p> <p><b>Evidenca :</b></p> <p><b>Vizita e ambienteve në institucion</b></p> <p><b>Website :</b> <a href="http://library.unyt.edu.al">http://library.unyt.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka mban rekorde për numrin e personave që e aksesojnë dhe titujt që ata konsultojnë. Ne u informuam edhe gjatë vizitës mbi numrin e personave që e frekuentojnë mesatarisht çdo ditë, që rezultoi të ishte rreth 80. Rektori dhe Administratori i universitetit marrin informacion mujor mbi këto evidenca. Pasurimi dhe përditësimi i literaturës bëhet çdo vit bazuar në një procedurë të mirëpërcaktuar, ( neni 7 i “Politika dhe procedura e bibliotekës” ), por edhe falë një bashkëpunimi dhe koordinimi mjaft të mirë të bibliotekës me stafet akademike të programit dhe Drejtuesit e Departamenteve.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 4.9: Politika dhe procedura e bibliotekës/ pasurimi</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>



<b>Konkluzione</b>	<p>- UNYT ofron një bibliotekë me hapësira të dedikuara për studentët dhe me orare të përshtatshme sipas hapësirave që u lejon programi mësimor. Biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës. Orari është i afishuar në hyrje të bibliotekës dhe në website të UNYT.</p> <p>-Institucioni angazhohet maksimalisht në ofrimin e teksteve bazë dhe ndihmëse të përditësuara dhe dedikon një fond vjetor për këtë qëllim.</p> <p>-Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/ on line me një fond të larmishëm dhe me platforma bashkëkohore.</p> <p>-Biblioteka është e pajisur me kompjutera, që kanë të instaluar programet përkatëse për aksesin në literaturë .</p> <p>-Aksesi i literaturës online lehtësohet përmes aksesit free në wifi</p> <p><b>Sugjerim : GVJ rekomandon monitorim më të mirë të përditësimin të literaturës nëpërmjet kontrollit më të saktë të syllabuseve.</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Që prej vitit 2023 UNYT ka siguruar platformën e re KION , përmes të cilës administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre gjatë të gjitha fazave të procesit mësimor, që nga regjistrimi deri në diplomim për programin e studimit. Para këtij sistemi institucioni përdorte sistemin GNOMON. Në krahasim me sistemin e mëparshëm GNOMON, sistemi i ri KION mundëson edhe hedhjen e mungesave nga pedagogët, regjistrimin e studentëve online, si edhe hedhjen e rezultateve të vlerësimeve nga vetë stafi akademik. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit si edhe gjenerimin e raporteve statistikore. Çdo student pajiset me kredencialet e tij personale dhe mund ta aksesojë sistemin nga çdo pajisje elektronike në çdo kohë.</p>



	<p>Sekretaria mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma: shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Sekretaria mësimore administron regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin me të dhënat akademike, regjistrin e pajisjes me diploma.</p> <p>Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Sekretaria mësimore administron edhe procesverbalet me rezultatet e provimeve të studentëve, të projektit të diplomës, listën e të diplomuarve dhe i përcjell rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra.</p> <p>Zyra e Çështjeve studentore kryen regjistrimin fillestar në sistem e më pas proceset ndiqen nga sekretaria mësimore. Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore.</p> <p><b>Evidenca :</b></p> <p><b>Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme për funksionimin e sekretarisë mësimore</b></p> <p><b>Anekset 4.21. 4.21.1, 4.21.2. 4.21.3. 4.21.4, 4.21.5, 4.21.6 mbi sistemin KION</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Përmes zyrës së burimeve njerëzore sigurohet ruajtja e dokumentacionit që lidhet me stafet. Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Zyra e Burimeve Njerëzore disponon dosjet fizike dhe një bazë elektronike të dhënash. Në dosjet personale të stafeve, të cilat hapen sapo ata punësohen, disponohen dokumentat personale të stafit akademik PAE dhe PAK, ndihmës akademik dhe administrativ si CV, librezat e punës, kontratat e punës, procedurat e punësimit, librezat shëndetësore, certifikatat të ndryshme të titujve e gradave, etj.</p> <p><b>Evidencë</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneksi: 4.24: Politika dhe procedura të Departamentit të Burimeve Njerëzore</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili funksionon në bazë të rregullores përkatëse. Stafit akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin KION,</p>



<p>personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>në regjistrat e sekretarisë pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet. Studentëve dhe stafeve akademike u është siguruar akses në këto sisteme, përmes kredencialeve të tyre.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Vizita ne institucion</b></p> <p><b>Anekset 4.21. 4.21.1, 4,21.2. 4.21.3. 4.21.4, 4,21,5, 4,21.6 mbi sistemin KION</b></p> <p><b>Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme për funksionimin e sekretarisë mësimore</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Platforma KION përfshin komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve. Sistemi KION mundëson shkëmbim informacioni mbi regjistrimin, vlerësimin, mungesat e studentëve.</p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Anekset 4.21. 4.21.1, 4,21.2. 4.21.3. 4.21.4, 4,21,5, 4,21.6 mbi sistemin KION .</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik dhe administrativ garantohej përmes sistemit KION përsa i takon aktivitetit mësimor dhe përmes dosjeve të personelit përsa u takon të dhënave që lidhen me stafet.</p> <p>Gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u konfirmua se sistemi siguron edhe gjenerimin e raporteve që i nevojiten sekretarisë mësimore për raportimet pranë strukturave menaxhuese të institucionit, në lidhje me frekuentimin, rezultatet, etj.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Anekset 4.21. 4.21.1, 4,21.2. 4.21.3. 4.21.4, 4,21,5, 4,21.6 mbi sistemin KION</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me IAL: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organigramën. Ajo jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UNYT, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë dhe të strukturuar në rubrika të dedikuara për Universitetin, stafet akademike, studimet, si edhe jetën në universitet, programet dhe syllabuset e lëndëve. Lidhur me programin e studimit BSC në "Biznes dhe Tregti elektronike" në faqen e internetit të</p>

	<p>institucionit gjejmë informacion mbi kurrikulën e tij. Institucioni po punon për një faqe të re e cila, sipas informacionit nga nivelet drejtuese, do të jetë më user friendly si edhe do të jetë në të dy gjuhët anglisht dhe shqip.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/e-business-and-e-commerce/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/e-business-and-e-commerce/</a></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-UNYT realizon menaxhimin e informacioneve për studentët në të gjitha fazat e studimit që nga regjistrimi e deri tek diplomimi, përmes platformës elektronike KION.</i></p> <p><i>-Në sistemin KION hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me frekuentimin, ecurinë dhe vlerësimin e studentit.</i></p> <p><i>-Faqja zyrtare e NYUT përmban informacionet kryesore në lidhje me aktivitetin e UNYT si edhe misionin, drejtimin, funksionimin, organogramën si edhe mbi kurrikulën e programit të studimit Biznes dhe tregti elektronike.</i></p> <p><i>-Është evidentuar nevoja për përmirësim të faqes zyrtare, për ta bërë atë më userfriendly, gjë që është në proces, .</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit	Çdo vit akademik hartohet një raport financiar i cili evidenton shpenzimet dhe të ardhurat. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion është një tabelë e cila është emërtuar “kosto efektivitet” por në të janë pasqyruar vetëm kostot. Tabela është në nivel Departamenti. Gjithashtu Departamenti harton një plan buxheti, ku pasqyrohen nevojat financiare të tij. Ky plan është pjesë e planit të Fakultetit e më tej të Universitetit të cilat miratohen nga Bordi i Administrimit. Institucioni ndjek një politikë buxhetimi e cila përcakton procedurat e përcaktimit të



<p>për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>zërave të buxhetit. Kjo politikë është formalizuar në një dokument të posacëm.</p> <p><b>Evidencë:</b></p> <p><b>Aneksi 4.32. Plan buxheti në nivel Dedpartamenti</b></p> <p><b>Aneksii 4.31. Kosto efektivitet</b></p> <p><b>Aneksi 4.32: Politika e buxhetimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Çdo vit akademik Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit në bazë të kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, identifikon kostot operacionale dhe ato kapitale të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimor. Në këtë mënyrë hartohet plan buxheti. Në plan buxhetin e Departamentit specifikohen nevojat të cilat përfshijnë burimet njerëzore, bazën materiale, nevojat për financime të aktiviteteve kërkimore, nevojat për literaturë, në shërbim të realizimit të procesit mësimor dhe atij kërkimor të Departamentit. Në fund të çdo viti, institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit. Plan buxheti miratohet nga Senati dhe nga Bordi i Universitetit. Institucioni ndjek një politikë buxhetimi e cila përcakton procedurat e përcaktimit të zërave të buxhetit. Kjo politikë është formalizuar në një dokument të posacëm.</p> <p>Financimi i aktiviteteve mbështetet nga Fondacioni MAARIF , gjë që ka sjellë një ecuri financiare të kënaqshme dhe të qëndrueshme.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 4.32. Procedura e buxhetimit</b></p> <p><b>Aneksi 4.33.2 Plan buxheti në nivel Departamenti</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UNYT auditohet nga një kompani auditimi e jashtme e cila monitoron efikasitetin e përdorimit të burimeve financiare. Kjo kompani realizon auditimin e pasqyrave financiare të institucionit. Kryerja e auditimit parashikohet dhe në Rregulloren e zyrës së financës.</p> <p>Institucioni e ka ngritur Komisionin e Auditimit te brendshem dhe ka hartuar nje procedure specifike ne lidhje me funksionimin e tij ne vitin akademik 2022-2023. Ky Komision ka filluar punen ne vitin akademik 2023-2024, i cili e ka perfunduar procesin e</p>

	<p>auditimit ne njesine e sekretarise mesimore.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4.30 Raporti i auditimit 2021</b></p> <p><b>Aneksi 4,30,1 Raporti i auditimit 2022</b></p> <p><b>Aneksi 4.33.3 Rregullore e zyrës së financës</b></p> <p><b>Aneksi 6.8 Procedura e Auditit te Brendshem; Aneksi 6.20 Vendim Rektorati per Auditin e Brendshem</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Gjatë takimit me Drejtuesit, u informuam se në përfundim të vitit Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit nga Drejtoria e Financës. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës. Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin për vitin e ardhshëm. Nuk na është vënë në dispozicion ndonjë raport mbi realizimin e buxhetit.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4.33.3 Rregullore e zyrës së financës</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë takimit me nivelet drejtuese u informuam se UNYT garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në tarifat e shkollimit, projektet e ndryshme por mbi të gjitha në mbështetjen financiare të Fondacionit Turk Maarif.</p> <p>Nuk ka patur situata të vështirësisë financiare, për të cilat të kërkohej ndonjë ndërhyrje e posaçme.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b><a href="https://unyt.edu.al/index.php/turkish-maarif-foundation/">https://unyt.edu.al/index.php/turkish-maarif-foundation/</a></b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-UNYT harton raporte vjetore financiare të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin e buxhetit për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij.</i></p> <p><i>-Shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore dhe kërkesave të planifikuara për mësim dhe</i></p>

	<p><i>kërkim në çdo fillim viti akademik.</i></p> <p><i>-Buxheti vjetor miratohet nga bordi i adminstrimit.</i></p> <p><i>- Në përfundim të vitit, Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës.</i></p> <p><i>-Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, bazuar në të ardhurat që siguron dhe në mbështetjen nga Fondacioni Maarif.</i></p> <p><i>-UNYT i është nënshtruar auditimeve të jashtme , dhe atyre të brendshme</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UNYT zbaton politika dhe procedura të qarta të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve që nga regjistrimi në Universitet deri tek diplomimi i tyre. Këto politika e procedura bazohen në legjislacionin në fuqi të MAS dhe janë sanksionuar përmes Statutit, Rregullores së Universitetit, Rregullores së Zyrës studentore, Rregullores së Sekretarisë. Çdo vit akademik Senati miraton me një vendim të posacëm kriteret dhe kuotat e pranimit. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të Universitetit. Procedura e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS). Në rregulloren e Universitetit përcaktohen qartë në nenet respektive të gjitha procedurat që lidhen me ecurinë e aktivitetit studentor si regjistrimi, matrikulimi, vlerësimi, transferimi, kryeja e praktikave, diplomimi, Në faqen web të Universitetit studenti gjen të gjithë informacionin e nevojshëm si përbërjen e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të realizimit të procedurave janë krijuar edhe strukturat përkatëse si Sekretaria mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore, Zyra e karrierës dhe alumni. Gjithashtu në institucion është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i pranimeve dhe transferimeve. Kohëzgjatja normale e studimeve në këtë program studimi është tre vite akademike dhe studenti diplomohet me punim diplome. Rregullorja e programit të studimit formalizon në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat e lartpërmendura.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneks 1.1 Statuti i Universitetit</b></p> <p><b>Aneksi 1.8 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit</b></p> <p><b>Aneksi 1.10 Rregullore e Departamentit</b></p> <p><b>Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme për funksionimin e sekretarisë mësimore</b></p> <p><b>Aneksi 5.1: Rregullorja e Zyrës së Çështjeve studentore.</b></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat, të cilat i referohen të gjithë hapave që ndjekin studentët që nga regjistrimi e deri në diplomim, garantojnë plotësisht të drejta të barabarta të studentëve. Kjo garanci sigurohet nga Statuti dhe të gjitha rregulloret në nivel Fakulteti dhe Departamenti. Të drejtat e barabarta dhe mosdiskriminimi reflektohen në të gjitha proceset përfshirë jo vetëm ato që lidhen me mësimdhënien, por edhe me pjesëmarrjen në forume, grupe pune, komisione, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, aplikimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Këto sanksionohen edhe në Kodin e etikës, në nenin 7 të tij. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë përcaktuar në rregulloret përkatëse. Studentëve u njihet gjithashtu edhe e drejta e ankimimit si edhe e trajtimit të çështjeve që mund të përbëjnë raste të shkeljes së Kodit të Etikës, zbatimin e të cilit e garanton Këshilli i Etikës, në të cilin është antar edhe një student..</p> <p><b>Aneks 1.1 Statuti i Universitetit</b></p> <p><b>Aneksi 1.8 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit</b></p> <p><b>Aneksi 4.7 Kodi i etikës</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni para çdo viti akademik bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përcakton kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të cilat miratohen me Vendim të Senatit akademik. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerëzore, akademike dhe logjistike për cdo program studimi. Senati akademik i propozon kuotat dhe kriteret e pranimit në MAS. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në faqen eeb të Universitetit:</p> <p>Në Vendimin e Senatit për kriteret e pranimit specifikohen kriteret sipas legjislacionit në fuqi, për studentët nga Shqipëria, por edhe ata nga Republika e Kosovës, apo studentët nga trojet shqipfolëse. Gjithashtu referohet edhe kriteri i një testimi institucional lidhur me certifikimin e njohjes së gjuhës angleze, nisur nga fakti që mësimdhënia në këtë Universitet dhe në këtë program bëhet në gjuhën angleze.</p> <p>Zyra e Çështjeve Studentore është përgjegjëse për bashkëpunimin me strukturat e maturës shtetërore dhe për informimin, ndjekjen e procedurës përmes U-Albania dhe regjistrimin e studentëve.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Anekset, 5,21,. 5,2,2. 5,2.3 Vendim Senati për kriteret e pranimit</b></p>

	<p><b>Aneksi 5.1: Rregullorja e Zyrës së Çështjeve studentore</b></p> <p>Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me pranimin përzgjedhjen, e deri tek diplomimi janë të shprehura qartë dhe të detajuara në të gjitha dokumentat zyrtarë të UNYT si dhe në faqen web. Statuti, Rregullorja e Fakultetit, Rregullorja e Departamentit, por edhe syllabuset japin informacion të plotë dhe të qartë për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit e cdo aspekt të rrugëtimit të studentëve përgjatë një cikli studimi,</p> <p>Gjithashtu studentët mund të konsultohen për çdo paqartësi apo informacion shtesë nga këshilltari akademik, por edhe Zyra e Çështjeve studentore.</p> <p>Nga takimi që zhvilluam me studentët, konstatohet se ata janë të mirëinformuar lidhur me procedurat, janë të kënaqur me aksesin në informacion, me bashkëpunimin me këshilltatin akademik, me Sekretarinë dhe Zyrën e Çështjeve Studentore si edhe atë të Këshillimit të Karrierës. Faqja Web është e aksesueshme lehtësisht nga ata.</p> <p>Studentët aksesojnë edhe sistemin KION, përmes të cilit marrin informacion mbi rezultatet e vlerësimit të dijeve, mungesat dhe diplomimin.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneks 1.1 Statuti i Universitetit</b></p> <p><b>Aneksi 1.8 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit</b></p> <p><a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p> <p><b>Aneksi 5,28 Programet e studimit</b></p> <p><b>Anekset 4.21. 4.21.1, 4,21.2. 4.21.3. 4.21.4, 4,21,5, 4,21.6 mbi sistemin KION</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UNYT organizon fushatat promovuese para fillimit të cdo viti akademik përmes, informimit në faqen web, boshurave promovuese, reklamave në rrjetet sociale, në radio, në televizion, Një instrument shumë i mirë promovimi janë edhe kurset e organizuara nga ky Universitet si për shembull kurset falas të maturës shtetërore, të cilat përveç pajisjes së pjesëmarrësve me njohuritë në lëndët përkatëse, synojnë edhe dhenien e informacionit mbi programet e studimit, bursat, etj. Panairi i punës dhe studimit ka dhënë gjithashtu rezultat si aktivitet promovues i këtij institucioni. Studentë dhe pedagogë dhe</p>




	<p>përfaqësues të zyrave përkatëse marrin pjesë edhe në aktivitetet promovuese që organizohen sipas një kalendari i cili rakordohet me Drejtoritë Rajonale të Arsimit me fokus njohje të të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit si edhe mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe punësimin pas mbarimit të programeve të studimit etj. Gjithashtu maturantë të Gjimnazeve ftohen të vizitojnë UNYT, por edhe vetë Universiteti zhvillon vizita në Gjimnaze. Kjo bëhet sipas një programi pune.</p> <p>Informacioni gjendet gjithashtu në faqen web të UNYT: <a href="https://unyt.edu.al">https://unyt.edu.al</a>.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.25; Materiale promovuese</b></p> <p><b>Aneksi 5.5; Kurset e maturës</b></p> <p><b>Aneksi 5-6: Panairi i punës dhe studimit</b></p> <p><b>Aneksi 5.8: Provimi i bursës</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>UNYT parashikon kuota të caktuara dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara, bazuar në legjislacionin në fuqi. Këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara fillimit të çdo viti akademik dhe publikohen edhe në website. Deklarohet se aplikohen politika lehtësuese për shtresat në nevojë përmes aplikimit të bursave. Gjithashtu, në raste të vështirësive financiare, trajtohen kërkesat e studentëve të bëra përmes peticioneve financiare. Por tek vendimet për kuotat nuk ka specifikim për këto shtresa, as në politikat e bursave.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.3: Kuotat për vitin 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 5.30.1; Peticion pagesë financiare më këste</b></p> <p><b>Aneksi 5.7 ; Politika e bursave 2021-2022</b></p> <p><b>Aneksi 5.7.1 ; Politika e bursave 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 5.7.2 ; Politika e bursave 2023-2024</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përcaktohen në Vendimet e çdo viti përmes të cilave Senati bën miratimin e kriterëve të pranimit. Kjo konfirmohet edhe nga vizita në institucion, ku u pyetën mbi numrin e studentëve të huaj. Në këtë program nuk ka, por në nivel Universiteti janë rreth 5% studentë të huaj. Kriteret mundësojnë aplikimin e shtetasve nga</p>

<p>kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Republika e Kosovës dhe trojet shqipfolëse, por edhe të shtetasve të huaj nga vende të tjera, të cilët u nënshtrohen kritereve standard të miratuara nga MAS. Kuotat përcaktohen bazuar në historikun e aplikimeve në vitet paraardhëse. Edhe në këto raste kandidatët duhet të plotësojnë si kriter shtesë kriterin e njohjes së gjuhës angleze.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 5.2.1 Vendim senati për kuotat e pranimit 2022-2023</b>  <b>Aneksi 5.2.1 Vendim senati për kuotat e pranimit 2023-2024</b>  <b>Aneksii 5.2.1 Vendim senati për kuotat e pranimit 2024-2025</b></p> <p><b>Aneksi 5.3 Kuotat për 2020-2021</b></p> <p><b>Aneksi 5.3.1 Kuotat për 2021-2022</b></p> <p><b>Aneksi 5.3.2 Kuotat për 2022-2023</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si edhe nga takimi me studentët e programit konstatojmë se UNYT ndjek politika të akordimit të bursave bazuar në arritjet akademike, arritjet në fusha specifike si art sport, punë vullnetare. Gjithashtu , në raste të vështirësive financiare , trajtohen kërkesat e studentëve të bëra përmes peticioneve financiare. Politika e bursave hartohet me baza vjetore, Komiteti i bursave ia propozon atë Bordit të Administrimit, i cili e miraton.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 5.7 ; Politika e bursave 2021-2022</b>  <b>Aneksi 5.7.1 ; Politika e bursave 2022-2023</b>  <b>Aneksi 5.7.2 ; Politika e bursave 2023-2024</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-UNYT ka hartuar procedura dhe politika të plota dhe të kuptueshme të cilat mbulojnë çdo aspekt të rrugëtimit të studentëve në ciklin e plotë të studimit nga regjistrimi deri në diplomim në programin BSC “ Biznes dhe tregti elektronike”. Këto formalizohen në Statutin e UNYT si edhe në Rregulloret e njësive , të cilat janë hartuar duke respektuar legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me studimet dhe studentët.</i></p> <p><i>-Procedura e pranimit të studentëve bazohet në kriteret e miratuara nga Senati sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.</i></p> <p><i>-UNYT ka ngritur një zyrë të posaçme që merret me procesin e informimit dhe regjistrimit të studentëve në kuadër të U-Albania , zyrë e cila bashkëpunon me QSHA për procedura\ t e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</i></p>



	<p><i>-Studentëve u mundesohet studimi në UNYT bazuar në parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, gjë që saknksionohet në rregulloret e studimit.</i></p> <p><i>- Kuotat e pranimit bëhen publike nga UNYT dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MAS.</i></p> <p><i>-UNYT, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave .</i></p> <p><i>-UNYT zbaton kriteret e regjistrimit të studentëve të huaj dhe ka si kriter specifik shtesë për ndjekjen e studimeve në këtë universitet njohjen e gjuhës angleze.</i></p> <p><i>Sugjerim Institucioni duhet të parashikojë bursa për regjistrimin e studentëve nga shtresat e marginalizuara.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit dhe atë të programit ka informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Nga vizita në institucion konstatuam se në sekretarinë mësimore mbahet regjistri i përparimit të studentëve të këtij programi mësimor , i cili plotësohet për çdo lëndë mësimore. Në rregullore përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin dhe kur studenti ka të drejtë për mbrojtjen e diplomës. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen elektronike të NYUT.</p> <p>Informimi i studentëve bëhet edhe përmes sistemit KION, ku në kohë reale ata marrin informacionin e duhur për ecurinë e tyre Ky informacion aksesohet edhe nga pedagogët , kështu që këshilltarët akademikë kanë mundësi të këshillojnë studentët lidhur me përparimin e tyre.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 1.9. Rregullore e Departamentit</b></p>

	<p><b>Aneksi 110. Rregullorja e programit</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.5; Ndjekja e ecurisë së studentëve në KION</b></p> <p><a href="https://unyt.edu.al">https://unyt.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UNYT ka hartuar një politikë për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në rregulloret e Fakultetit dhe të Departamentit referohet procedura e transferimit të studimeve apo ekuivalentimit të lëndëve, studentët informohen përmes Zyrës së Çështjeve Studentore. Në departament ngrihet një komision ad-hoc, i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacionin, i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. I gjithë procesi i transferimit dhe njohjes së krediteve të mëparshme, si për studentët vendas, ashtu edhe për ata ndërkombëtarë, zhvillohet brënda afateve ligjore dhe ndjek hap pas hapi të gjitha procedurat e përcaktuara në ligj dhe në rregullore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 3-20 Politika e transferimit të studimeve</b></p> <p><b>Aneksi 5.26 Komunikimi me studentët ndërkombëtarë.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve janë specifikuar në Rregulloren e programit të studimit, e cila u bëhet e njohur studentëve sapo ata regjistrohn në UNYT. Gjithashtu, mënyra e vlerësimit për çdo lëndë detajohet në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e vlerësimit të dijeve e cila përmban elementë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar.</p> <p>Nga takimi me drejtuesen e Departamentit, u informuam se Këshilltarët akademikë dhe Zyra e Çështjeve studentore janë në dispozicion të studentëve për të bërë sqarimet e kërkuara nga ana e tyre, gjë që u konfirmua dhe gjatë takimit me studentët e këtij programi. Studentët u shprehën të kënaqur me metodologjinë e vlerësimit dhe me procedurat e vlerësimit dhe të rishikimit të vlerësimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 1.10 Rregullorja e programit</b></p> <p><b>Aneksi 2.14 Syllabuset</b></p> <p><b>Aneksi 3.1 Manuali i Instruktorëve</b></p> <p><b>Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe drejtuesen e Departamentit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për realizimin e punimit të diplomës dhe diplomimin në këtë program studimi janë të specifikuar në të gjithë hierarkinë e Rregulloreve që nga ajo e Universitetit, e Fakultetit, e</p>

<p>lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Departamentit dhe deri tek Rregullorja e Programit. Këto rregullore përcaktojnë se kur studenti mund të plotësojë kushtet për diplomim, cilat janë procedurat që duhet të ndiqen, etj. Të gjithë studentët në këtë program studimi do të diplomohen me punim diplome dhe jo me provim. Nga takimi me studentë të vitit të fundit rezultoi se ata kishin informacion mbi këto procedura. Pedagogu udhëheqës është në rolin e mentorit dhe i ndihmon studentet përgjatë gjithë periudhës së përgatitjes së punimit nga ana përmbajtësore. Për çdo nevojë për këshillim lidhur me procesin, studentët bashkëpunojnë me këshilltarin akademik. UNYT ka përcaktuar kriteret e përgatitjes së projektit të diplomës në një rregullore të posaçme. Gjithashtu ka hartuar edhe një Manual për mënyrën e përgatitjes së projektit të diplomës, ku specifikohet në mënyrë të detajuar struktura dhe përbërja e tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Aneksi 1,7 Rregullore e UNYT</b></p> <p><b>Aneksi 1.8 Rregullore e Fakultetit</b></p> <p><b>Aneksi 1.9 Rregullore e Departamentit</b></p> <p><b>Aneksi 1.10 Rregullore e Programit</b></p> <p><b>Aneksi 3.3 Rregullore e projektit të diplomës</b></p> <p><b>Aneksi 3.7 Rregullore e projektit final</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Për çdo vit akademik UNYT angazhohet për promovimin e programeve të studimit, bazuar edhe në udhëzimet e nxjerra nga MAS, përgjegjëse për këtë proces është Zyra e Çështjeve studentore. UNYT organizon fushatat promovuese para fillimit të çdo viti akademik përmes, informimit në faqen web, boshurave promovuese, reklamave në rrjetet sociale, në radio, në televizion. Një instrument shumë i mirë promovimi janë edhe kurset e organizuara nga ky Universitet si për shembull kurset falas të maturës shtetërore, të cilat përveç pajisjes së pjesëmarrësve me njohuritë në lëndët përkatëse, synojnë edhe dhënien e informacionit mbi programet e studimit, bursat, etj. Panairi i punës dhe studimit ka dhënë gjithashtu rezultat si aktivitet promovues i këtij institucioni. Informimi i publikut për programet e studimit realizohet edhe përmes posterave dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj). Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni realizon gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve informuese.</p> <p>Para fillimit të vitit akademik hartohet një plan aktivitetesh për këtë qëllim nga Zyra e Çështjeve studentore. Gjithashtu personat e interesuar, marrin informacion për programet e studimit që ofron</p>

	<p>IAL, edhe nëpërmjet publicitetit në median sociale dhe përmes faqes ëeb të Universitetit. Nga takimi me studentët e vitit të parë në këtë program rezultoi se ata ishin informuar për këtë program studimi përmes ditës së hapur, panairit dhe vecanërisht përmes njoftimeve në rrjetet sociale.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.5 Kurset e maturës</b></p> <p><b>Aneksi 5.27 SAO plani vjetor 2023</b></p> <p><b>Unyt_official</b></p> <p><b>www.unyt.edu.al</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-UNYT ka formalizuar procedurat dhe kriteret e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, si dhe shkallën e frekuentimit të detyruar për programin e studimit në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit, ku çdo student gjen informacion të plotë edhe mbi kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.</i></p> <p><i>-Procedurat e vlerësimit të përparimit akademik janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit dhe ne syllabuset e lëndëve përkatëse.</i></p> <p><i>-Institucioni ka përgatitur një rregullore dhe një manual udhëzues për përgatitjen e projektit të diplomës. Të gjithë studentët diplomohen përmes projektit dhe jo provimit.</i></p> <p><i>-Studentët asistohen gjatë përgatitjes së projektit të diplomës nga udhëheqësi dhe nga këshilltari akademik.</i></p> <p><i>-Informimi i publikut kryhet në mënyrë të strukturuar përmes planeve të punës dhe strukturave të dedikuara të cilat përdorin instrumenta të ndryshëm të promovimit si mediat, fletëpalosjet, por edhe panairët, vizita nga dhe tek gjimnazet, etj</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Informacion i hollësishëm mbi programin gjendet në Rregulloren e programit, e cila u vihet në dispozicion studentëve sapo fillojnë vitin e parë akademik. Zyra e Çështjeve Studentore është përgjegjëse për informimin e studentëve përmes takimeve, emaileve, broshurave, etj. Nga takimi që zhvilloam në Institucion më personelin e kësaj zyre u informuam mbi këtë komunikim me studentët. Në fillim të çdo viti akademik, bëhen takime me studentët e viteve të para, ku shpërndahe çdo informacion në lidhje strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Pranë kësaj zyre studentët mund të aksesojnë edhe dosjen e programit të studimit. Për çdo pyetje apo nevojë për sqarime studentët mund të diskutojnë me këshilltarin akademik, i cili është në dispozicion të tyre përgjatë ciklit të plotë 3 vjeçar të studimeve në këtë program. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen web.</p> <p>Nga diskutimi me studentët rezultoi se ata ishin të mirëinformuar lidhur me programin e studimit, strukturën e tij, kohëzgjatjen, elementët e vlerësimit, etj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><b>Vizita në Institucion, takimi me studentët</b></p> <p><b>Aneksi 1.10 Rregullore e programit</b></p> <p><b>Aneksi 5.29 Ditët e hapura</b></p> <p><b>Aneksi 5.1 Rregullore e Zyrës së Çështjeve studentore</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Zyra e Çështjeve të Studentëve dhe këshilltarët akademikë njohin studentët me dokumentacionin shpjegues për programin e studimit. GVJ konstaton se ky dokumentacion është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion, i cili vihet në dispozicion të studentëve me regjistrimin e tyre, por edhe nga çdo lektor i lëndës, në orën e parë të çdo semestri, studenti gjen informacion të detajuar për lëndën përkatëse, organizimin dhe shpërndarjen në semestra. Gjithashtu, çdo syllabus është një dokument përmes të cilit studenti informohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës mësimore (leksion, seminar, projekt, etj). Informacioni gjendet dhe në faqen zyrtare web të UNYT <a href="http://www.unyt.edu.al">www.unyt.edu.al</a> ku studentët informohen edhe lidhur me akreditimin e programeve.</p> <p>Nga takimi me studentët u konfirmua se ata njihnin lëndët, përmbajtjen dhe mënyrat e vlerësimit përmes dokumentave dhe zyrës përkatëse.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.29 Ditët e hapura</b></p>

	<p><b>Aneksi 2.14 Syllabuset</b>  <a href="http://www.unyt.edu.al">www.unyt.edu.al</a>)  <b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UNYT informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe i orienton ata drejt tregut të punës përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumni. Në rregulloren e funksionimit të kësaj zyre përcaktohen qartë detyrat funksionale të saj, që përfshijnë realizimin e aktiviteteve të ndryshme informuese, trajnime, internshipe, etj. Kjo zyrë operon përmes një plani pune vjetor, i cili përfshin aktivitetet që planifikon të zhvillojë ajo në harkun kohor të një viti. Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm si edhe me përfaqësues të zyrës së karrierës, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve drejt tregut të punës dhe mbi mundësitë e punësimit. U konfirmua informacioni i dhënë në RVB dhe dokumentacioni shoqëruar i cili sqaron se instrumentat më të rëndësishëm të përdorur janë ditët e karrierës, takimet informuese, bashkëpunimi me institucionet e ndryshme për realizimin e internshipeve, panairi i punës dhe pjesëmarrja e Alumnit në aktivitetet pormovuese. Aktiviteti i kësaj zyre monitorohet përmes një raporti vjetor të performancës. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike, pjesë e bashkëpunimit me të cilat është edhe marrja e informacionit për vendet e lira të punës. Realizohet edhe përfshirja e studentëve në përzgjedhjen e kompanive pjesëmarrëse në panair, përmes një linku për këtë qëllim. Informohemi se mbi 40 kompani morën pjesë në panair gjatë viteve të fundit, gjë që shpreh interesimin e tyre për punësimin e studentëve të këtij Universiteti.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion, Takimi me studentët dhe përfaqësues të Zyrës së karrierës dhe Alumni</b></p> <p><b>Aneksi 5.11 Rregullore e zyrës së karrierës</b></p> <p><b>Aneksi 5.12 Aktiviteti i zyrës së karrierës</b></p> <p><b>Aneksi 5.22 Raporti vjetor i zyrës së karrierës</b></p> <p><b>Aneksi 5.15 Panairi i punës</b></p> <p><b>Aneksi 5.15.1 Përfshirja e studentëve në përzgjedhjen e kompanive në panair</b></p> <p><b>Aneksi 5.16 Plani vjetor zyra e karrierës</b></p> <p><b>Aneksi 5.18 Dokumenti i performancës , karriera dhe alumni</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p><b>Aneksi 5.15.2 Lista e kompanive pjesëmarrëse në panair</b></p> <p>Studentët që u takuan nga GVJ reflektuan se kishin informacion të hollësishëm mbi infrastrukturën dhe organizimin e procesit mësimor, programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtëkurrikulare, logjistikën, laboratorët, bibliotekën, internshipet si edhe zyrat dhe strukturat ndihmëse, përfshirë zyrën e karrierës, zyrën e ceshtjeve studentore, sekretarinë mësimore.</p> <p>Ditët e hapura gjithashtu shërbejnë për të informuar studentët mbi infrastrukturën dhe logjistikën bashkëkohore si edhe me zyrat dhe funksionet e tyre.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.29 Ditët e hapura dhe vizitat e studentëve</b></p> <p><b>Vizita në institucion, takimi me studentët</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UNYT përdor sistemin KION, përmes të cilit mundësohet informimi i studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në çdo moment, si dhe detaje për programin e studimit, detaje individuale për notat, frekuentimin, etj. Informacioni i detajuar dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen elektronike të Institucionit.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4.19 Adresa elektronike për çdo student</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.4 Aksesi i studentëve në KION</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Biznes dhe Tregti Elektronike " informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij.</i></p> <p><i>- Dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.</i></p> <p><i>- Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentojmë që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtëkurrikulare, logjistika, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave mesimore si edhe strukturat ndihmëse.</i></p> <p><i>-Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për mundësitë e punësimit,</i></p>

	<i>përmes zyrës së karrierës dhe alumni.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Nga takimi me Sekretarinë Mësimore u informuam se pranë saj janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve për programin e studimit përmes Regjistrat themeltar të studentëve; Regjistrat të të diplomuarve si edhe Regjistrat të vlerësimeve /notave. U informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe disponon të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit. Këto të dhëna reflektohen edhe në raportet e performancës së Institucionit.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.5 Ndjekja e ecurisë së studentëve në KION</b></p> <p><b>Aneksi 5.18 Dokumneti i performancës</b></p> <p><b>Aneksi 5.20 Statistika mbi punësimin</b></p> <p><b>Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore.</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve sigurohen nga sistemi i menaxhimit KION, ku mund të aksesohen të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar, atyre që shkëputen përkohësisht apo përfundimisht. Gjithashtu, në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit dhe të çregjistrimit. Përmes sistemit KION gjenerohen raporte të nevojshme për të informuar strukturat drejtuese si edhe MAS, ASCAL apo QSHA. Nga vizita në sekretarinë mësimore rezultoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <p>Viti akademik 2021-2022 4 studentë;</p>





	<p>Viti akademik 2022-2023 3 studentë; Viti akademik 2023-2024 13 studentë.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4,21 Sistemi i menaxhimit KION</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.6 Regjistrimi i studentëve në KION</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.2 Hedhja e mungesave në KION</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.3 Hedhja e vlerësimit në KION</b></p> <p><b>Aneksi 4.21.4 Akses i studentëve në KION</b></p> <p><b>Aneksi 4. 21. 5 Ndjekja e ecurisë në KION</b></p> <p><b>Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të menaxhimit KION. Sekretaria mësimore ka akses në këto të dhëna dhe e përdor sistemin për gjenerimin e raporteve të nevojshme- Këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave. Informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nën ligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të UNYT.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4.21 Akses i sekretarisë mësimore në KION</b></p> <p><b>Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që</p>	<p>UNYT ka ngritur një Komision ad hoc për auditimin e brendshëm lidhur me procedurat që aplikohen nga strukturat që lidhen me procesin mësimor pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve, ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar. Na është vënë në dispozicion dokumentacioni mbi ngritjen e komisionit ad hoc dhe procedura, por jo ndonjë raport auditimi i brendshëm.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 6.20 Vendim Rektorati për Auditin e Brendshëm</b></p> <p><b>Aneksi 6.8 Internal Audit procedure</b></p>

lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet analitike përpilohen në kuadër të analizës vjetore të njësisë bazë dhe asaj kryesore në bashkëpunim me sekretarinë dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumni, Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin. Zyra e Karrierës dhe Alumni realizon skedimin e informacionit për punësimin.</p> <p>Aktualisht disponohen të dhëna për studentët në hyrje, rezultatet e tyre, por akoma jo për të diplomuarit, duke qënë se ky është një program që nuk e ka përfunduar një cikël studimi të plotë. Por nga takimet e zhvilluara u informuam se mbi 90 % e të diplomuarve në nivel Universiteti janë punësuar në kompani prestigjioze.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 3.8 Raport vjetor MAS 2021-2022</b></p> <p><b>Aneksi 3.9 Raporti vjetor MAS 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 5.20 Statistika mbi punësimin e studentëve Bch</b></p> <p><b>Aneksi 5.21.1 Statistika mbi punësimin e studentëve Master</b></p> <p><i>Sugjerim: Mendojmë se duhet të mbahen të dhëna edhe se ku janë punësuar dhe jo vetëm a janë punësuar studentët pas përfundimit të studimeve në UNYT.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Në sekretarinë mësimore të UNYT, janë të depozituara dokumentacionet e plota mbi numrin e studentëve për programin e studimit. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</i></p> <p><i>-Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit, KION i cili është i aksesueshëm në cdo kohë nga</i></p> <p><i>-Sistemi KION aksesohet nga sekretaria për gjenerimin e raporteve analitike të nevojshme.</i></p> <p><i>-UNYT përgatit raportet e analizës vjetore të cilët përmbajnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe ecurinë e procesit mësimor.</i></p> <p><i>-Sistemi i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga komision ad hoc dhe jo nga një njësi auditimi të brendshëm</i></p>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UNYT ka zbatuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë, lidhur me garantimin e të drejtës së studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të UNYT. Këto të drejta formalizohen në Statutin e UNYT dhe Rregulloret e institucionit. Studentët janë pjesëmarrës në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshillat studentore,</li> <li>• Komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</li> <li>• Senatin Akademik;</li> <li>• Këshillin e etikës</li> <li>• Grupet e vlerësimit të brendshëm për akreditimin</li> </ul> <p>Gjatë takimit më GVB ne u njohëm edhe me studentin që ishte pjesë e këtij GVB dhe KPSSC, të cilët vlerësuan angazhimin në këto struktura.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i NYUT</b></p> <p><b>Aneksi 1.7 Rregullore e UNYT</b></p> <p><b>Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjsBC, Këshilli i Etikës</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete,</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion ne u takuam me një student pjesëmarrës në GVB dhe një në Komisionin e Sigurimit të cilësisë. Gjithashtu në takimim me studentët që po ndjekin programin e studimit ne i pyetëm a kanë dijeni për përfaqësuesit e tyre në strukturat vendimmarrëse. Rezulton se informacioni i tyre lidhur me këtë nuk është i plotë.</p> <p>Studentët marrin pjesë në vlerësimin e procesit akademik përmes</p>

<p>frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>plotësimin të pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor. Lidhur , me këtë studentët e takuar u shprehën se kanë një rol aktiv në këtë drejtim dhe kjo ndikon në përmirësimin e procesit akademik.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjsBC, Këshilli i Etikës</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga takimi që zhvilloam në Institucion, u informuam se koordinatori i programit që është dhe përgjegjësi i Departamentit që mbulon këtë program studimi është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit, për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.</p> <p>Gjithashtu këshilltari akademik luan një rol të rëndësishëm për të mbledhur sugjerimet e studentëve.</p> <p>Rol shumë të rëndësishëm luajnë pyetësorët e vlerësimit, të cilët janë një instrument i drejtpërdrejtë për të mbledhur opinionet dhe sugjerimet e studentëve për procesin mësimor dhe për mësimdhënien. Vlerësimet që studentët bëjnë u përcillen pedagogëve, shefit të departamentit, dekanit dhe rektorit dhe ato shërbejnë si inpute për përmirësime të nevojshme të programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, pjesëmarrja si antarë në komisione e studentëve, shihet si një mënyrë për të marrë opinionet e tyre rreth prograneve të studimit.</p> <p>Kjo u konfirmua dhe nga studentët pjesëmarrës në Unionin studentor dhe Komisionin e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 6.9 Format vlerësimi nga studentët</b></p> <p><b>Aneksi 6 .9.1 Vlerësimi i pedagogëve nga studentët</b></p> <p><b>Vizita në institucion, Takimi me studentët dhe koordinatorin e programit të studimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet e drejta e studentit për të ankimuar rezultatin e vlerësimit. Gjithashtu në këto rregullore detajohet procedura se si bëhet ankesa, si ndiqet deri në përgjigjen përfundimtare. Studenti e adreson ankesën pranë Zyrës së Çështjeve studentore, më tej ajo kalon në Departament e po të jetë e nevojshme në Dekanat. Procedura detajohet në nenin 45 të Rregullores së Programit, ku specifikohet se kjo realizohet përmes peticioneve.</p>





<p>të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Për peticionet ka një format të vecantë, i cili plotësohet online. Administrimin e peticioneve e bën zyra e çështjeve studentore. Për trajtimin e ankimit është ngritur Komisioni i peticioneve , i cili përbëhet nga 3 antarë. Komisioni trajton ankimin dhe vendos në se ai pranohet apo refuzohet.</p> <p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e gjen atë të plotë dhe shumë të kuptueshëm. Nga takimi me studentët e programit rezultoi se ata nuk kishin aplikuar procedura ankimi, pasi nuk e kishin gjetur të nevojshme deri tani. Ata njohin procedurën dhe formatin e peticioneve akademike dhe administrative.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita ne institucion, takimi me studentët</b></p> <p><b>Aneksi 5.30 Peticioni administrativ</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- <i>Studentët janë të përfaqësuar në strukturat vendimmarëse të UNYT, Ata kanë një përfaqësues të zgjedhur prej tyre në organin më të lartë vendimmarës që është Senati Studentët janë Antarë në Këshillat studentorë, në Komisionin e përhershëm për standardet e cilësisë, në Këshillin e Etikës, Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.</i></p> <p>-<i>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën, përfshirjen në projekte e grupe studimore.</i></p> <p>-<i>Studentët vlerësojnë pozitivisht cilësinë e mësimdhënies.</i></p> <p>-<i>Institucioni aplikon procedura të qarta për shqyrtimin e ankesës së studentit për rezultatin e provimit, të formalizuara në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit.</i></p> <p>-<i>Koordinatori i programit dhe këshilltari akademik janë në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërbejnë si ura komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.</i></p> <p>-<i>Koordinatori kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës, duke reflektuar opinionet e dhëna nga ata përmes pyetësorëve të vlerësimit si edhe pjesëmarrjes në KPSSC.</i></p> <p><i>Sugjerime : Duhet të përfshihen në pyetësorë më shumë pyetje për programin</i></p> <p><i>Studentët që janë antarë të komisioneve duhet të bëjnë takime me studentët e tjerë dhe të luajnë rol më aktiv në përfaqësimin e interesave të tyre</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në funksion të informimit të studentëve në varësi të çështjeve të ndryshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Çështjeve Studentore</li> <li>- Zyra e Karrierës dhe ALUMNI;</li> <li>- Sekretaria mësimore</li> </ul> <p>Funksionet e këtyre zyrave përcaktohen në Statutin e UNYT si edhe në rregulloret respektive të zyrave. Zyra për çështjet studentore përgjigjet për informim të studentëve deri në regjistrim. Sekretaria i informon lidhur me çështjet e frekuentimit dhe vlerësimit, Zyra e karrierës dhe alumni mbi qasjet ndaj tregut të punës, internshipet dhe mundësitë për punësim. Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë në kontakt të vazhdueshëm me këto zyra, të cilat janë shumë bashkëpunuese dhe të gatshme për ofrimin e informacioneve që ata kërkojnë.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i UNYT</b></p> <p><b>Aneksi 1.7 Rregullore e Universitetit</b></p> <p><b>Aneksi 5.1 Rregullore e zyrës së çështjeve studentore</b></p> <p><b>Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme për funksionimin e sekretarisë mësimore</b></p> <p><b>Aneksi 5.11 Rregullore e zyrës së karrierës</b></p> <p><b>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe zyrat</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1, është funksional dhe i përshtatshëm. Kjo konfirmohet nga takimi me studentët të cilët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për angazhimin e zyrës së çështjeve studentore për të dhënë gjithë</p>

<p>përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>informacionin deri në regjistrim. Gjithashtu zyra e karrierës i ka mbështetur për të getur kompani ku të zhvillojnë internshipet. Vec kësaj ata kanë një bashkëpunim permanent me këshilltarin akademik për çdo çështje që lidhet me procesin mësimor.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe zyrat</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UNYT informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe i orienton ata drejt tregut të punës përmes Zyrës së Karrierës dhe alumini. Kjo zyrë operon përmes një plani vjetor pune. Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm si edhe me përfaqësues të zyrës së karrierës, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve drejt tregut dhe mbi mundësitë e punësimit. U konfirmua informacioni i dhënë në RVB dhe dokumentacioni shoqëruar i cili sqaron se instrumentat më të rëndësishëm të përdorur janë ditët e karrierës, takimet informuese, bashkëpunimi me institucionet e ndryshme për realizimin e internshipeve, panairi i punës dhe pjesëmarrja e Alumnit në aktivitete të ndryshme. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike, pjesë e komunikimit me të cilat është edhe marrja e informacionit për vendet e lira të punës. Përmes një linku të posaçëm realizohet edhe përfshirja e studentëve në përzgjedhjen e kompanive pjesëmarrëse në panair.</p> <p>Nga takimi me përfaqësuesen e zyrës së karrierës rezultoi se kjo zyrë bashkëpunon dhe me zyrën e marrëdhënieve me publikun për të shpërndarë informacionin. Gjithashtu, zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për identifikimin e lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë, vendet e mundshme për punësim, qasjen ndaj vendeve të punës.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5-11: Rregulloren e zyrës së karrierës dhe alumni.</b></p> <p><b>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumni</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni ndjek studentët edhe pas diplomimit për të gjykuar mbi performancën e programeve të studimit dhe konfirmimin e përputhshmërisë me kërkesat e tregut të punës. Zyra ka krijuar një bazë të të dhënave, e cila përditësohet çdo vit. Përmes saj bëhet gjurmimi të studentëve pas përfundimit të studimeve. Të dhënat dhe statistika në lidhje me punësimin e studentëve të këtij programi akoma nuk janë mundësuar pasi akoma nuk është përfunduar cikli i plotë 3 vjeçar i studimit.</p>

<p>të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Informacioni mbi punësimin e studentëve ndahet me Departamentet dhe është pjesë e dokumentit të vlerësimit të performancës,</p> <p>Në takimin me përfaqësuesen e zyrës së karrierës u informuam edhe mbi marrëdhëniet që mbahen me studentët që kanë mbaruar studimet në UNYT si alumni që shpesh edhe mundësojnë forcimin e marrëdhënieve me kompanitë e ndryshme, ku ata janë punësuar .</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.11 Rregullore e zyrës së karrierës</b></p> <p><b>Aneksi 5.18 Dokumneti i performancës</b></p> <p><b>Aneksi 5,20 Statistika të punësimit të studentëve Bch</b></p> <p><b>Aneksi 5,21 Statistika të punësimit të studentëve Master</b></p> <p><b>Aneksi 5.17.1 Komunikim alumni</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UNYT ka ngritur një sistem funksional për informimin e studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</i></p> <p><i>-Në institucion funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumni , pranë së cilës studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme si për internshipet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, ashtu edhe për qasjen dhe mundësitë e tregut të punës, .</i></p> <p><i>-Zyra e Karrierës dhe Alumni mban lidhje me studentët e diplomuar, mban e përditëson një bazë të të dhënave, të cilat përditësohen çdo vit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p><b>X</b></p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

## VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

### Standardi VI.1



**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, në zbatim të planit strategjik të UNYT, e cila ka përcaktuar edhe objektivat që lidhen me cilësinë e mësimdhënies. UNYT konsideron se implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies rrit cilësinë akademike dhe është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës. Në planin strategjik të institucionit theksohet se në UNYT zbatohen metoda inovative dhe bashkëkohore të mësimdhënies, përtej leksioneve tradicionale.</p> <p>Nga diskutimi me pedagogët si edhe me NJSBC u informuam se në ndihmë të rritjes së cilësisë së mësimdhënies vijnë edhe trajnimet e stafëve të reja si edhe shkëmbimet e stafëve në kuadër të projekteve të ndryshme. Përgjegjësi i Departamentit, i cili është edhe koordinator i programit udhëzon stafet e reja lidhur me hartimin e kurrikulave me qëllim përfshirjen në to të metodave inovative të studimit.</p> <p>Gjithashtu, në takimin e zhvilluar, Përgjegjësi i Departamentit theksoi se ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga NJBSC, por nuk na është vënë në dispozicion ndonjë program apo raport trajnimi.</p> <p>Në takimin që pati GVJ me studentët ata konfirmuan se pedagogët kujdesen që të përdorin metoda bashkëkohore të mësimdhënies si puna në grup, vizita në kompani, etj, të cilat e sjellin mësimdhënien më pranë praktikës dhe e bëjnë orën mësimore më tërheqëse.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.6 Plani strategjik</b></p> <p><b>Aneksi 6.18 Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit</b></p> <p><b>Aneksi 1.31. Statistika shkëmbim stafi</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative kryhet përmes strukturave për sigurimin e cilësisë që janë NJSBC, me 2 antarë dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë me 7 anëtarë. KPSSC ka në përbërje të tij antarë nga të gjitha fakultetet dhe gjithashtu dhe një student.</p>



periodike aftësitë  
mësimdhënëse dhe  
inovative të personelit  
akademik dhe  
ndihmësakademik.

NJSBC është njësi bazë, e cila përdor mekanizmat për sigurimin e cilësisë sic janë pyetëtorët. Ajo i mbledh, i përpunon dhe rezultatet ia kalon KPSSC, i cili është një organ i një niveli më strategjik.

Institucioni ka hartuar rregulloren për secilën strukturë ku paraqiten funksionet e tyre dhe modalitetet e bashkëpunimit. Rezultatet e pyetësorëve u shpërndahen pedagogëve individualisht, por edhe përmes Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit. NJSBC harton raportin vjetor mbi bazën e përpunimit të të dhënave nga pyetëtorët. Për herë të parë KPSSC ka hartuar edhe pyetësorin për stafin administrativ. Tek pyetëtori i studentëve ka pyetje për përdorimin e mjeteve të inovacionit dhe teknologjisë, përmes të cilave vlerësohen edhe aftësitë inovative të personelit. Pyetëtori konsiderohet si një dokument dinamik, ai rinovohet, sipas nevojave për vlerësime shtesë apo përmirësime të cilat rrjedhin nga gjetjet vjetore. Organizohen edhe trajnime për antarët e NJSBC, në lidhje me hartimin e dokumentave që kanë të bëjnë me garantimin e cilësisë.

Çdo vit bëhet vlerësimi i performancës akademike, përmes : pyetësorëve që plotësohen nga studentët, pyetësorëve që plotësohen nga kolegët si edhe një raport vetëvlerësimi, ku secili pedagog ballafaqon objektivat me arritjet vjetore. Këto pasqyrohen në raportin e departamentit e më tej në atë të Fakultetit dhe Universitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore monitoron në mënyrë periodike cilësinë e programeve të studimit, aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, rekrutimin e stafit me gradat dhe titujt e duhura, anketimet dhe kontrollet e vazhdueshme të procesit mësimor, si dhe çdo aktivitet që shërben për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe jetës studentore.

Nga takimi me përfaqësues të NJSBC dhe KPSSC rezultoi se është bërë një analizë vjetore e detajuar lidhur me pyetëtorët dhe ata janë në fazë rishikimi, për të përmirësuar përmbajtjen e tyre bazuar në gjetjet e analizave të kryera, për t'i sjellë ata më pranë çështjeve që kanë interes për studentët dhe vendimmarrësit.

Institucioni ka përgatitur dhe një Manual të posaçëm për sigurimin e cilësisë.

#### **Evidenca**

**Aneksi 1.1 Statuti i NYUT**

**Aneksi 6.1 Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë**

**Aneksi 6.2.2 Raport vjetor i NJSBC**

	<p>shkencore, bazuar edhe në performancën e tyre akademike dhe si kërkues shkencor. Një instrument promovimi për stafet me arritje të qënësishme është edhe ngritja e tyre në karrierë.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.17 Vlerësimi i performancës individuale</b></p> <p><b>Aneksi 4.33.2 Plan buxheti</b></p> <p><b>Aneksi 4.29 Promovim stafi</b></p> <p><b>Aneksi 6.6 Formular për raportin vjetor të monitorimit</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Pranë UNYT janë miratuar politikat, janë krijuar strukturat dhe hartuar procedurat për sigurimin e cilësisë, duke krijuar një sistem funksional, i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit.</i></p> <p><i>-Studentëve u garantohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, si edhe e komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti.</i></p> <p><i>- KPSSC në fund të çdo viti harton një raport në nivel institucional, me gjetjet e analizës lidhur me sigurimin e cilësisë, i cili shoqërohet me planin e ndërhyrjeve për përmirësime cilësore të mëtejshme.</i></p> <p><i>-Të dhënat e raportit të vlerësimit të cilësisë, që evidentojnë arritjet e stafëve i shërbejnë promovimit të praktikave të mira, ngritjes në karrierë dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të nivelit të mësimdhënies.</i></p> <p><i>-Procedurat për garantimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë formalizuar në Rregulloret e strukturave përkatëse si NJSBC, KPSSC dhe Manualin e Sigurimit të cilësisë</i></p> <p><i><u>Rekomandim.</u> Mund të aplikohen edhe stimuj financiarë për pedagogë që kanë arritje të spikatura në procesin mësimor dhe kërkimor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**



	<p><b>Aneksi 6.3 Rregullore e KPSSC</b></p> <p><b>Aneksi 6.7 Rregullore e NJSBC</b></p> <p><b>Aneksi 6.9.6 Vlerësimet e pedagogëve nga studentët 2023-2024</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>E drejta e studentëve për t'u përfshirë në vlerësim është formalizuar në Statutin e UNYT si dhe në rregulloret përkatëse. Kështu, studentët janë të përfaqësuar në KPSBC. Ata janë burimi më i besueshëm dhe i plotë i informacioneve mbi cilësinë e programeve dhe të mësimdhënies, përmes plotësimit të pyetësorëve për këtë qëllim. Gjithashtu, UNYT ka mundur praktika të ankimit përmes peticionit, një formulari/peticioni ankimi administrativ ose akademik. Peticioni drejtohet tek zyra e çështjeve studentore dhe bëhet online në web .UNYT ka krijuar dhe një Komision të posaçëm që realizon trajtimin e këtyre peticioneve.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 6,9 Formular vlerësimi nga studentët</b></p> <p><a href="http://www.unyt.edu.al">www.unyt.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vërejmë se KPSSC publikon raportet e vlerësimit të jashtëm. Gjatë takimit me KPSSC pyetëm në se publikohet raporti vjetor i sigurimit të cilësisë. U informuam se raporti vjetor i NJSBC publikohet në web. Në të është edhe plani i masave për përmbushjen e rekomandimeve. Kjo tregon transparencë në procesin e vlerësimit të cilësisë në këtë institucion.</p> <p><b>Evidencë</b><a href="https://unyt.edu.al/content/uploads/2023/06/Quality-Assurance-Annual-Report.pdf">https://unyt.edu.al/content/uploads/2023/06/Quality-Assurance-Annual-Report.pdf</a></p> <p><b>Aneksi 6.2.2 Raport vjetor NJSBC</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjetjet e pyetësorëve si edhe analiza e performancës vjetore i shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim në mësimdhënie dhe kërkim. Vlerësimi bëhet bazuar edhe në raportin individual të performancës, i cili ballafaqon objektivat e përcaktuara me arritjet për cdo pedagog. Departamentet përgatisin një raport të performancës, i cili miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga Dekani dhe i përcillet rektoratit si pjesë e analizës së performancës në nivel universiteti. Bazuar në arritjet akademike dhe shkencore, çdo vit akademik jepen 2 çmime, përkatësisht “best researcher” dhe “best professor” si një vlerësim simbolik, por jo i stimuluar financiarisht. Por UNYT alokon fonde për pjesëmarrjen e stafeve në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikimet e tyre</p>



**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UNYT ka ngritur një sistem adekuat për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ky sistem përbëhet nga strukturat, politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë. Politikat përkatëse janë formalizuar në dokumentat strategjike si Plani Strategjik i UNYT, Statuti, Rregullorja e UNYT. Procedurat janë formalizuar në Rregulloret e funksionimit të NJSBC, KPSSC dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Të gjithë këta dokumenta zbatojnë kërkesat e legjislacionit të Arsimit të lartë.</p> <p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë NJSBC dhe Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë. NJSBC është njësisia bazë, e cila përdor mekanizmat për sigurimin e cilësisë sic janë pyetësorët. Kjo njësi i mbledh, i përpunon dhe rezultatet ia kalon KPSSC, i cili është një organ i një niveli më strategjik.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i NYUT</b></p> <p><b>Aneksi 6.1 Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë</b></p> <p><b>Aneksi 6.2.2 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 6.3 Rregullore e KPSSC</b></p> <p><b>Aneksi 6.7 Rregullore e NJSBC</b></p> <p><b>Vizita në institucion , takime me strukturat e cilësisë.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UNYT ka ngritur Sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku përfshihen edhe studentë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. NJSBC bashkëpunon me Departamentet për të këshilluar mbi vlerësimet që lidhen me cilësinë e mësimdhënies. UNYT ka rekrutuar një ekspert të jashtëm për sigurimin e cilësisë. Ekspertja e jashtme mori pjesë në takim me GVJ. Ajo demonstroi një rol tepër aktiv në proceset e analizës së rezultateve të vlerësimit. Në KPSSC bën pjesë dhe një student. Nga takimi me antarë të KPSSC u informuam se në rastet kur bëhen rishikime kurrikulash apo programesh, ata zhvillojnë edhe takime me ekspertë të fushave të studimit, për të përshtatur programet e studimit me kërkesat cilësore të tregut të punës.</p> <p>Elementët e vlerësimit të cilësisë janë pjesë integrale e kuadrit strategjik të institucionit. Në të gjithë dokumentat strategjike si</p>




	<p>Plani strategjik, Statuti, e më tej në rregulloret e strukturave përkatëse demonstron rëndësia që i jep ky institucion përmirësimin të cilësisë në mësimdhënie e mësimnxënie, në mënyrë që të bëhet sa më konkurrues në tregun e punës.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.6 Plani strategjik</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i NYUT</b></p> <p><b>Aneksi 3.9 Raportet e ecurisë akademike MAS 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 6.6 Vendim Rektorati 99 Ekspert i jashtëm.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UNYT i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional, bazuar në Ligjin për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm. Në këtë kuadër institucioni ka vënë në dispozicion strukturat e tij të vlerësimit të cilësisë. UNYT ka konsideruar me seriozitet dhe angazhim profesional raportet e vlerësimit të jashtëm dhe ka hartuar dhe zbaton plane pune të detajuara për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga GVJ dhe Bordi i Akreditimit të ASCAL. Eksperti i jashtëm i rekrutuar për këtë qëllim luan një rol aktiv në kryerjen e proceseve vlerësuese dhe koordinimin e punës së NJSBC me KPSSC.</p> <p>UNY T është në proces akreditimi edhe nga Agjencia Turke e Sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë “YOKAK”, nisur nga fakti që prej vitit 2018 NYUT ka kaluar në pronësi të fondacionit turk MAARIF, i cili operon në rreth 67 shtete për mbi 50,000 studentë.</p> <p>Është zhvilluar në këtë kuadër një vizitë në institucion nga ekspertë të YOKAK, të cilët kanë zhvilluar edhe seanca trajnimi lidhur me procesin e akreditimit.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.19 Akreditimi institucional</b></p> <p><b>Aneksi 6.11. YOKAK visit agenda</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi</p>	<p>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, UNYT ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC dhe KPSSC. Ndër treguesit kryesorë të performancës përmendim publikimet, botimet, pjesëmarrjet në konferenca e aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, pozicionet menaxheriale si edhe elementët e mësimdhënies. Treguesit janë sasiorë dhe cilësorë. NJSBC përpaket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë</p>

<p>bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>standardizuar si procese që kryhen si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në bazë të Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.</p> <p>Veç mekanizmave të përmendur më lart siç janë pyetësorët nga studentët, nga kolegët, është përmendur si një instrument vlerësimi dhe Raporti i paanshmërisë transparencës, krahasueshmërisë dhe auditimit. Ky plotësohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe vlerëson komponentët e mësimdhënies.</p> <p>Mekanizmat e sipërpërmendur shërbejnë për evidentimin e arritjeve më të spikatura të stafëve në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen përmes ngritjes së tyre në karrierë dhe/ose akordimit të titujve “ best professor” dhe “ best researcher”.</p> <p><b>Evidencë :</b></p> <p><b>Aneksi 6.10: Individual performance assessment form</b></p> <p><b>Raporti I paanshmërisë transparencës, krahasueshmërisë dhe auditimit .nuk është në listën e dokumentave</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka krijuar një sistem funksional të menaxhimit të cilësisë të përbërë nga politika dhe procedura, si dhe struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p> <p><i>-NJSBC dhe KPSSC kryejnë vlerësimin dhe monitorimin e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes instrumentave si pyetësorët, raportet vjetore, etj. ,</i></p> <p><i>-Vlerësimi i brendshëm i cilësisë kryhet periodikisht përmes një sistemi të bazuar në standarde, duke realizuar vlerësime dhe analiza të detajuara që synojnë të promovojnë praktikat më të mira dhe përmirësojnë cilësinë.</i></p> <p><i>- UNYT përdor tregues konkretë të performancës, të cilët përbëjnë bazën e analizave të cilësisë. Lista e treguesve të performancës përmban tregues që lidhen me procesin mësimor, kërkimin shkencor si edhe angazhimin institucional. Ajo realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NJSBC dhe KPSSC dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UNYT përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Ky proces fillon që nga vendosja e objektivave vjetore nga vetë stafet, monitorimi i realizimit të tyre në nivel individual, Departamenti, Fakulteti dhe Universitetit. Gjetjet e këtyre analizave janë pjesë e Raportit që përgatitet në mënyrë hierarkike. Disa nga instrumentat e përdorur janë analizat periodike të punës në nivel departamenti, të cilat u përcillen strukturave më të larta për përgatitjen e raporteve në nivel Fakulteti dhe Universiteti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve akademike.</p> <p>Raportet e performancës akademike, raportet e vlerësimit bazuar në pyetësorët, përbëjnë instrumentat kryesorë për monitorimin e programeve të studimit. Këto raporte analizohen nga strukturat që merren me sigurimin e cilësisë, NJSBC dhe KPSSC pasi janë shqyrtuar nga Departamentet përkatëse.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u informuam se NJSBC ishte aktive në përgatitjen e këtyre raporteve si edhe në ndjekjen e rekomandimeve të lëna në kuadër të procesit të akreditimit, përmes një plani pune. Koordinatori i programit theksoi se ai luante një rol të rëndësishëm në koordinimin me Departamentin përkatës.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 3.9 Raportet e ecurisë akademike MAS 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 6.2.2 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 1.14 Raporti vjetor i Departamentit</b></p> <p><b>Vizita në Institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e</p>	<p>Raportet vjetore përfshijnë analizën e arritjeve të stafeve, Departamenteve, bazuar në objektivat e vendosura në nivel personal dhe departamenti. Gjithashtu, bazuar në gjetjet e analizës së vlerësimit përmes pyetësorëve evidentohen edhe</p>





vlerësimin, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.

mangësitë dhe nevojat për ndërhyrje në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit. Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim, në funksion të përmirësimin të programit të studimit. Të dhënat e vlerësimin përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe Fakultetit. Në mbledhjet e departamentit, ku analizohen të dhënat e vlerësimin, diskutohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë.

Bazuar në analizat e realizuara, evidentohen edhe rastet e praktikave më të mira, të cilat promovohen përmes ngritjes në karrierë, por edhe përmes dhënies së titujve si “Profesori më i mirë i vitit”

Këto informacione u konfirmuan edhe gjatë takimit me KPSSC.

#### **Evidenca**

##### **Aneksi 4.29 Promovim Stafi**

##### **Aneksi 6.9 - Formular Vlerësimi nga Studentët**

##### **Aneksi 6.9.1 - Vlerësimet e Pedagogëve nga studentët - Spring 2021**

##### **Aneksi 6.9.2 - Vlerësimet e Pedagogëve nga studentët - Fall 2022**

##### **Aneksi 6.9.3 - Vlerësimet e Pedagogëve të rinj - Fall 2022**

##### **Aneksi 6.9.6 Vlerësimet e Pedagogëve nga studentët 2023-2024**

##### **Aneksi 1-14 Raporti vjetor i Departamentit**

**Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimin i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimin paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimin lokale apo të

Vlerësimin i cilësisë së mësimdhënies bëhet përmes : vetëvlerësimin, vlerësimin nga kolegët, vlerësimin nga studentët. Gjithashtu, pedagogët ndjekin seancat e mësimdhënies të njëri-tjetrit, për të evidentuar teknikat më të mira dhe nevojat për përmirësimin. Studentët komunikojnë edhe me këshilltarin akademik lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mësimdhënien, praktikën, etj. Bazuar në kërkesat e studentëve, por edhe mbi nevojat e tregut të punës, bëhen rishikime të herëpashershme të programeve të studimit, duke propozuar ndryshime deri në 20% , sipas rregulloreve në fuqi.

#### **Evidenca**

##### **Aneksi 6.9 - Formular Vlerësimi nga Studentët**

##### **Aneksi 6.9.1 - Vlerësimet e Pedagogëve nga studentët -**



<p>standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><b>Spring 2021</b></p> <p><b>Aneksi 6.9.2 - Vlerësimet e Pedagogëve nga studentët - Fall 2022</b></p> <p><b>Aneksi 6.9.3 - Vlerësimet e Pedagogëve të rinj - Fall 2022</b></p> <p><b>Aneksi 6.9.6 Vlerësimet e Pedagogëve nga studentët 2023-2024</b></p> <p><b>Aneksi 1.15 Vlerësimi nga Koleget</b></p> <p><b>Aneksi 3.21 Lista e Këshilltarëve Akademikë</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni si edhe NJSBC përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi. Studentët plotësojnë një pyetësor në mbarim të studimeve. Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte më të dipomuarit dhe ka bashkëpunim me ta, përmes ftesës në aktivitete të ndryshme, siç është edhe panairi i punës. Këto shërbejnë për të vlerësuar aksesin e studentëve në tregun e punës, bazuar në formimin e tyre universitar.</p> <p>Një instrument i rëndësishëm është dhe sondazhi kombëtar i realizuar përmes ASCAL.</p> <p>Këto sondazhe kanë shërbyer për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe për përshtatjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 5.15 Panairi i punës</b></p> <p><b>Aneksi 5.16 Plani vjetor zyra e karruerës dhe alumni</b></p> <p><b>Aneksi 5.17 Paneli alumni</b></p> <p><b>Aneksi 6.15 Sondazhi kombëtar i studentëve ASCAL</b></p> <p><b>Vizita në institucion, Takimet me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Programet e studimit vlerësohen përmes mekanizmave e proçeseve formale të dokumentuara lidhur me shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të tyre .</i></p> <p><i>-Të dhënat e analizave vjetore përfshihen në raportet vjetore të Departamentit, Fakultetit dhe Universitetit</i></p> <p><i>- Të dhënat e vlerësimit analizohen nga çdo Departament përmes mbledhjes së Departamentit.</i></p> <p><i>-Raportet e vlerësimit shoqërohen me planin e masave për adresimin e mangësive dhe ndërhyrjet për përmirësimin e</i></p>

	<p><i>cilësisë.</i></p> <p><i>-Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni dhe NJSBC përdor instrumenta të tërthorta vlerësimi që lidhen me aktivitetin e studentëve pas përfundimit të studimeve .</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### **Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka ngritur një sistem për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë, të përbërë nga NJSBC dhe KPSSC. Detyrat funksionale dhe procedurat e punës së këtyre strukturave të menaxhimit të cilësisë janë të sanksionuara në Statut, në planin strategjik të institucionit, në rregulloren e NJSBC dhe Manualin për sigurimin e cilësisë Ky sistem garanton përfshirjen e formalizuar të strukturave në procesin e sigurimit të cilësisë, ku bëjnë pjesë dhe studentët. Gjithashtu ky institucion ka rekrutuar një ekspert ligjor të jashtëm që asiston në përmirësimin e standardeve të cilësisë përmes analizës së gjetjeve të raporteve vjetore dhe të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë, i cili është një mbështetje për përmbushjen e rekomandimeve që lidhen me procesin e akreditimit. Përmirësimi i cilësisë së këtij programi studimi ndjek të gjitha procedurat e formalizuara në dokumentat startegjike dhe rregulloret që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë si Statuti, Rregullorja e NjsBC, Rregullore e KPSSC, Manuali i sigurimit të cilësisë ..</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i UNYT</b></p> <p><b>Aneksi 6.1 Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë</b></p> <p><b>Aneksi 6,3 Rregullore e KPSSC</b></p> <p><b>Aneksi 6.7 Rregullore e NjsBC</b></p> <p><b>Aneksi 6.6 Vendim Rektorati 99 Ekspert i jashtëm</b></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se UNYT, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka përcaktuar qartë detyrat funksionale të strukturave të menaxhimit të cilësisë.</p> <p>Këto janë përcaktuar në Statutin e UNYT, në kuadër të përcaktimit të detyrave të të gjitha strukturave e më tej janë detajuar e specifikuar në rregulloret e posacme si Rregullorja e NJSBC, e KPSSC dhe Manuali i Sigurimit të cilësisë. Detyrat specifike për këto struktura si edhe për Departamentet janë përcaktuar edhe në planet vjetore të punës. Një plan konkret masash , me detyra specifike për njësitë përgjegjëse hartohet në kuader të akreditimit të programeve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ takoi përfaqësues të këtyre strukturave të cilët konfirmuan se njohin përgjegjësitë e tyre dhe koordinojnë punën mes tyre për realizimin e planeve të punës. KPSSC është struktura më e lartë e cila garanton monitorimin e sigurimit të brendshëm të cilësië deri në nivel Rektorati. Strukturat shprehën angazhim optimal në procesin e akreditimit. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë.</p> <p>GVJ konstatoi se strukturat kanë kapacitetet e duhura dhe aftësi menaxhuese dhe drejtuese. Antarët e KPSSC janë personalitete të fushave të tyre dhe kanë mbajtur dhe pozicione drejtuese të nivelit të lartë brenda dhe jashtë sistemit arsimor. Studentët e përfshirë në strukturat si GVB, KPSSC dëshmuuan se janë të përfshirë në proces.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i UNYT</b></p> <p><b>Aneksi 6.1 Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë</b></p> <p><b>Aneksi 6,3 Rregullore e KPSSC</b></p> <p><b>Aneksi 6.7 Rregullore e NJSBC</b></p> <p><b>Aneksi 6.17 Plani vjetor i NJSBC</b></p> <p><b>Aneksi 2.15 Përfshirja e studentit në RVB</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë</p>	<p>Procedurat që lidhen me sigurimin e cilësisë kanë garantuar përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore, stafeve akademike, administrative dhe studentëve. Nga pikëpamja rregullatore kjo sigurohet përmes faktit që secila strukturë ka të përcaktuar rolin e saj në dokumentat strategjike dhe rregulloret përkatëse. Gjithashtu</p>






<p>dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>kjo reflektohet në faktin se raportet vjetore që lidhen me sigurimin e cilësisë përgatiten në bazë të raporteve individuale të vetëvlerësimit, raporteve të analizës së performancës së Departamenteve, gjetjeve të pyetësorëve ku përfshihen stafet dhe studentët. Procedura e vlerësimeve përfshin të gjithë aktorët, që nga vetë pedagogu, përmes vetëvlerësimit, tek studentët përmes formularit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët, vlerësimin nga kolegët. Në KPSSC bën pjesë si antar një përfaqësues nga secili fakultet, gjë që garanton edhe përfaqësimin e Fakultetit që mbulon këtë program studimi në vendimmarrjet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.17 Vlerësimi i performancës individuale</b></p> <p><b>Aneksi 6.4 Formular vlerësimi nga kolegët</b></p> <p><b>Aneksi 6,9 Formular vlerësimi nga studentët</b></p> <p><b>Aneksi 6.10 Formular vlerësimi performance.</b></p> <p>Procedurat e përzgjedhjes së antarëve të KPSSC janë transparente dhe të sanksionuara në Statutin e UNYT . KPSSC zgjidhet nga Senati, duke patur parasysh plotësimin e kriterëve të integritetit profesional. UNYT ka hartuar Kodin e Etikës dhe ka krijuar Komisionin e Etikës konform akteve ligjore në fuqi që lidhen me etikën në arsimin e lartë. Shmangia e diskriminimit dhe garantimi i respektimit të lirisë dhe integritetit akademik janë pjesë e politikës së UNYT, formalizuar në Kodin e etikës. Procedura e përzgjedhjes së antarëve të KPSSC reflekton transparencë dhe gjithëpërfshirje Gjithashtu, instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me studentët dhe pedagogët u konfirmua se në asnjë rast nuk janë ndeshur me praktika diskriminuese. Ata konfirmuan se në strukturat e menaxhimit të cilësisë ka pedagogë dhe studentë me integritet të lartë dhe të përgjegjshëm. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangët çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve.</p> <p>Ne takuam antarët e KPSSC, një pjesë e të cilëve janë personalitete të njohura publikisht-, me një eksperiencë akademike dhe drejtuese të spikatur dhe me integritet.</p>

	<p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 4.7 Kodi i etikës</b></p> <p><b>Aneksi 6.21 Vendim Senati për antarët e NJSBC</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>			
<p><b>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</b></p>	<p>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit është përfshirë dhe një ekspert i jashtëm . Gjithashtu, në procesin e vlerësimit instucionioni shfrytëzon eksperiza nga institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, studentët e diplomuar, bashkëpunimet ndërkombëtare në kuadër të projekteve si ERASMUS. Mendimet e sugjerimet e tyre janë një kontribut i vlefshëm në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, vlerësimet e jashtme të programit nga ekspertët në kuadër të akreditimit shërbejnë si një bazë e rëndësishme për ndërmarrjen e hapave përmirësues që lidhen me proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-KPSSC dhe NJSBC funksionojnë në nivel institucioni dhe koordinojnë sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.</p> <p>-Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Biznes dhe tregti elektronike ”, njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, siç është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët.</p> <p>-Detyrat funksionale, rolet dhe përgjegjësitë e strukturave që merren me sigurimin e cilësisë janë të garantuara përmes dokumentave të politikave dhe rregulloreve përkatëse</p> <p>-Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, institucioni ka përfshirë dhe një ekspert të jashtëm , gjë që vlerësohet nga GVJ</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Të gjithë dokumentat që lidhen me politikat dhe strategjitë e UNYT, dhe në këtë kuadër edhe ato që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë bëhen publike përmes faqes web të institucionit. Aty të gjithë të interesuarit, pedagogët, studentët, institucionet apo personat nga jashtë institucionit kanë akses në Statutin e UNYT, Strategjinë, rregulloren e NJSBC dhe KPSSC, Manualin e Cilësisë.</p> <p>Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë, ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët.</p> <p>Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm nga studentët dhe publiku në faqen ëeb të IAL. <a href="http://www.unyt.edu.al">www.unyt.edu.al</a></p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><a href="http://www.unyt.edu.al">www.unyt.edu.al</a></p> <p><b>Aneksi 1.1 Statuti i UNYT</b></p> <p><b>Aneksi 6.1 Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë</b></p> <p><b>Aneksi 6,3 Rregullore e KPS SC</b></p> <p><b>Aneksi 6.7 Rregullore e NjsBC</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislationin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBC realizon pyetësorët në fund të çdo viti akademik, Ata janë pjesë e raportit vjetor të cilësisë, i cili publikohet rregullisht duke zbatuar parimin transparencës, në përputhje me rregulloret që lidhen me menaxhimin e cilësisë. Në hartimin e raportit, NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”).</p> <p>Raporti u komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse. Dekanët organizojnë punën për reflektimin lidhur me problematikat e evidentuara.</p> <p>Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e tij elektronike, për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 1.19 Akreditimi institucional</b></p> <p><b>Aneksi 6.1 Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë</b></p>



	<p><b>Aneksi 6,3 Rregullore e KPSSC</b></p> <p><b>Aneksi 6.7 Rregullore e NjsBC</b></p> <p><b>Aneksi 6.2.2 Raporti vjetor NjsBC 2022-2023</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raportet e vlerësimit të cilësisë përveç pjesës narrative kanë edhe një plan për adresimin e rekomandimeve përkatëse apo adresim të problematikave, të cilat synojnë përmbushjen e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Problematikat që kanë të bëjnë me ndërhyrjet e nevojshme që synonë përmirësimin e metodave të mësimdhënies, pajisjen me literaturë, punën kërkimore adresohen edhe në Raportet vjetore të Departamenteve, ku parashikohen edhe fondet e nevojshme për këtë qëllim.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 6.2.2 Raporti vjetor NjsBC 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 4.33.2 Plan buxheti</b></p> <p><b>Aneksi 1.14 Raporti vjetor i Departamentit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukturat e vlerësimit të cilësisë janë tashmë të konsoliduara dhe kanë ekeperiencën e nevojshme. Atyre u është dhënë e gjithë mbështetja institucionale për rritjen e efektivitetit të vlerësimeve. Gjetjet e raporteve të vlerësimit bëhen objekt diskutimi në mbledhjen e Departamentit, ato gjithashtu janë pjesë e raportit vjetor të Departamentit dhe mbi bazën e tyre përgatitet edhe një plan veprimi. Gjithashtu, për ndërhyrjet të cilat kanë nevojë për mbështetje financiare, paraqiten nevojat e Departamentit cdo vit pranë Dekanatit dhe këto bëhen pjesë e plan buxhetit të vitit përkatës.</p> <p>Në takimet me pedagogët u reflektua fakti që UNYT është shumë mbështetës për nevojat e tyre lidhur me përmirësimin cilësor të procesit të studimit dhe kërkimit shkencor si përshebull pajisja me literaturën e fundit, pajisjet elektronike në funksion të metodave inovative të mësimdhënies, etj</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Aneksi 6.2.2 Raporti vjetor NjsBC 2022-2023</b></p> <p><b>Aneksi 1.14 Raporti vjetor i Departamentit</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari</p>	<p>Institucioni ka realizuar takime me studentë dhe pedagogë, por edhe trajnime lidhur me vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu janë ftuar</p>



<p>periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>ekspertë të cilët kanë realizuar ndërgjegjësimin e stafeve mbi rëndësinë e vlerësimin të cilësisë për mbarëvajtjen akademike dhe kërkimore të institucionit.</p> <p>Raportet vjetore të cilësisë janë një veprimtari periodike për të informuar mbi situatën lidhur me sigurimin e cilësisë, problematikat që ndeshen dhe nevojat për përmirësime. Në mënyrë periodike organizohen në bazë departamenti apo fakulteti, aktivitete të ndryshme, seminare, ëorkshop, trajnime, leksione të hapura, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Trajnimet organizohen edhe nga institucione të lidhura me arsimin e lartë si ACAL, i cili ka organizuar trajnimin mbi sondazhin kombëtar të studentëve. Ky u konsiderua nga përfaqësues të KPSSC si një instrument i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e studentëve lidhur me rëndësinë e këtyre pyetësorëve dhe përgjegjshmërinë që ata duhet të reflektojnë gjatë plotësimit të tyre, duke patur parasysh ndikimin që do të kenë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të akreditimit nga Agjencia turke e akreditimit YOKAK, janë zhvilluar senca trajnimi lidhur me aspektet e lidhura me cilësinë në kuadër të procesit të akreditimit.</p> <p><b>Evidenca</b></p> <p><b>Vizita në institucion.</b></p> <p><b>Aneksi 6.17 Trajnimi NJSBC</b></p> <p><b>Aneksi 6.11 YOKAK visit agenda</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>--Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit nëfaqen zyrtare, on line të universitetit.</i></p> <p><i>-NJSCB realizon pyetësorët institucionalë në fund të çdo viti akademik, në bazë të të cilëve hartohet raporti vjetor i sigurimit të cilësisë , i cili publikohet në faqen ëeb të institucionit.</i></p> <p><i>-Bazuar në gjetjet e pyetësorëve përgatiten raportet vjetore të vlerësimin të cilësisë të cilët u komunikohet individëve, strukturave e autoriteteve përkatëse dhe shërbejnë si bazë për ndërhyrjet institucionale në funksion të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>-Në bazë të gjetjeve të raporteve hartohet një plan veprimi ku reflektohen rekomandimet për përmirësime dhe mënyra e adresimit të tyre.</i></p> <p><i>-Institucioni ka realizuar aktivitete për të mundësuar një monitorim sa më efektiv të standardeve të cilësisë, sic janë edhe trajnimet e</i></p>

	<p><i>pedagogëve për këtë qëllim.</i></p> <p><i>-Institucioni vë në funksion buxhete vjetore për të mundësuar përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies dhe punës shkencore (literatura, pjesëmarrja në konferenca, publikimet shkencore etj)</i></p> <p><b>Rekomandim:</b> <i>Studentët duhet të luajnë një rol më aktiv në strukturat ku ata marrin pjesë.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Biznes dhe Tregti Elektronike” të ofruar nga “Univeristeti i New York-ut në Tiranë”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit paraqet një risi dhe një nevojë të tregut të punës dhe si i tillë premtion lehtësimin e aksesit të studentëve në tregun e punës.
2. Programi i studimit është organizuar në mënyrë të strukturuar mirë, me një kurrikul të pasur, duke harmonizuar përfshirjen e lëndëve bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore të fushës së biznesit dhe të teknologjisë së informacionit.
3. Mësimdhënia reflekton harmonizim të metodave tradicionale dhe atyre bashkëkohore, duke ekuilibruar teorinë me praktikën dhe nxitjen e aftësive të punës individuale të studentëve.
4. Stafet akademike që marrin pjesë në këtë program studimi reflektojnë kapacitete akademike dhe menaxheriale të spikatura, falë eksperiencës së tyre në akademi dhe industri.
5. Institucioni reflekton një qëndrueshmëri të stafeve dhe qëndrueshmëri financiare, duke garantuar ecuri normale dhe të pa rrezikuar të programit të studimit.
6. Infrastruktura fizike si dhe ajo e mësimdhënies është e përshtatshme dhe mundëson lehtësimin e procesit mësimor dhe veprimtarive praktike në mjediset laboratorike dhe bibliotekën, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.
7. Institucioni ka ngritur një sistem funksional adekuat të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton realizimin e misionit të tij për një mësimdhënie dhe kërkim shkencor sipas standardeve më të larta bashkëkohore.

**Pika të dobta:**

1. Njohje jo e plotë nga ana e studentëve e përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në strukturat vendimmarrëse. **(Standardi V/5, kriteri 2)**
2. Zhvillimi i mësimin në dy korpuse larg njëri – tjetrit gjë që vështirëson aksesin e mjedisve nga ana e studentëve sidomos të bibliotekës. **(Standardi IV/2, kriteri 1)**
3. Ka një paqartësi në dokumentat bazë të institucionit në lidhje me zgjedhjen e koordinatorit të programit dhe përcaktimin e rolit të tij. **(Standardi II/2, kriteri 3)**
4. Ka një paqartësi në Rregulloren e posaçme të Projektit të Diplomimit apo edhe Rregulloren e Programit të Studimit, në lidhje me mbrojtjen e Projektit para një komisioni apo vlerësimit të tij vetëm nga ana e udhëheqësit. **(Standardi V/2, kriteri 4)**

**Rekomandime:**



1. Mund të aplikohen edhe stimuj financiarë për pedagogë që kanë arritje të spikatura në procesin mësimor dhe kërkimor.
2. Të bëhet rishikimi i pyetësorëve në mënyrë që të përfshihen në to më shumë pyetje për programin e studimit.
3. Studentët që janë antarë të komisioneve duhet të bëjnë takime me studentët e tjerë dhe të luajnë rol më aktiv në përfaqësimin e interesave të tyre.
4. Institucioni mund të parashikojë ofrimin e bursave për regjistrimin e studentëve nga shtresat e marginalizuara, për një politikë sociale më të spikatur.
5. Rekomandojmë që zgjedhja dhe roli i koordinatorit të programit të qartësohet në dokumentat themelore të institucionit.
6. Rekomandojmë përcaktimin e procedurës së mbrojtjes dhe vlerësimit të Projektit të Diplomimit në Rregulloren e posaçme të Projektit të Diplomimit apo në rregulloret e tjera të institucionit.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Bachelor in e-Business and e-Commerce" provided by the Higher Education Institution "University of New York Tirana"**

**Strengths and affirmations**

1. The study program represents an innovation and a growing need of the labor market for professionals in this field and promises to facilitate students' access to the labor market.
2. The study program is organized in a well-structured way, with a rich curriculum, harmonizing the inclusion of fundamentals, specific and interdisciplinary courses in the field of business and information technology.
3. Teaching reflects the harmonization of traditional and contemporary methods, balancing theory with practice and promoting individual skills of students.
4. The academic staff participating in this study program reflect outstanding academic and managerial capacities, thanks to their experience in academia and industry.
5. The institution reflects a stability of the staff and financial stability, guaranteeing the normal and risk-free progress of the study program.
6. The physical infrastructure as well as the teaching infrastructure is suitable and enables the facilitation of the learning process and practical activities in laboratory environments and the library, contributing to the development of students' practical skills.
7. The institution has established an adequate functional system of quality management, which guarantees the realization of its mission of teaching and scientific research according to the highest contemporary standards.

**Weaknesses**

1. Incomplete recognition by students of the involvement of their representatives in decision-making structures. ( **Standard V/5, criterion 2**)





2. The distance of premises of the institution makes it difficult for students to access the facilities, especially the library. ( **Standard IV/2, criterion 1** )
3. There is an ambiguity in the institution's basic documents regarding the election of the program coordinator and the definition of his role. ( **Standard II/2, criterion 3** )
4. There is an ambiguity in Graduation Project Regulation, regarding the defense of the Graduation Project in front of a committee or its evaluation is made only by the Advisor. ( **Standard V/2, criterion 4** )

### **Recommendation**

1. Financial support can also be applied to lecturers who have outstanding achievements in the teaching and research process.
2. It is suggested to revise the questionnaires to include more questions about the study program.
3. Students who are members of committees should meet with other students and play a more active role in representing their interests.
4. The institution can provide scholarships for the enrollment of students from marginalized groups, for a more prominent social policy.
5. We recommend that the election and role of the program coordinator to be clarified in the Regulation's documents of the institution.
6. We recommend defining the procedure for the defense and evaluation of the Graduation Project in the Graduation Project Regulation.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>